

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrale online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Përmbajtja / Sommario

NË VJEN TURKU, TURKU ‘ ZI...

Lek Pervizi

faqe 2/4

EDITORIALI

(D.)

faqe 3

NGA KATUNDET ARBËRESHË

Angelo Matrangelo, Costantino Bellusci, Lucia Cardamone, Motimadh

faqe 4-6

TEKSTE, ZAKONE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË

Carlo Trupo, Zef Beccia, Mario Massaro, Drejtori, Giuseppe Gallo

faqe 7-13

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

Emanuele Giordano, Red.

faqe 14-18

PËRVJETORI I REVISTËS “ZËRI I ARBËRESHVET” (1972-1982)

(Red.)

faqe 19-25

SIMBJET KUJTOMI...

Giovanni Frate, Costantino Bellusci, Antonio Bellusci,
Giovanni Giudice, Giuseppe Chiaffitelli

faqe 26-30/33-37

DOKUMENTE TË HISTORISË ARBËRESHE

Alicia Bodily

faqe 31-32

KOMPOZITORË ARBËRESHË

Raffaele Bloise, Francesco Scaravaglione

faqe 38

POEZI SHQIPE

Klara Kodra, Ibrahim Kadriu, Nebih Bunjaku

faqe 39

POEZI ARBËRESHE / POEZI E PJERRË ARBËRISHT

Zef Chiaramonte, Demetra G. Schirò, Carmine Stamile,
Buzëdhelprì, Giuseppe Gallo / Pierfranco Bruni

faqe 40-41

STUDIME, TEKSTE E ARTIKUJ MBI BOTËN ARBËRESHE

Alma Dema, Asime Feraj, Emil Lafe, Kastriot Marku, Emanuele Giordano

faqe 42-49

STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN SHQIPTARE

Laura Smaqi, Laureta Petoshati, Zamira Alimemaj

Irena Fistani, Denisa Tare

faqe 50-60

NGA KOSOVA - Seminari XXXII Ndërkombëtar i Prishtinës

faqe 61

LIBRE E REVISTA

faqe 61

BIBLIOGRAFI ARBËRESHE

faqe 62-63

JO VET ARBËRISHT

Pierfranco Bruni

faqe 64

Letër e hapur Institucionevet të Kosovës dhe të Shqipërisë

Lek Pervizi

shkrimtar, drejtor i revistës "Kuq e Zi", Belgjikë

Drejtuar:

Presidentes së Republikës së Kosovës, Znj. Ahtifete Jahjaga
Parlamentit të Republikës së Kosovës
Qeverisë së Republikës së Kosovës
Akademisë së Shkencave të Republikës së Kosovës

Për dijeni:

Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bujar Nishani
Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë

Kohëve të fundit në Kosovë është hapur debati rreth "ndryshimeve të historisë" dhe nevojës për një histori të mirëfilltë kombëtare, në të cilën ngjarjet dhe personalitetet do të trajtoheshin në përkim me faktet historike dhe argumentet e nevojshme multishkencore.

Ne vlerësojmë se faktet historike dhe argumentet shkencore janë ngjarje dhe momente jetike në historinë e një Kombi. Ato s'mund të ndryshohen me ndërhyrje të jashtme, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhënie mes një Perandorie pushtuese dhe një Kombi të pushtuar, pas një qëndrese që përbën një faqe të ndritur jo vetëm në historinë e shqiptarëve, por në historinë e Europës.

Ne vlerësojmë se pushtimi osman shkaktoi një gropë të zezë në historinë e Kombit Shqiptar, se ndërpreu procesin normal historik të zhvillimit të kombit tonë, se ky pushtim i shkëputi me dhunë shqiptarët nga Europa dhe shkaktoi tragjedi dhe drama që janë të pashlyeshme në kujtesën historike të kombit. Nuk mund të pajtohemi kurrë dhe dënojmë përpjekjet e disa pseudohistorianëve dhe të segmenteve të caktuara politikë, që përpiqen t'i paraqesin shekujt e gjatë të pushtimit osman si kohë të bashkëjetesës paqësore dhe të suksesshme. Ne deklarojmë, të bindur dhe me logjikë historike, se pashallarët, ushtarakët, zyrtarët, apo shtetarët e lartë të perandorisë, qofshin këta edhe kryeministra, që i kanë shërbyer Perandorisë Osmane, nuk kanë asnjë vlerë për historinë tonë kombëtare, pavarësisht origjinës së tyre shqiptare.

Historia e Shqipërisë nuk është një histori renegatësh dhe as histori shërbëtorësh, por histori qëndrese me Gjergj Kastriotin të parë, histori kryengritjesh e luftërash për liri, histori përpjekjesh për ruajtjen e gjuhës, të kulturës e të identitetit, histori e përpjekjeve titanike për rilindje kombëtare, për shkrimin shqip, histori e përpjekjeve dhe sakrificave të panumërta për liri, pavarësi dhe sovranitet kombëtar që shqiptarët të jetojnë të lirë me shtetin, kulturën dhe identitetin e tyre si të gjithë popujt e tjerë të qytetëruar të Europës.

Përpjekja për të trilluar një histori të paqenë, me pseudohistorianë dhe pseudokomisionerë shtetërorë, të

drejtuar sipas një projekti të errët politik, s'i shërben as paqes dhe as miqësisë së vërtetë mes popujve dhe as projektit të një të ardhmeje që sjell paqe, harmoni e mirëkuptim. Përpjekjet që interpretimi i historisë të bëhet në funksion të pushtetit dhe jo në funksion të së vërtetës, janë të rrezikshme dhe vënë në pikëpyetje të ardhmen tonë. Ndryshimi i historisë në formë arbitrare, duke i ardhur rreth oreksit të diplomacisë turke, krijon një precedent të rrezikshëm: pas disa vitesh edhe Serbia mund të kërkojë të shpallet vetëm një administratore në Kosovë dhe ajo të vlerësohet pozitivisht për lirinë, pavarësinë, kulturën dhe identitetin tonë. Paqja e bazuar në drejtësi është përvojë që i ka ndihmuar shumë popujve të kuptojnë të kaluarën, pa e mohuar atë, pa i fshehur ose shtrëmbëruar të vërtetat historike. "E vërteta është e padiskutueshme", pati thënë Winston Churchill-i.

Më të tillë shembuj është e mbushur historia e Europës dhe mbi këto premisa duhet të shkruhet edhe historia jonë.

Nuk mund te lejojmë që të dhunohet, manipulohet e fallsifikohet historia shqiptare, për interesin e qejfin e një shteti të huaj si Turquia, pushtues e sundues i tmerrshëm 500 vjet mbi shqiptarët duke i trajtuar si skllëvër e duke kryer krime të llahtarshme mbi ta. Cilët janë ata të pa cipë dhe injorantë me diplomë që duan të na vëllazërojnë me turqit ? Të tillë individë nuk janë shqiptarë ! Ç'presin ? Le të thejnë qafën në Anadoll të Turqisë, nga si duket kanë ardhur !

Pikërisht këtë paqe, që bazohet në të vërtetën historike, duhet ta synojmë edhe ne, që populli shqiptar dhe ai turk si popuj liridashës dhe paqësor, të ndërtojnë marrëdhëniet e tyre të miqësisë dhe të bashkëpunimit reciprok.

Pikësynimi i historisë gjithmonë duhet të jetë e vërteta dhe vendosja e së vërtetës historike në kontekstin e duhur e në përkim me parimet metodologjike që ka shkenca e historisë.

Kërkesa për ndryshimin e historisë s'ka ardhur si rezultat i shtytjeve shkencore, zbulimeve dhe fakteve të reja dhe as i nevojës së interpretimeve të reja të mirëfillta shkencore, por si rezultat i trysnisë së shtetit turk mbi qeverinë e Kosovës dhe mbi disa historianë të manipuluar e të painformuar me punime të mirëfillta shkencore. E gjithë historia jonë, e shkruar nga shqiptarë dhe të huaj, dëshmon të kundërtën e asaj që ofron komisioni i ministrisë dhe ekspertëve turq për historinë tonë, sipas të cilëve periudha e pushtimit osman s'kishte dhunë, s'kishte shtytje dhe s'kishte gjencid.

Pushtimi pesëshekullor turk ka qenë i dhunshëm, dhe

(ec te faqja 4)

Erdogani do të bëjnë Sultantin? Te shpia 'tij!

Thuhet se ai që vrau priret ngaherë te vendi ku vrau. Kështu duan të bëjnë Turqit me Shqiptarët e Kosovës. Për të ri-shkruajën historinë e Kosovës si i pëlqen atyre, me duart e tyre që pikojën akoma gjak shqiptar. Po ka i vjen kjo ballëz, kur gjithë Bota i njeh mirë krimet e tyre të parrëfyeshëm kundër Shqiptarëve të Krishterë në Ballkan, gjatë shekulvet XV-XX? Kanë liqë Intelektualët shqiptarë, kudo gjënden, të nënshkruajën, të zëmëruar, Letrën e Hapur të shkrimtarit Lek Pervizit, - e drejtuar Institucionave Shqiptare të Kosovës e të Shqipërisë - se t'i hapjen mirë sytë me Turqinë! Mos të harrojnë, krerët e Kosovës dhe të Shqipërisë, se ikjet "pahir" të Shqiptarëve nga Mëmëdheu zunë dhjaj në shek.XV, me Luftat imperialiste turke kundër Arbrit të lirë të Gjergj Kastriotit Skanderbë e, pëstaj, me Pushtimin/Izlamizimin e Egër të Shqipërisë. Ftesjën Turqit, mëse gjithë, ndëse sot gjënden më Shqiptarë "jashtë" se "mbrënda" kufinjet kombëtarë të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ftesën sundimi otoman dhe diktaturat komuniste të B.Titit e të E.Hoxhës, ndëse sot Shqiptarët e Mëmëdheut rrinë si rrinë.

E ka liqë edhe shkrimtarja Vilhelme Vranari Haxhiraj, kur i bën një Peticionë Institucionave Shqiptare, aq për të nderuar ata dijetarë shqiptarë të emigruar në Botë, që, shkruan "qenë udhëheqës të së ardhmes sonë kombëtare", aq për të kallzuar helmin dhe vajin e save duruan filaqë e vdekje, në Shqipëri, nën dorën gjakësore të E.Hoxhës, dhe që akoma presën të drejtën. Kur do të nderohen "si i nget"? Krimet e Turqvet, e Titit, e Miloseviçit, e Hoxhës kundër Shqiptarëve janë të shkruar te libret e historisë, të shtypur në kujtesat e martirëve të qëndruar të gjallë. Një gjenocid i egër, i gjatë, i turpshëm.

Na Arbëreshë pështuam në Itali, sepse i njihjem mirë Turqit, e zgjedhja jonë që e tharët, po e urtë. Buartim Atdheun, po qëndruam të lirë e të krishterë. E s'jemi fare të penduar për këtë zgjedhje.

Edhe Italia, sot, është e rron një krizë ekonomike të thellë. E katundet e Arbërisë mbrazen ditë për ditë më shumë: trimëria emigron ndaj veriut, ose jashtë Italisë, për me gjetur punë e një t'ardhme më të mirë. Njo, sot, një fat i mjerë i bashkon trimat arbëreshë, kosovarë e shqiptarë: Papunësia. Gjëndemi përpara një "emigrimi global shqiptar" për me gjetur shërbim/punë. Një mundje për Europën e tërë.

Te kjo ndodhje kritike, edhe ndihma e Shtetit Italian për kulturën e Pakicave Gjuhësore Historike u zvogëlua shumë, pothuaj shtërhoi. E *Jeta Arbëreshe* ju e buthton: ky është i trejt numër që del "gjashtëmujore e online". Do me thënë se, soteparet, shërbemi me internetin.

Drejtori

ERDOGAN VUOLE FARE IL SULTANO? A CASA SUA! - Si dice che l'assassino torna sempre sul posto del delitto. Così vogliono fare i Turchi con gli Albanesi della Kosova. Per ri-scrivere la storia della Kosova come piace a loro, con le loro mani che ancora gocciolano sangue albanese. Ma da dove gli viene tutto questa sfrontatezza, quando il Mondo intero conosce bene i loro crimini inenarrabili contro gli Albanesi cristiani nei Balcani, durante i secoli XV-XX? Hanno ragione gli Intellettuali Albanesi, dovunque si trovano, a sottoscrivere, indignati, la Lettera Aperta dello scrittore Lek Pervizi - diretta alle Istituzioni Albanesi della Kosova e dell'Albania - perché aprano bene gli occhi con la Turchia! Non dimentichino, i capi della Kosova e dell'Albania, che le migrazioni "forzate" degli Albanesi dall'Albania cominciarono proprio nel secolo XV, con le guerre imperialiste turche contro l'Albania libera di Giorgio Castriota Skanderbeg, e poi, con l'occupazione / islamizzazione feroce dell'Albania. La colpa è soprattutto dei Turchi se oggi ci sono più Albanesi "fuori" che "dentro" i confini nazionali dell'Albania e Kosova. Le colpe sono del dominio ottomano e delle dittature comuniste di B.Tito e di E.Hoxha se oggi gli Albanesi della Madrepatria si trovano nella situazione attuale.

E ha ragione anche la scrittrice Vilhelme Vranari Haxhiraj, quando presenta una Petizione alle Istituzioni Albanesi, sia per onorare quegli intellettuali albanesi emigrati nel Mondo, che - scrive - "furono guide del nostro futuro nazionale", che per denunciare il dolore, il lamento di quanti sopportarono carcere e morte, in Albania, sotto la mano sanguinaria di E.Hoxha, e ancora aspettano giustizia. Quando saranno degnamente onorati? I crimini dei Turchi, di Tito, Miloseviç e Hoxha contro gli Albanesi sono scritti sui libri di storia e stampati nei ricordi dei martiri sopravvissuti. Un genocidio feroce, lungo, vergognoso.. Noi Arbëreshë scampammo in Italia, perché li conoscevamo bene i Turchi, e la nostra scelta fu amara, ma saggia. Perdemmo la Patria, ma siamo rimasti liberi e cristiani. E non siamo affatto pentiti per questa scelta.

Anche l'Italia, oggi, sta vivendo una crisi economica profonda. E i paesi arbëreshë si svuotano ogni giorno di più: la gioventù emigra verso il nord, o fuori Italia, per trovare lavoro e un futuro migliore. Ecco, oggi, un brutto destino accomuna i giovani arbëreshë, kosovarë e albanesi: la Disoccupazione. Ci troviamo davanti ad una "emigrazione globale albanese" alla ricerca di lavoro. Una sconfitta per l'Europa intera.

In questa situazione critica, anche l'aiuto dello Stato italiano per la cultura delle Minoranze Linguistiche si è ridotto notevolmente, quasi è agli sgoccioli. E *Jeta Arbëreshe* ne è la testimonianza: questo è il terzo numero che esce "semestrale e online".

Vorrà dire che, d'ora in avanti, lavoreremo con internet.

Letër e hapur Institucionevet të Kosovës dhe të Shqipërisë

(vjen nga faqja 2)

përgjatë asaj periudhe të gjatë, ka pasur vrasje, shfarosje, dhunë të vazhdueshme, ndërkohë që shqiptarët ishin populli më i persekutuar i Perandorisë.

Të mos harrojmë faktin se nga të gjitha gjuhët e të gjithë popujve të pushtuar nga osmanët, gjuha shqipe u ndalua në mënyrë të veçantë e me forcë. Mjafton vetëm ky fakt për të treguar gjenocidin e Perandorisë osmane kundër Shqiptarëve, kundër kulturës dhe identitetit të tyre. Por si mund ta fshehim diellin me shosh kur 7 marsi, dita e mësuësit, na kujton se në sajë të largpamësisë kulturore dhe bujarisë politike të Perandorisë osmane mike (siç!), vetëm më 7 mars 1887 Shqiptarët arritën ta hapin në Korçë "Mësonjëtorën e parë shqipe"? Për fat, ndryshe ndodhi me shqiptarët jashtë kufijve të Perandorisë osmane; dhe Arbëreshët e Italisë që prej fundit të shekullit XVI arritën t'i çelnin në diasporë shkollat e para dhe vatrat e tyre të rëndësishme arsimore, që përfaqësuan inkubatorët e parë të Rilindjes sonë kulturore dhe të identitetit kombëtar shqiptar. Ndryshimet e historisë, që synojnë rehabilitimin e pushtimit osman, përbëjnë një lojë të rrezikshme që hap një plagë të thellë në ndërgjegjen tonë kombëtare.

Ndryshimet e historisë me ekspertë turq përbëjnë një agresion kulturor që godet shtyllën kurrizore të kombit, ato janë një fyerje e papranueshëm për shqiptarët dhe me pasojë për të ardhmen dhe identitetin e tyre. Të gjithë tashmë e dimë se çdo ndërhyrje në histori sipas skenarëve të paracaktuar politikë cenon ADN-në e Kombit Shqiptar.

Ne kemi dëshiruar dhe dëshirojmë që marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe turqve dhe shteteve të tyre respektive të jenë miqësore, të sinqerta dhe në interes të ndërsjellë të popujve tanë.

Dhe në emër të kësaj të vërtete, Ne i kërkojmë qeverisë së Kosovës, Kuvendit të Kosovës, institucioneve përgjegjëse kulturore dhe akademike si dhe historianëve, që të mos e tradhtojnë ndërgjegjen e tyre profesionale dhe kombëtare;

Njëzet vjet bashkë

Angelo Matrangelo
mësues, ka Firmoza (Cs)

Të shtunë njëzet e pesë të majit, Bashkia e Shën Mitrit i hapu dyert Festivalit (Rasenjës) njëzetvjetor të folklorit e kulturës pir vlerimin të Pakicavet Etnike.

Tek anfiteatri të katundit, skollat të shumta të pakicavet u gjëndëtin bashkë e me kostumet shumëkulluresh kënduan e vallëzuan.

Mbrëmja që e shkëlqyer, djemt tanë me muzike e simbole vunë në dukje historin e tyre, bujarin të rrënjëvet. Qëllimi i Rasenjës është ai t'i mbjedh gjithë bashkë e t'i lidhinj në ëmrin të miqësisë e të vllëzërisë.

Skolla jonë merr pjesë ka tetëmbëdhjetë vjet tek kjo ngjarje, e kjo është e mundur vet pir urtësin e zellin të drejtuesëvet skollor të ndryshëm, që njëri pas tjetrin gjatë vitravet siguruan mbrënda POF-it realizimin të projekteve që vë pirpara të zbulosh njetir herë rrënjët të vjetra.

Mos të farromi se ndir këta vjet shurbian bashkë me Skollin aq Bashkia sa Familjet, që vanë ngaherë prapa këtyre protagonistëve të rinj, kudo ata dhanë shfaqje. Tek e njëzeta Rasenjë Skolla e Fallkunarës pati të dytin vend pir më të mirin shfaqje, edhe se kjo njohje nëng i përgjegjet të virtetës: pse ndose komisioni kish gjegjur tifozerin, rezultati do të kish qënë ndryshe.

të rishikojnë këtë vendim arbitrar dhe tërësisht antikombëtar; të anulojnë punën e komisionit të përbashkët ndërshtetëror për rishikimin e historisë së Shqipërisë; dhe të lejojnë historianët të bëjnë punën e tyre të pavarur shkencore, sipas parimeve dhe metodologjisë së shkencës historike dhe jo sipas interesave, urdhrave dhe vullneteve politikë të qeverisë së sotme të Turqisë.

Lek Pervizi

(Kjo Peticionë do nënshkruar ka gjithë Intelektualët Arbëreshë e Shqiptarë. E revista jonë, që Turqvet ja këndo i tek Editoriali i numrit 74, e nënshkruan me gjithë zëmër) (Drejtori)

Jeta  **Arbëreshe**

Semestratale online di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtëmujore online e Shoqatës Kulturore "Jeta Arbëreshe", Purçill / Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**
Drejtori, Redaksí dhe Administratë / Direzione, Redazione, Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)
Tel. (+39) 0981-32539 / e-mail: jetarbreshe@libero.it
sito internet - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Ku dërgohen-dhurohen turrësë / Versamenti e Donazioni: sul ccp. n.12994760, intestato all' "Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina/Purçill (Cs)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografí, edhe ndëse s' botohen, nëng priren prapë / Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtoría nëng është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Nj' vjaxh kullturor i bukur ka Atdheu i prindërvet tanë

Shoqata jonë “Bashkë”, me shoqatan “La Fenice” të Frasnitës, organixarti, ndër 2 njera ndër 8 të majit, nj' vjaxh/udhëtim kullturor i bukur nd' Shqipëri, si ndër Atdheut ç' ka pak bëri Festan e Qindvjetorit për lirinë ka Turku, ç' për më se pesëqindvjet, pas ç' vdiq eroi in Skanderbeku, a mbajti suçk. Kle vartet nj' esperjënxe a paharruar dhe emocjonante ç' dua t'a r'fianj. Bashkë me ca miqë, ja shtatë katunda arbëreshe: Pllatëni, Frasnita, Ejanina, Çifti, Shën Vasili (me Sinkun e tij dhe me ca katundarë t'atij), Ungra, Spixana, me nj' mik ka Allumunta e me nj' mikaz ka Manduria, u nistim me pustallin tanë dhe natan, Brindis, muartim tragetin ç' manatat na qelli Vlorë. Kur pami, pre s' llargu, atët çitatë na harepsi zëmra sepse kisham arrivuar ku u nistin, motit, prindët e tanë për t' sallvothshin ka armiku i lig ç' doj t'i vrini. Pas ç' u kallartim, u nistim për Arxhirokastrin e atjè vizitartim Kastjelin e Pirros dhe t' Aliut Pascià; psana vam Berat, pam Kalajan (Kastjelin), vam ka Muzeu ikonografik i Onufrit dhe vizitartim klisban ortodosa e Shën Spiridionit. Atjè zoti na priti me mirësi dhe, bashkë, kënduam me atë, arbërisht, *Krishti u ngjall*, dhe grek, *Kristòs anësti*. Shqipëria është vartet a bukur për naturan dhe është shumë interesante për gluhan, për kullturan dhe për historinë e vjetar ç'ka. T' ditan ditë, psana, vam Tiranë, ç' është çitata kriesore e gjithë Shqipërisë dhe lloku i Guvernit centrall shqiptar. Atjè vam e vizitartim Sheshin e Skanderbekut, me statuan e tij mbi kalin; bulevardin, ku dukan pllesat e Guvernit; moskën dhe klisba ortodosa, ditan e Pashkët Ortodòsvat (ndër pesë të majit), dhe mbrënda kënduam, njetar herë, Krishti u ngjall dhe Kristòs anësti. Grupi, psana, bëri nj' pasjät ndëpër Tiranë dhe pa pllesa t' rea, si Sky Tower (Turra e qiallit), me llürtmun pjan ç' xhiraran, ku duki gjithë çitata, dhe shumë negoxa t' bukurë. Pas ç' iktim ka Tirana shkuam dhe qindruam Lezhë, ka varri i Skanderbekut, ku mëpar ish klisa e Shën Kollit, e atjè i shtum, atij, di vjersha si dhuratë. Pasmjesditës arrivuam Shkodër, çitatë a bgat dhe shumë a gjall, ku ishan e na prisjan miqët e Shoqatas Italia - Albania, ç' na shoqëruan ka Kastjeli i Rozafas dhe mbi lucan e Shkodras. Muartim nj' kafë bashkë dhe dicà shok t'urta t'asaj Shoqatas, ç' na dhan nj' mikpritja a ngroht kur xun se isham Arbëreshë. Me atà foltim për kullturë dhe për bashkëpunim. Shumë interesante kle dhe përpjèkja ç' pat'tim me Sinkun e Shkodras, Lorenc Luka, ka studi i tij, dhe me Munsinjurin/Peshkopin e asaj çitatë, Imzot Angelo Massafra, arbëresh ka San Marcani. Nd' fund, vami ka monkat sallezjane ç' na nderuan me dica kënga dhe me valla, bënur, me ndiemja ka kriaturët e tira.

Kostandin Bellushi

djâkon e mësues, ka Pllatëni (Cs)

Psana, ka nj' sallon e Klisbas së Zonjas Shkodra, Grupi teatralli i Shoqatas Kullturall “La Fenice” të Frasnitës, “Arbreshando bashkë për ju”, bën di komedje, *Racjunza* dhe *Një mbrëma tek llòxha e ndrikullis Ndonetë*, ç' shkruajti prof. Vincenzo Bruno, ç' i pilqjan shumë gjindjas ç' mbluan lokallin dhe u shallartin gaz. Manatat e 7 t' majit vam Durrës dhe pam Anfitheatrin Roman. Natan, psana, u nistim me tragetin ka porti e u pruartim nd' shpit plot haré dhe me nj'entuziazm i madh për t'bukuran esperjencë ç'bëm ka Atdheu inë. Faleminderit gjithë atira ç' muartin pjesë!

Jeta Arbëreshe

(11 vjet: 2002 - 2012)

74 numra, 1.472 faqe

Gjuhë, Letërsi, Histori, Folklor e Lajme
ka Arbëria e ka Bota Shqiptare

450 euro

(për Institucionat, 650 euro)

Gjithë 74 numrat në DVD

50 euro

(për Institucionat 100 euro)

Cep. nr. 12994760 - Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina / Purçill (Cs)

Ndihni

Jeta Arbëreshe

cep. 12994760

Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe”
87010 Eianina / Purçill (Cs)

Skolla e Shën Sofisë fjet arbërisht, po jashtë fjasen gjithë lëtisht!

Lucia Cardamone

mjështel arbrishti, ka Shën Sofia (Cs)

Simbjet, për të paren herë, tek Skolla Parësore të Shën Sofisë, zëmë e mbësueu arbërishtjen menatet e jo më dhesperherë, si bëjim parë me projektet të financuar ka Ministeri. Si bëmë? Muartim oret për arbërishtjen ka pjesa e kurrikullit e vendit (llokut) e bëmë dy orë mbësime ndë javet nga kllasë. Mbësueu gjuhen e edhe zakonat, historin e të tjerat, xhu si bëhet me nj'jeter gjuhë ndrishë ka talliani. Për gjithë këtë, kam të falenderomi Drejtorin e Skolles tonë, prof. Eugenio Broccolo, që dish me shumë fuqi sa të bëjim këtë. U vete te gjithë kllasët, kështu si bën ajo që mbësion Nglizin, e i mbësionj gjuhen tonë skolleëve, po janë vërteta pak ata që e njohen. Më të shumet fjasen itallisht o kallabriz, Jasht ka skolla nëng gjegjen djalëra që fjasen "si na", e kështu nëng vete mirë. Arbërishtja është për ata një gjuhë e huaj. Prindët e skolleëve janë të gëzuar se të bilët mbë skollë mënd xënë gjuhen tonë, po nëng sosen: mos nëng e fjasen edhe ata mbë shpi, Skolla nëng mënd bënj mirëkul.

LA SCUOLA DI S.SOFIA PARLA ARBËRESH, MA FUORI PARLANO TUTTI IN ITALIANO!

- Quest'anno, per la prima volta, nella scuola Primaria di Santa Sofia d'Epiro, abbiamo iniziato a insegnare l'arbërisht di mattina e non più di pomeriggio come facevamo prima coi progetti finanziati dal Ministero. Come abbiamo fatto? Abbiamo preso le ore per l'arbëresh dalla quota di curriculum locale e abbiamo fatto due ore di lezione alla settimana in ogni classe. Abbiamo insegnato la lingua, le tradizioni, la storia ecc., proprio come si fa con un'altra lingua diversa dall'italiano. Di tutto questo dobbiamo ringraziare il Dirigente della nostra scuola, prof. Eugenio Broccolo che ha voluto fortemente che attuassimo tutto ciò. Io vado in tutte le classi così come fa chi insegna l'inglese, e insegno la nostra lingua agli alunni ma sono davvero pochi quelli che la conoscono. La maggior parte di loro parla italiano o dialetto (calabrese). Al di fuori dalla scuola non senti bambini che parlano la nostra lingua e così non va bene. L'arbërisht è per loro una lingua straniera. I Genitori degli alunni sono contenti che i figli a scuola possono imparare la nostra lingua ma non basta: se non la parlano anche loro a casa, la Scuola non può fare miracoli.

Vende

Motimadh / Mario Giuseppe Miracco

kok skollje, ka Shën Sofia (Cs)

Jeta nëng ka peng, kur çahet së ndërrohet, ne njeri t'ë ndreqen.

Ai burr që s'u gëzua te jeta tij, ai jeten kërdir se e blejti te "ipermarkati" si një televizion, me peng, se ndë çahet ja ndrrojen o ja ndreqnen, e zë paguan ngapu gjashtë muaj me kambël.

E sëreren e sotem kët rrubullion që na shesen per dhjetë urre, pa kërdirtur mundësi, kjo shortë lërije që na llargon ka kjo vërtet pa vende.

Jeta na llargon ka vendet, si mbrazen vendet, sa vende të mbrazur, pse mbrazen vendet?

Asaj lloxhët pa trandofile, ai shësh pa djale, ajo gjitoni pa gjiton, nëng sosen të kultoç motin i par; si e rrëfien një vend i mbrazur njij diali i sotem?

Edhe ndallanisha ndërroj vend, s'e bën më fole nën asaj qaramidhe, ndighet e bjerrë pa at rrubullion që armonisnij at vend.

Atë që nëng kam jan fjalat tënde, më moti shkon më mëndimat ngjaten, ti shkruam fjala të bukur, ti shkruam, shkruam di fialë te një fiet kartë, fjalë arbëreshë shkruam: anangasu, shkruam!

Kur erret e arrvon nata, gjumi të rrëmben, trut vullarnjen tue kërkuar ata vende, nj'ënderr e ëmbel të pështill, të merr për dorje, të qell te një vend, ku së qeve, që së mban mënd, po ai vend të fjet.

Te praku deres një jëmë këndon djalin te diepi, një valtim me ato fjal piot urat e mall: fjala mëmes, ajo që së më vini nxë, të ja këndoja birit im.

Ffalet të dashruara, shkruan, vashza e ulet te sjeti, t'ëmbëla e të lea, ja rrëfien nana, si një të puthur, e vashza pien: ma që vjen me thën?

Prapa menxaportit jan garareshe: dy gra të njoghura, njera tier, jetra argalisen; e kur zgjetza vete, një këndim i ghoill luten të parin mall.

Ka ruga ngjitet ajo puhji e dushkut që frin ndë Arbëri e sill frishiin, nd'ato dit vapje, e gjitonia façon te sheshi, kackadhjarja zë e rrotar me dy vajza, një par ganjun zën e bredhen sheghura.

Me një përhejmje ngjitet ka llavina si një e qeshme shkatinjolle, që mbjon rrëmurin e rughes e një vjersh i kënduar te ajri është një vjersh mbe gjysëm, e ëndrrja fërnon, gjumi çaghet, e jeta të vjon pa pritur nj'ënderr i ri te njeter vend.

Një mbron i fatàjtur

(mbjoth) **Carlo Trupo**
ka Farneta (Cs)

Ish një her një mbron i fatàjtur e manatet e Pashkëvet vate jasht e bëri një fashin me shkajpa; kur i bëri, ju vu sipar asaj fashins e i tha:

- Nani qellam më shpitë!

Ajo fashina u ngre ka dheu e vej ta qellnaj më shpitë.

Ish e shkonej pijpara shpis rregjit, kur ka një dritsores a pa një kupile që ish bashk me të bilan e rregjit; e, si pa atët mbronin, i tha të bilës e rregjit:

- Ruaj, ruaj si ajo fashina qellan kaluar atët mbronin!

A bila rregjit vu kriot mb'llajt e u vu e qeshnaj.

Kur a pa Tarondi – kështu ja thojn atihj mbronit, pënxoje me kriot e tij:

- S'bën t'kishnja u një bir ka a bila rregjit?

Ditan vate më shpi. Kur shkoj ca mot, a bila rregjit pat një bir pa fare që s'dij kush i ishna jati. Kur i biri kish një çik i rritur, rregji pënxoje:

- Ndë u i thërres gjith njezëvet që jan ka kto an, e bën të vinjan të han e të pijn, bën t'jet se gjaku i thërret gjakut e im nip bën t'jet se nje kush është jati.

Tarondi asaj ditje s'dish vej më trias; e jëma, tua i thënur fjal'liga, i thoj:

- Ec, ec ka jan e han, ktu ke sullu buk e that, e ka triasa rregjit gjën gjith atë që donje.

Tua i thënur fjal'liga, belu belu vate m'trias.

Si hiri, a pa i nipi rregjit e vate e ju ul ka glunjët, e thoj:

- Tatarà, tatarà, ki është tata im!

Kur gjegji kështu, rregji qindroj e pënxonaj:

- Bën t'jet se ka gjithë kta njeriz, justu ai mbroni është jati tim nipi?

Ai kriaturi më rrij e më a thoj, e rregji s'pat fare një që të bënej.

Kur shkoj ca mot, u majtuan e rregji i tha të biles:

- Ai është it shoq e u s'bën e mbanj një mbron ka shpia ime, po u të lëshonj ata dherat që jan ka Fikarroni me atët shpin, e rrij atjè.

Tarondi muar të shoqen e vate mbet ka Fikarroni. Njëj mbrëmje, kur ishin e hajn, a shoqja i tha Tarondit:

- Ti pate vijtuten që u bën a pata një bir ka ti! Pse s'bën a bëhet qjo shpia një pëllas më i mir se ai ja tatës?

Tarondi mbet qet një çik e psajna tha:

- Donja se qo shpia ka t'bëhat më e mir se ajo ja rregjit!

Ashtu ajo shpia u bë më e mir se ajo ja rregjit; e nga ca mot a shoqja i lipnaj një kund njera kur ishin e hajn, e i tha:

- Pse nëk bëhe dhe ti një bukur trim?

Dhe ashtu dhe ai u bë një bukur trim.

Njëi ditje rregji me dica shok vate a kaça prej Fikarronit e, kur vran një par lepura, njëri ndi ata burra i tha rregjit:

- Vemi ndutu e i pjekam ka ai pllasi që duket?

I tha rregji:

- Ec e vrej ndë bën t'vemi e a ham atjè, se u ka ai pllas nëk a di fare kush rri.

Ai burri muar e vate ka ai pllasi e kur arrvoj, par se t'i bij dejs, një voxh i tha:

- Hir, hir!

Si hiri, njetar voxh i tha:

- Ulu, ulu!

Psajna një qelq i tha:

- Pi, pi!

Ashtu u babàr e nëk vate ka rregji.

Ai priti ca her e, kur pa se s'vinaj, muar e drigoj njetar. Shkoj më ca her e dhe ai jetri nëk priraj; e kur priti një bukur çik, ai rregji tha:

- Ngana e vrenjam pse ata s'vinjan! Heraher është ndonj frushkul që i ha...

U nistin e she ata kur arrvun pijpara dejs, një voxh i tha:

- Hini, hini!

Psajna, si hijtin, sexha i tha:

- Uli, uli!

Qelqi i tha:

- Pini, pini!

E kur shëkoj një çik, pa ata të tjejt shoq me t'bilan e tija, u qas afar e i tha:

- Ti që je e bën ka ki pllasi?

Ajo vashëza i tha se ktët shpin kish e a bënur Tarondi e se rriji shum kutjend ka i shoqi.

Psajna muajtjn e hëngtin ata kunilët e pijtin sa më dishtin.

ALFABETIZZAZIONE ARBËRESHE

(Abetare, Gramatikë, Histori, Letërsi, Folklor, Rit, Muzikë, Glosar)

2 libre - euro 5,30

(editor Shoqata Aiadi, Ungër; botues "Il Capitello", Torino 2000;

Redaktorë: I.C.Fortino (koordinator), V.Bruno, A.Giordano, papas E.Giordano, C.Stamile, E.Tocci)

**Telefononi Antonio Uberti-t
0982 - 582241**

Vasha e Vjershe

Tërëzi

Tërëzi, kalò këtù poshtë
e ej më zëmbullì
kjò hënzë që isht prëmë
isht a bukra si gjall ti.

Ni shkon nji marasháll
më thot që bën a këtù
fërmonj Tërëzinan e jima
që isht a bukra si gjall u.

Tërëzi, kalò këtù poshtë...

Ti ke nji si dhë kërstellë
u a kam dhë kulumbri
kuqohëmi né të di
e ngë shkataromi mosnjari.

Tërëzi, kalò këtù poshtë...

Ti ke dhambët si gjall nji rrashqël
u i kam si gjall nji rrataviej
kuqohëmi ne të di
e ngë shkataromi mosnjari.

Tërëzi, kalò këtù poshtë...

Ti ke hundën si gjall nji lënar
u a kam si gjall nji paljar
kuqohëmi në të di
e ngë shkataromi mosnjari.

Tërësi, kalò këtù poshtë...

Tërëzi, Tërëzi, Tërëzi,
që u kuqiuotëm né të di
nji vukalet dhë ver
e rrimi bashkë dica herë.

A Teresina

Teresina, scendi giù
e vieni ad aprirmi
la luna che c'è questa sera
è bella come te. (*ritornello*)

Adesso passa un maresciallo
mi chiede cosa faccio qui,
aspetto la mia Teresina,
che è bella come me.

Teresina, scendi giù...

Tu hai un occhio di cristallo,
io ce l'ho come prunello,
uniamoci tutti e due
e non guastiamo nessuno.

Teresina, scendi giù...

Tu hai i denti come un rastrello,
io li ho come una marra,
uniamoci tutti e due,
e non guastiamo nessuno.

Teresina, scendi giù...

Tu hai il naso come una lucerna,
io ce l'ho come un pagliaio,
uniamoci tutti e due,
e non gustiamo nessuno.

Teresina, scendi giù...

Teresina, Teresina, Teresina,
come ci siamo uniti tutti e due,
un boccale di vino,
e stiamo insieme un pochino.

(mbjodhi) **Zef Beccia**

avokat, ish-kryetar i Kazallveqit (Fg)

Arza manusaqe

Ishtë si gjall një arza manusaqe që
rrunxon,
që gjith lulet sukun.
Nga nji trim i bukri që sitë shonjn,
ajò dharasu ma hundën a duron.
Kur rri ta shpia bën ndën e sipër,
ai që a merr, pë ta mbar,
kapistrin ka t'i vër.

L'ape viola
(= l'irrequieta)

E' come un'ape viola che ronza, e
che succhia tutti i fiori.
Ogni bel giovane che gli occhi
vedono, quella da lontano con il
naso lo odora.
Quando sta in casa è sempre
irrequieta; colui che l'avrà, per
trattenerla, le dovrà mettere la
cavezza.

Një qepsëz

Një vajzë ngë dishi nji trim psë ki
ishi puntor.
Trimi ja këndoi kështu:
O e shkreta bilja dhë qepës,
oj bukura qepsëz,
kur na vëhmi ta trieza,
ti ruan steljat .

Una sartina

Una sartina rifiutava un giovane
perché questi faceva il coltivatore.
Il giovane gliel cantava così:
O povera figlia di sarto,
o bella sartina,
quando noi ci sediamo a tavola,
tu guardi le stelle.

Një vajzë e urtë

Kishi një gunë.
Dhë mbrëma a ljai.
Dhë natë a ndei.
Menata pas a vëi ngrah.
Kishi gjith-herë hijë.

Una ragazza virtuosa

Aveva un vestito.
Di sera lo lavava.
Di notte lo stendeva.
Il mattino dopo lo indossava.
Era sempre elegante (= attraente)

Vasha e Vjershe

O ti Mari

O ti Mari, ndë do viç me né,
o ti Mari, ndë do viç me né,
o ti Mari, ndë do viç me né,
tata e mëma kan shumë haré.

O Nduniëtë, o paqanë, o trëngënë
t'et shoqa ku më a lé.

Ngë mund vinj pa vëndrë kurorë,
(3 herë)
psë ngë ndurisnj mangu një orë.

O Nduniëtë...

E ni çë arren ta 'jò staciun, (3 h.)
prir nji si ka ki katund.

O Nduniëtë...

Vajta l'Amerkë e to'qa nji dhëmb,
(3 herë)
kur çë erdha ma nji këmbë.

O Nduniëtë...

**Shprishni
Jeta
Arbëreshe**
ndër miqtë
e
ndër gjiritë



Përrallaz e Poezi

(te mbjedhura ka) **Mario Massaro**
profesor, ish-kryetar i Qeftit (Fg)

Përrallza e birit dorëlëshuar

Një burrë kishi di bij. M'i vogli i tha jatit:

- Ta, jëm atë çë më nget.

E ai ndajti gjërin ndër 'ta. Pas pak ditë i biri m'i vogël vuri gjithë bashkë e vaiti uz te një horë gjatë, te ku, tua bënë një gjellë e lig, sosi gjithë atë çë kishi. Kur sosi gjithësej, te ajo horë qeti një vit i lig e ai zuri fill t'ishi i mjer. Atëhera vajti uz e u vëh të shurbei te një burrë t'asaj horë e ai e dërgoiti te dherat t'atija pë të ruoji dirqit. E kishi mall të mbushi barkun me lëndet çë hajën dirqit, po mosnjari ja jipi, e kishtu hiri ndër vet e tha:

- Sa sërëvëturë te shpia tatës ime kanë bukë sa duonjën e u këtu jam e vëdes pës pa ngrënë! Ngrihem e vete te tata ime e i thom:

-Ta', bëra mëkat kundru qjellës e kundru tija, ngë meritonj të jem thërritur it bir; mbam si një sërëvëtur ka joti.

E u nis të veji te jati. Kur vet ishi gjatë, jati e pa, ju dhëmb zëmbra, i dolli përpara, ju drit ngrah e e puthi. E i biri i tha: - Ta', bëra mëkat kundru qjellës e kundru tija, ngë meritonj të jem thërritur it bir.

Po jati i tha sërëvëturvet:

- Bjeni shpejt petkun më të bukur e vishnie, e vëni një unazë te gishti e këpucët te këmbët; pëstaj mirri një viç i majmë, vrinie, hami e bëmi festë, pse ki im bir kish vdekur e u ngjall, u kish bjer e u gjënd.

E zurën fill të bëjën festë. Po i biri m'i madh ishi jashtë: kur erdhi e u gas te shpia, gjegji të bjejen e të këcejën. E thërriti një sërëvëtur e pjethi ç'ishi kjo. E ai ju përgjegj:

- Erdhi it 'ullà e it at bë t'e vrvën viçin i majmë, pse e pa të gjalltë e mirë.

Atëhera ai u mbjet lig e ngë dish hiji. Po jati dolli jashtë e zuri mbë së mirë pë të hiji. Po ai ju përgjegj e i tha jatit:

- She', u të sërëvirta kaq vjet e bëra gjithë motin atë çë më the, e ti ngë më dhe kurrë një kaciq pë të bëja festë me shokët time; po nani çë erdhi ki it bir çë sosi gjithë gjërin me gra të liga, ti vrave p'atë një viç i majmë.

E jati i tha:

- Bir, ti je gjithë motin me mua e gjithë gjëri im isht edhe joti; po nani duhet të bëmi festë e hare, pse ki it 'ullà kish vdekur e u ngjall, u kish bjerr e qeti gjëndur.

(E prori arbrisht Vincenzo Rogato, mjeshter skollje qeftjan, te viti 1966)

www.agm.calabria.it

Përrallaz e Poezi

Mallpenxi

Ishi një e kush na ishi? Ishi një jëmë e një jat që kishën një bir që i thojn Malpenxë. Nani jëma vdiqi e jati u martua popa me njetër grua. Kjo mbaji kumbarin!

Një ditë Malpenxi i tha jati ke kish qeji një bar dru të ciptuora së njerksës. E kishtu ngarkoiti vëturën e vajti uz. Erruri te shpia e tucuoiti: tung, tung. E njerka i tha kumbarit që ishi prëzë asaj:

- Vëhu, vëhu ndën shtratit!

E vajti t'i hapi Malpenxit.

- Çë ke, Malpë?

- She, e tha tata, prura një bar dru ke ka' t'i vë ndën shtratit.

- Mirë! Lëji këtu ke i vë u.

- Jo, tata më tha ke ka' t'i vë u te vendi.

Mori barin e druvet të ciptuora e i dërviti gjithë te fjanget e kumbarit e ai bëji:

- Ov! Ov!

- Çë isht, më', ndën shtratit?

- Isht një qen. – ju përgjegj ajo.

Malpenxi shkarkoiti gjithë drutë e vajti uz. Kumbari dolli ndën shtratit me fjanget të pundënuora.

Njetër ditë Malpenxi i tha jati ke kish qeji një par mastjele gur së njerksës. Ngarkoiti mastjelet e vajti uz te shpia. Kur e pa e njerka u mbjet, po ai hiri e tha:

- She, të prura gurët e ka' t'i dërvinj te fuseta. Ka' t'i dërvinj u, tha tata.

Te fuseta ishi kumbari! E gurët kalojën cëkun cëkun te kurrizi kumbarit e ai bëji ov! ov!

- Çë isht, më'?

- Isht ndonjë çinxhë e vjetër.

Sa Malpenxi dolli te shpia, dolli edhe kumbari te fuseta.

- Ndrikullë, dje Malpenxi më spundënoiti fjanget, sod më çaiti kurrizin. Ndë isht kishtu u ngë vinj më!

Shkojtën di ditë e Malpenxi u pror te e njerka.

- Më', prura një thes kasht e lagët ke ka' djeginj kamënen.

- Lëj, ke e bënj u.- tha ajo.

- Jo, tata tha ke ka' t'i vë u zjarr.

Ajo dish miri nge, pse kur pa ke viji Malpenxi i tha kumbarit të vëhshi brënda vatrës. Malpenxi që e diji tha:

- Jo, ka' t'e bënj nani pse tata më pret.

Si zuri zjarrë, kashta ç'ishi e lagët nxiri më tim ke lambë e kumbari bëji "pr., pr."

- Më'! Çë isht te vatra?

- Eh! Janë cëkulunët. – u përgjegj gruoja.

Pas që e sfumëkjoiti mirë mirë, Malëpenxi vajti uz.

Malpensante

C'era una volta una mamma ed un papà che avevano un figlio di nome Malpensante. Morì la madre ed il padre si risposò e prese un'altra moglie. Questa aveva il compare!

Un giorno Malpensante era in campagna col padre e gli disse che doveva portare un carico di legna appuntita alla mamma. Caricò il cavallo ed andò a casa. Arrivò e bussò:

- Tunc, tunc.

La matrigna che era in compagnia del compare disse a costui di nascondersi sotto al letto ed andò ad aprire a Malpensante.

- Che cosa c'è?

- Vedi, l'ha detto papà, ti ho portato un carico di legna che devo mettere sotto il letto.

- Bene. Lasciala lì che la metterò io a posto.

- No, papà mi ha detto che devo sistemarla io.

Prese la legna e la gettò tutta sui fianchi del compare, che faveva "ov! ov!"

- Cosa c'è mamma?

- C'è un cane. – rispose la matrigna.

Malpensante scaricò ed andò via. Il compare uscì da sotto il letto con i fianchi doloranti.

Un altro giorno Malpensante disse al padre che doveva portare un paio "di mastelli" pieni di pietre alla mamma.

Caricò i mastelli ed andò a casa. Quando lo vide la matrigna rimase meravigliata. Malpensante entrò e le disse:

- Vedi che ti ho portato due mastelli di pietre che devo buttare nella fossetta, così mi ha detto il babbo.

Nella fossetta c'era il compare. "Tum, tum" cadevano le pietre sulla schiena del compare che faceva "Ov!, Ov!".

- Cosa c'è, mamma, nella fossetta?

- C'è forse qualche pezza vecchia.

Appena Malpensante uscì di casa, anche il compare uscì dalla fossetta e disse alla donna:

- Comare, ieri Malpensante mi ha puntellato i fianchi ed oggi mi ha rotto la schiena. Io non vengo più.

Trascorsero due giorni e Malpensante tornò dalla matrigna.

- Ma'! Ho portato un sacco di paglia bagnata perché devo bruciare la fuliggine nel camino.

- Lascia, che lo faccia io.

- No, papà ha detto che devo bruciarla io.

La matrigna voleva prendere tempo, perché quando vide che stava arrivando Malpensante aveva detto al compare di nascondersi nel camino. Malpensante lo sapeva e disse:

- No, devo farlo io adesso perché papà mi aspetta.

Appena mise fuoco, la paglia che era bagnata sprigionò più fumo che fiamma. Intanto il compare faceva "Prr, prr".

- Ma'! Che c'è nel camino?

Përrallaz e Poezi

Kur dolli kumbari i tha ndrikullës:

- Ndrikullë, ngë vinj më, ai isht e më vret. Eja ti te u.

- Vinj të djel. – i tha ndrikulla.

Kur erruri e djela menatë, gruoja vravi një gjel, bëri makarune, mori një butjun verë, i vuri te një shportë te koça e ishi e veji te kumbari. Si eci pa Malëpenxin:

- Më! Tata isht e vjen prapa tija pse ka të vras.

- E pse?

- Ng'e di, isht e merr gjithë gurët që sheh te rruga.

Ajo që kishi zëmbren ca e zezë, ngriti gunën e iku.

Malëpenxi ngë bori nge, vajti edhe te kumbari e i tha:

- Kumba, tha tata ke huom çetelen.

- Çë ka' t'e bënj?

- Më tha ke i duhet ke ka' të t'pres vesh.

Kumbari kur gjegji kishtu mori e iku. Si iki pa jatin e

Malëpenxit që ngë diji mosgjë.

- Kumba, ku vete? Eja këtu!

- Jo, ke ti më pret vesh! U një herë vajta te ndrikulla!

Gruoja iki përpara, kumbari prapa, jati i vareji e ngë kapirij mosgjë e Mallpenxi hëngri makarunet me gjelin e pivi edhe butjunin me verë.

(Rrëfjejt): Pizzuto Giuseppina, nga Qefti, 82 vjet, grua shpije, mësim elementar. Datë regjistrimi: 15 fjavar1966)

Mëmza ime

Mëmza ime, zëmbra sa m'u plas

e m'u bë trezet e dhjet pjesë,

sitë e mi t'panë një bukur vajzë:

ajo më mori më të madhin pjesë.

U, pë t'i veja prëzë, i vajta pas

e i thaç: -Zëmbra ime, pë tija vdes!

Ajo më bëri buzën mbë gazë

vashojti sit e iku si varë.

Gjegj që të thom, mëma ime:

u dua vashën që mori zëmbren ime!

Thoi mëmës saj sa e do mirë,

ke ti je plake e do t'ja mbaç si bijë.

Mos i lip jo pajë e jo stoli,

u mund e rronj ke jam trim i ri.

Ndë prindi i saj të thot ke jo,

u pëstana e puthin.... 'È të vinj që do!

Ec, ec, mëma ime, e u të pres.

Mos ti ngë do veç, u vdes!

Mamma mia

Mamma mia, il cuore mi è scoppiato / e mi si è fatto
in settanta pezzi:/ i miei occhi hanno visto una bella

- Ci sono i topi. – rispose quella.

Malpensante affumicò ben bene il compare ed andò via.

Quando il compare uscì disse alla comare:

- Comare, io non vengo più perchè quello mi sta uccidendo. Vieni tu da me.

E la donna rispose: - Verrò domenica.

Quando giunse la domenica, la comare uccise un pollo e fece i maccheroni, prese un fiasco di vino, mise tutto in un cesto sulla testa ed andò via. Durante il cammino incontrò Malpensante che le disse:

- Ma! Papà sta venendo dietro a te perchè ti vuole uccidere.

- E perchè?

- Non lo so. Sta raccogliendo tutte le pietre che trova sulla strada.

La matrigna che aveva l'animo un po' nero (era in difetto) alzò la gonna e corse via. Malpensante non perse tempo ed andò anche dal compare.

- Compare, ha detto papà di prestarmi l'ascia.

- Cosa deve farci?

- Mi ha detto che gli serve perchè deve tagliarti le orecchie.

Il compare quando sentì quelle parole corse via. Mentre correva vide il padre di Malpensante che, però, era all'oscuro di tutto.

- Compare, dove corri? Vieni qua! - Gli disse il padre di Malpensante.

- No, perchè tu mi tagli le orecchie; io una sola volta sono andato dalla comare!

La matrigna andava avanti, il compare dietro, il padre li guardava e non capiva nulla e Malpensante ne approfittò, mangiò i maccheroni con il pollo e bevve il fiasco di vino.

ragazza, / che mi ha preso il pezzo più grande./ Io per starle vicino, l'ho seguita / e le ho detto: - Il mio cuore muore per te./ Ella mi ha atteggiato il labbro al riso / ha abbassato gli occhi ed è fuggita come vento./ Ascolta quel che ti dico, madre mia: / Io amo la giovane che mi ha preso il cuore./ Tu di' a sua madre che le vuoi bene, / che tu sei vecchia e gliela terrai come figlia./ Non chiedere nè dote, nè gioielli. / Io posso mantenerla perchè sono giovane / Se i suoi genitori ti dicono di no,/ io allora la baceròe venga ciò che vuole./ Va', va', madre mia, ed io ti aspetterò./ Se tu non vuoi andare, io morirò!

*(E mbjodhi, Qefti, Mario Massaro, te viti 1968; rrëfjejt
Nicola Saracino, 82 vjet)*

Idiomatizme e frazeologjizme të Purçillit

(vjen ka nr.74)

(mbjoth) Drejtori

ka Purçilli (Cs)

gjallë (i,e të), agg = vivo808. *s'u bë ne i gjall e ne i vdekur* = non si è fatto né vivo e né morto (non si è fatto vedere/sentire)809. *jam u i gjall e ti qan?* = sono io vivo e tu piangi? (finché son vivo, non hai problemi)810. *e vu t'gjall t'ffjënej* = l'ha messo vivo a dormire (l'ha messo a letto ancora sveglio)811. *e dogjtin t'gjall si kau Frrinjit* (nofkë) = l'hanno bruciato vivo come il bue di Ferrigno (soprannome)**gjas, v.intr = assomigliare**812. *i gjet sikur e vuall ka grika* = gli somiglia come se l'ha vomitato dalla bocca (gli somiglia completamente)813. *i gjet sikur i preu kriet* = gli somiglia come se gli ha tagliato la testa (gli somiglia completamente)814. *i gjet Markurit Nusevet* = assomiglia a Mercurio delle Fidanzate (cambia fidanzate spesso)815. *i gjet Janjit Viçravit* = assomiglia a Giovanni dei Vitelli (è ladro e assassino)**gjegjënj, v.tr/intr = sentire**816. *gjegje, nd' do t'e gegjsh* = ascolta, se vuoi ascoltare (ti consiglio per il tuo bene)817. *kur gegjen ftigen, rëkon* = quando sente (parlare del) lavoro, si lamenta (non ha voglia di lavorare)818. *kur gegj ashtu, ja veshi mënjëth mënjëth* = quando senti in quel modo, sgattaiolò via senza dare all'occhio (??)819. *u gjëgj ka s'ë më jet* = si senti dove non c'è più mondo (gridò talmente forte che si udì dappertutto)820. *gegja nj'vishilât!* = sentii una staffilata! (udii una cosa strana)821. *i nomrën s'biles se t'e gegjenj e reja* = riprende la figlia perché lo senta la nuora (parla in modo indiretto)**gjel-i, sm = gallo gjel-i, sm = gallo**822. *bën gjelthin*, fa il galletto (si pavoneggia, fa il bulletto)823. *kndon si gjel bragat*, canta come gallo raucò (sgradevole a sentirsi)824. *rri si gjeli ndir pulat*, sta come il gallo tra le galline (sta sempre in mezzo alle donne, pavoneggiandosi)825. *ki "i ardhur" do t'bënj gjelin*, questo venuto (da fuori) vuole fare il gallo (questo italiano vuole dominare su di noi)**gjellë-a, sf = vita, esistenza**826. *s'i la menu gjellen e nji ditje*, non gli ha lasciato

neanche la vita di un giorno (l'ha lasciato in fin di vita)

827. *i shuajti gjellen*, gli ha spento la vita (l'ha ucciso)828. *më thartoj gjellen*, mi ha amareggiato la vita (mi ha fatto disperare)829. *foka ë pena gjelles!...*, come se fosse la pena della vita!... (Non è che sei in fin di vita!...)**gjer-i, sm = ghiro**830. *ffjë si gjeri*, dorme come il ghiro (dorme molto)**gjëmb-i, sm = spina**831. *më mir kshtu se nj'gjëmb ndër si*, meglio così che una spina nell'occhio (meglio così che peggio)832. *ësht (rri) ndër gjëmbat*, sta sulle spine (è a disagio; è penseroso, è in attesa d'una notizia)833. *ju vu (e ka) si gjëmb ndër si*, gli si è messo (ce l'ha) come spina negli occhi (è una persona che gli dà fastidio)**gjënj, v.tr/intr = trovare**834. *e gjet'in!...*, l'hanno trovato!... (non è proprio il tipo che fa per loro)835. *atë s'e gjën, tek e lidhen*, quello non lo trovi dove lo legghi (è uno che cambia idea spesso; voltagabbana)836. *e gjet'in t'tastaròst*, l'hanno trovato stecchito (morto)**gjindë-ja, sf = gente**837. *vijen gjind si ësht dita*, vengono gente com'è il giorno (ogni giorno viene gente)838. *ishen më gjind se gjind*, c'era più gente che gente (una folla)839. *jan më gjind se milingona*, ci sono più persone che formiche (sono tantissime)**gjiri-u, sm = parent**840. - *Si vini gjiri? - Shtat bith vllëzrish!*, Come venite parenti? Di sette sederi di fratelli! (siamo parenti lontani / jemi gjiri llargu)841. *janë/vijen gjiri ka triesa/sënduqi*, vengono parenti dalla tavola/cassapanca (sono parenti solo quando mangiano insieme / sono parenti per interesse)842. - *Ka vini gjiri: ka ksula o ka keza?*, da dove venite parenti, dal cappello o dal diadema? (da parte di padre o di madre?)**gjisht-i, sm = dito**

Idiomatizme... të Purçillit

843. *i jep gjishtin e t'marren gjith doren*, gli dà il dito e ti prendono tutta la mano (si prendono più confidenza di quanta gli dà)

844. *ishen sa gjisht t'e dores*, erano quante le dita della mano (erano in cinque)

845. *e lidhi te gjishti*, se l'è legata al dito (prima o poi gliela farà pagare)

846. *e mban si unaz te gjishti (poet.)*, la tiene come anello al dito (la rispetta come cosa preziosa)

gjithë, agg / pron = tutto/i

847. *i ka gjith mb'të*, ce l'ha tutte addosso (è piena di virtù)

848. *gjith ajo t'ish!...*, tutta quella fosse!...(non è un gran problema)

849. *gjith e gjith, po shtrëmbura s'di t'hor*; tutto e tutto, ma bugie non sa dire (tutto quel che vuoi, ma non sa mentire)

(D. / 19 - është më)

Jeta Arbëreshe

(12 vjet: 2002 - 2013)

75 numra, 1.526 faqe

Gjuhë, Letërsi, Histori, Folklor e Lajme
ka Arbëria e ka Bota Shqiptare

450 euro

(për Institucionat, 600 euro)

Gjithë 75 numrat në DVD

50 euro

(për Institucionat 100 euro)

Ccp. nr. 12994760 - Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina / Purçill (Cs)

Gluha ime, sot

Giuseppe Gallo

profesor arbrishti në pension, ka Shën Marcani (Ta)

Fjalë që një herë, si:

brum-i (lievito),

çarlë-a (brocca di vetro),

dash-i (montone),

di-a (capra),

dillë-a (cera),

drapër-ra (falce),

dhjamë-a (grasso per scarpe...),

ka-u/qe (bue),

këpurdhamishël (carboncello),

këpurdhëmbretreshë-a (fungo reale??),

kopan-i (pestello),

krësombullë-a (albicocca di grossa dimensione),

kusi-a (paiolo),

lahurë-a (cicerchia),

linar-i (lumicino ad olio),

lopë-a (mucca),

mafjer-i (coltello a scatto),

majmë(i,e) (grasso),

majmun-i (scimmia),

mësallë-a (tovaglia),

papagjonë-a (specie di uccello),

pelë-a (puledra),

pëtalore-ja (tralcio di vite),

spumulatore-ja (mattrra per fare il pane),

strunf-e (calze),

shtami-a (piccola giara per acqua),

tip-i (martelletto),

trjezë-i (tavola da pranzo),

tumacë-a (tagliatella spessa),

viç-i (vitello),

...e shumë tjera fjalë kanë klënë vënë nde një anë muçur e njori i thotnë.

Gluha ime sot ka marrë shumë fjale ka gluha të katundëve afër jònëti, i ka bërë arbëreshe e, kur i ndienjë, më zjen gjaku perçë ato fjale kanë marrë vendëni të fjalëve arbëreshe për të vërtë.

Gluha ime sot së mëgjon (?) shumë e adhe shumë gluhës të të pleqëve me pa dhëmbe. U e kaponjë, "ma", t'e ndjenje, më jep ndë zëmër përçë shoh se jet e merr atë udhë ku vehët e nën prirët.

LA MIA LINGUA, OGGI - Parole di un tempo, come...(vedi elenco), e molte altre ancora, sono state messe da parte e nessuno più le dice. La mia lingua (arbreshe di San Marzano, ndr) ha preso molte parole dai dialetti di altri paesi limitrofi, le ha arbrescizzate e, quando io le sento, mi si scalda il sangue perché quelle parole hanno preso il posto di parole veramente arbreshe. La mia lingua oggi assomiglia sempre di più alla lingua dei vecchi senza denti. Io la capisco, ma, solo ad ascoltarla, mi fà male il cuore, perché vedo che sta per prendere quella strada dove si va e non si ritorna.

Lutje Jisuit, Zotit tonë t'ëmbël *

(pruar arbërisht) **papas Emanuele Giordano**

ka Frasnita (Cs)

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për ne!

*Këndò e folmë për Atin tënd,
këndimi yt do t'më mbësónjë.
Sepse Ti më dritësove,
o Zot;
për Tij marr Atin,
me Tij, bëhem trashëgimtar:
sepse Ti s'ke turpë
për vëllaun tënd".*

(Shën Klementi i Aleksandrisë)

O Udhëheqës, mbrojtës te lufta,
Zot fitimtar i pisës,
sepse më shpëtove ka vdekja e përjetshme,
këndonj lavdinë tënde,
u, krijesa jote, shërbëtori yt.
Ti, që je i mirë sa s'dihet,
liromë sot edhe nga çdo rrezik,
Tij, kuj u thërres:

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

O Krijues i ëngjëlvet e Zot i fuqivet qiellore,
Ti që të shurdurit pa gojë i dhe të gjegjurit e të folurit,
dritësò shpirtin tim e zgjith gjuhën time,
se të mund lëvdonj ëmrin tënd shumë të dëlirë
e të të prirem Tij me këto fjalë:

O Jisù, bukurì e dritshme, mërakull për ëngjëlit
O Jisù, fuqi e pamundshme, lirim i etërvet tanë
O Jisù, ëmbëlsi e pakufishme, lëvdi e patriarkëvet.
O Jisù, Zot aq i dashur, plotësim i profecivet
O Jisù, admirueshëm te fuqia, lavdi e martirëvet
O Jisù, paqë e shkëlqyeshme, gëzim i kallogjërëvet.
O Jisù, plotë mirëdashje, ëmbëlsi e priftravet.
O Jisù, lipisi e palodhur, gëzim i shëjtravet.
O Jisù, i tërëdëlirë, dëlirësi e virgjërvet.
O Jisù, Ti je ka gjithmonë, shpëtim i mbëkatarëvet.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Kur Ti pé vejushën e këputur ka dhëmbja
i pate lipisi, o Zot,
e i ngjalle të birin
që ishin e qelljen te varrimi.

Ashtu edhe, Ti që do mirë njerëzit,
fortërò shpirtin tim
e kij lipisi për mua që të thërres:

Alliluja

Tue kërkuar të kuptonej të pakuptuashmin,
Fëlipi të tha: "O Zot, buthtëna Atin".
Ti ju përgjegje: "Ka aq mot që jam me ju,
e ti s'më njeh, o Fëlip?
S'ke besë se unë jam te Ati e Ati është tek unë?"
Tij, që je mbatanë çdo kuptimi,
me trëmbje u të thërres:

O Jisù, Perëndi ka gjithmonë e për gjithmonë
O Jisù, Mjeshtër me shumë durim
O Jisù, Shpëtimtar plotë lipisi
O Jisù, Dashuri e pakufishme, ruajmë
O Jisù, pastromë ka mbëkati im
O Jisù, llargò sytë e tu ka mbëkati im
O Jisù, lirò zëmrën time ka çdo ipokrizi
O Jisù, u shpresonj tek Ti, mos më lë
O Jisù, mos më resht llargu ka Ti.
O Jisù, krijuesi im, mos më harrò.
O Jisù, Ti i vetmi Delar i mirë, ruajmë.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

O Jisù, Ti veshe me fuqi ka Larti
Apostulit të mbetur në Jerusolim.
Me zjarrin e Shpirtit Shëjtë veshmë edhe mua,
që s'kam një vepër të mirë,
e lemë të të këndonj me dashuri.

Alliluia

O Jisù, te bëgatëria e lipisisë sate
thërrite publlikanë e mbëkatarë;
kështù nani priru ka u,
që jam si ata,
e mirr këtë këndim si mirrë shumë të shtrëjtë.

O Jisù, fuqi e pamundshme

Lutje Jisuit, Zotit tonë t'ëmbël

O Jisù, butësi e pakufishme
 O Jisù, bukuri e ndritshme
 O Jisù, dashuri e pathënëshme
 O Jisù, Bir i Perëndisë të gjallë
 O Jisù, kij lipisi për mua, mbëkatar
 O Jisù, mësomë mua, që nëng di
 O Jisù, dritësomë mua, që jam mbë t'erret
 O Jisù, pastromë ka çdo mbëkat
 O Jisù, sillmë prapë tek Ti, si birin dorëgjere

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

I sulmuar përmbrenda ka një monostròf dyshimesh,
 Pjetri po mbytej.
 Kur të pa Tij kurmërisht përpara
 e ç'ecje mbi ujit,
 Të njohu Perëndi të vërtetë,
 e, si u rëmbie te dora që shpëton, tha:

Alliluja

I verbri të gjegj se shkoje, o Zot,
 e u vu e thërriti:
 "O Bir i Davidhit, kij lipisi për mua!"
 Ti e thërrite e i dhe të parit.
 Edhe ashtù, te butësia jote,
 dritëso sytë e zëmër sime,
 mua që të thërres, tue thënë:

O Jisù, krijues i ëngjëlvet
 O Jisù, lirimtar i njerëzvet
 O Jisù, fitimtar i pisës
 O Jisù, Ti veshë me bukuri çdo krijesë
 O Jisù, jipi zëmër shpirtit tim
 O Jisù, dritëso mendjen time
 O Jisù, mbjò me gëzim zëmër time
 O Jisù, jipi shëndetë kurmit tim
 O Jisù, Shpëtimtari im, shpëtomë
 O Jisù, drita ime, dritësomë
 O Jisù, ka çdo ankth liromë
 O Jisù, shpëtomë mua, të padenjë

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Me gjakun tënd të derdhur, na shpëtove.
 Kështù, o Jisù, mos na le ndë filaqi,
 robër të pasjonavet tona e të helmit të rëndë.

Bën të lirë hapat tanë, neve që Të thërresmi:
 Alliluja

Të biltë e popullit tënd panë,
 te një kurm si yni,
 Atë, që me dorën e tij kish krijuar njerinë.
 E, si e njohtin si Zot,
 kërkojen t'i bëjnë festë,
 e ture i tundur dega thërrisjen: "Osanà!"
 Ashtù edhe na të dhurojmi një himn, tue thënë:

O Jisù, Perëndi i vërtetë
 O Jisù, Bir i Davidhit
 O Jisù, Rregji i lavdisë
 O Jisù, Shtjerr i pafajshëm
 O Jisù, Delar i çuditshëm
 O Jisù, ruajtës i fëmijërisë sime
 O Jisù, këshilltar i rinisë sime
 O Jisù, lëvdi i pleqërisë sime
 O Jisù, shpresë tek hera e vdekjes
 O Jisù, jetë pas vdekjes
 O Jisù, ngushëllim tek ajo herë
 që do t'më gjykosh
 O Jisù, dishërimi im i vetëm,
 hapmë dyert e Rregjërës sate.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Si plotësive lajmin
 e profitevet të frymëzuar ka Perëndia,
 erdhe mbi dhe, o Jisù.
 Dishe të rrije ndë mes të neve, Ti i pakufishmi,
 e pate lipisi për sëmundjet tona.
 Prandaj, të shëruar për lavomat e tua,
 xumë të këndojem:

Alliluja

Drita e vërtetës sate u ngre mbi gjithësinë e tërë,
 dhe e rremja që e reshtur:
 idhulit, o Shpëtimtari ynë,
 nëng duruan fuqinë tënde e ranë.
 E na, që muartim shpëtimin, të këndojmi:

O Jisù, e Vërtetë që resthën të rremën
 O Jisù, dritë që s'perëndon
 O Jisù, kështù i madh te fuqia jote e pakufishme
 O Jisù, Perëndi i patundshëm te lipisia jote
 O Jisù, bukë jetje, ndëndmë mua që kam ú

Lutje Jisuit, Zotit tonë t'ëmbël

O Jisù, burim i mendjes,
shuaj etjen time, se kam etë
O Jisù, veshje hareje, pështillmë mua të vdekshëm
O Jisù, mbulesë gëzimi, mbulomë mua të padenjë
O Jisù, çë jep kuj të lijpën,
lemë të qanjë mëkatët e mi
O Jisù, çë ja hapën kuj trokullon,
hap zëmren time të varfër
O Jisù, shpëtimtar i mbëkatarëvet, pastromë
ka mbëkati im.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua
Sepse doje të zbuloje misterin e fshehur ka shekul,
si një shtjerr pa golë qeve sakrifikuar, o Jisù.
Sepse je Perëndi, u ngjalle ka të vdekurit
e u ngjite ndër qielt te lavdia.
Me Tij na ngjalle, neve çë të këndojmi:

Alliluja

Për sytë tanë, qe krijesë e çuditshme,
kur Krijuesi, i lerë ka një Virgjëreshë,
u buthtua:
u ngjall ka varri pa çajtur vulat,
u buthtua kurmërisht Apostulvet,
me dyert e mbillura.
Prandaj, pjetë çudi këndojmi fort:

O Jisù, Fjalë e pandilgueshme
O Jisù, Fjalë e fshehtë
O Jisù, fuqi e paafrueshme
O Jisù, urtësi e pabesueshme
O Jisù, perëndi i pamasur
O Jisù, Zot i tërë gjithësisë
O Jisù, sovranitet i pakufishëm
O Jisù, fuqi e pazakëshme
O Jisù, mundësi e përjetshme
O Jisù, krijuesi im, kij lipisi për mua
O Jisù, Shpëtimtar, shpëtomë.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Si të shohmi Tij, o Jisù,
Perëndi çë more kurmisterjozisht,
na rromi te jeta pa qënë të jetës,
dhe ecmi me shumë shpresë drej Rregjërësë sate.
Ndëse u zbritte mbi dhë, e bëre se t'na ngrëje ndër qielt
neve,

çë të këndojmi:

Alliluja

Ti je i tërë mbi dhë
pa mos qënë ndër qielt, o Jisù,
kur, vullnetarisht, durove për ne.
Me vdekjen tënde munde vdekjen,
me ngjalljen tënde i dhe jetën
atyre çë të këndojën:

O Jisù, ëmbëlsi e zëmërës
O Jisù, fuqi e kurmit
O Jisù, dëlirësi e shpirtit
O Jisù, gjallëri e shpirtit
O Jisù, gëzim i zëmres sime
O Jisù, shpresa ime, e vetmja ime shpresë
O Jisù, lëvdi shumë e lartë, lëvdi e përjetshme
O Jisù, dishërimi im i vetëm, mos më resht.
O Jisù, Delari im, kërkomë.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Gjithë Ëngjëlit madhërojën pa prëhje
Ëmrin tënd të Shëjtë, o Jisù,
e këndojën te qielli: Shëjt, Shëjt, Shëjt.
Edhe na, mbëkatarë, me buzët tona gjinie,
mbi dhë këndojmi:

Alliluja

Si të shohen, o Jisù, Shpëtimtari ynë,
oratorët më gojëtarë qëndrojnë pa fjalë.
S'janë të zotrat të thonë si Ti qëndron
Perëndi i pandërrueshëm e njeri i përsosur.
Po na, plotë çudi përpara misterit,
me besë thërresmi:

O Jisù, Perëndi i përjetshëm
O Jisù, rregj i Rregjvet
O Jisù, Zot i zotravet
O Jisù, gjyqtar i të gjallëvet e të vdekurvet
O Jisù, shpresë e atij çë s'ka më shpresë
O Jisù, ngushëllim i atij çë qan
O Jisù, lavdi i të përulurvet
O Jisù, mos më gjyko sipas vepravet të mia
O Jisù, te lipisia jote, shëromë
O Jisù, llargò ka u hjidhërimin

Lutje Jisuit, Zotit tonë t'ëmbël

O Jisù, dritësò mendimet e zëmrrës sime
O Jisù, mbaj zgjuar tek unë mendimin e vdekjes

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Sepse dishe të shpëtoje jetën, o Djell që shkeptën,
more një kurm si yni
e u përulë njera te vdekja.
Prandaj Ëmri yt që i lartësuar
përmbi çdo ëmër.
E ka gjithë qëniet e dheut e të qiellit
gjegjën që këndojën:

Alliluja

O Perëndi i Përjetshëm, ngushëllimtar, Krisht i vërtetë,
pastrona nga çdo njollë,
si pastrove dhjetë gërbulit,
e shërona si shërove Zakenë, publikanin,
ashtu që, të penduar, të këndomi ture thënë:

O Jisù, thesar që s' shkatërrohet
O Jisù, pasuri e pafund
O Jisù, gjellë e të fortëve
O Jisù, burim i pambaruëshëm
O Jisù, veshje e të varfërvet
O Jisù, mbrojtës i vejushavet
O Jisù, mbrojtës i të shkretëve
O Jisù, ndihmë e punëtorëve
O Jisù, drejtues i ecërorëve
O Jisù, timoniër i detarëve
O Jisù, ngushëllimtar i të meruarvet
O Jisù, ngrëjmë njetër herë ka ftesat e mia.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Të dhuronj, unë i padenjë,
një himn pjotë me butësi e pendim.
Si kananea të thërres:
"Jisù, kij lipisi për mua!"
Shëromë, o Jisù, mua që të thërres:

Alliluja

Pali, që njera ahiera të ndjeknej,
- Tij, drita që dritëson
atë ç'është tek errësirat e padijturisë -

i gjegji fuqisë së zërit
që i thjellonej mendjen me njohje të perëndishme
e ndërroi tru gjithnjëherë
Kështu dritësò sytë e errësuar
të shpirtit tim që të thërret:

O Jisù, Perëndi i pamundshëm te fuqia jote
O Jisù, Zot i tërëfuqishëm e i pavdekshëm
O Jisù, Krijues që shkëlqen me lavdi
O Jisù, udhëzues i sigurt
O Jisù, Delar i palodhshëm te butësia jote
O Jisù, Shpëtimtar shumë zëmërdhëmbshur
O Jisù, dritëso ndjenjat e mia, të verbuara ka mallet
O Jisù, shëromë mua të shëmtuar ka mbëkati
O Jisù, pastrò shpirtin tim ka mendimet e kotshëm
O Jisù, ruaj zëmërn time ka dëshirat e liga.

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Falmë, o Jisù, Ti që ndëlën çdo dëtyr,
mbjdhmë mua, të penduar,
si mbjodhe Pjetrin që të kish mohuar.
Thërrit më mua, mbëkatar,
si thërrite Palin që të ndjeknej
e gjegjë më mua, që të këndonj:

Alliluja

Tue përkujtuar Mishërimin tënd
na të gjithë të lëndojmi.
Me Tumazin të besomi Perëndi e Zot,
që, ulur ka e djathta e Atit,
ka të vinjë të gjykonjë të gjallët e të vdekurit.
Ndreqmë prandaj një vend ka e djathta jote
mua që të këndonj:

O Jisù, zjarr dashurje, ngroh më
O Jisù, ndënjje e përjetshme, pështromë
O Jisù, veshje dritje, veshmë me bukurinë tënde
O Jisù, perne e shtrëjtë, shkëlqë mbi mua
O Jisù, Diell që shkeptën, dritësomë
O Jisù, dritë e shëjtë, dritësomë.
O Jisù, nga çdo sëmundje, ruaj më
O Jisù, shkulumë ka dora e kundërshtarit
O Jisù, liromë nga dënimi i përjetshëm

O Jisù, Bir i Perëndisë, kij lipisi për mua

Lutje Jisuit, Zotit tonë t'ëmbël

O Jisù, i butë e zëmërulet,
te dashuria jote që mosgjë shan
ruaj varfërinë tonë,
ndëlë pa masje, te lipisia jote e pasosur,
e mbjith lutjen tonë të përlurur
si mbjodhe ka vejusha dhurëtrirën e varfër.

O Jisù, si djemtë, ka Ti shumë të dashur,
ndërrromë.

O Jisù, si delaret e trëmbur,
hilqëmë ndaj Teje.

O Jisù, si të lerin e verbër, ngitëmë, se të t'shoh.

O Jisù, si të kërrusurin, shëromë,
se t'ecënj bashkë me Tij.

O Jisù, si kanaanë çë të parkalesnej, gjegjmë

O Jisù, si Maries çë të mirr vesh, folmë për Tij.

O Jisù, si mbi Pjetrin, çë të mohoi
ul sytë e Tu mbi mua

O Jisù, si Marien Magdalenë çë të dish shumë mirë,
ndëlëmë.

O Jisù, si Zakeun thërritëmë dhe eja tek u

O Jisù, si të bilën e Jairit, ngrëjmë

O Jisù, si Samaritanën, ndërrromë.

O Jisù, si Janjin, dishipullin tënd më të dashur,
bën të qëndronjë tek Ti

O Jisù, te mbarimi i kësaj jetje,

si kusarit të mirë, thuajmë njetër herë:

Sot do të jesh me mua ndë Parrajsit.

*“Zoti Jisù
të mund t'ngasë sytë tanë
se të na bënjë të zotra të ruami
jo atë çë duket
po atë çë s'duket!
Të mund t'na i hapënj këta sy
se të shohen
jo herën e nanishme
po herën e ardhshme
e të mund t'na dhuronjë
sytë e zëmrës
me të cilët të mund
t'shohmi Perëndinë
me anën e Shpirtit”.*

(Origjeni)

* Lutje bixantine, po jo-liturgjike

Ndëse jo nani, kur ?!...

Purçilli pret Prift e Ëmri

Ëmri

Sot më se ndonjë purçilot pyhet: a) Pse - e ç'kur - ëmri “Eianina” u humb ka Dokumentet e Bashkisë? Te Statuti i Bashkisë, ëmri i këtij katundi - fracjonë e Frasnitës - është i zënuar fill vet një (1) herë; e s'gjënjë menu hjenë e një artikulli ç'folen mbi Delegatin e Fracjonës. Po pra, ka katër vjet, dimi se Viçesindku është Michele Greco e se u le e rron Purçill. Pa ru' ktjë! Statuti thot një shurbes, Politika bën njetër e Burokracia bën kund se s'gjegjen e s'sheh. Pse kështu?

b) Mos hereherë Bashkia e mban mbë turpë fjalën “Purçill”? Provinçës dhe Universitatës s'Kosenxës ki ëmri i bën nderë, dhe e shkruajtin math mbi shumë (pesëmbëdhjetë?) Tabela Udhje. Purçilli/Eianina, si katund e si vater kulturje, është i njohur (jo më pak se Frasnita) ka Bota Shqiptare (e ndonjë meritë e kanë - më duket - edhe rivistat Zëri i Arbëreshvet e Jeta Arbëreshe).

Me një fjalë: Purçillit *ndera* s'i mangon jashtë shpisë, i mangon ndë shpitiç ' saj: dhjaj ka ana e asaj Bashkije te ku bën pjesë! E kjo nderë s'rri faregjë/è a costo zero: “7 shkronja/lettere e 2 kllapa/parentesi” çë kanë i shtohen çdoi udhje, toponomastike, qishje, shfaqje, festje, lipi, kuvendi, etj.../ecc... çë gjëndet (ose mbahet) mbrënda katundit t'Purçillit. Është e para herë, me këtë Administracjonë, çë Purçilli ka më Kunxilëre se Frasnita. Purçilli do Ëmrin e tij (Eianina) mbi Kartat e Bashkisë. Lipen shumë?

Prifti

Njera katër vjet prap, prifti i Purçillit ish zoti Manuell Giordano, frasnjot; pra vate në pension. Pas atij Purçilli patë një prift purçilot, i martuar: zotin Mink Randelli, çë vinej ka famullia/parrocchia e Cantinelle-s. Tre vjet e gjims e Inzot, parë Pashkëvet 2013, e muar me 'të. Një sëmundje e rëndë, e gjatë më se një vit, e grisi daledalë. Një lip i math, çë la Purçillin pa fjalë e të shoqen pa më lot. E zoti Peshkop i Ungrës, Donato Oliverio, shpresomi se do t'i japë Purçillit, sa më parë, jo vet nj'aministratore të famullisë /amministratore parrocchiale, po, mëshpejt, një Prift/Famullitar/Parroco të ri.

Nderen Purçillit s'ja jep vet Ëmri, po edhe Prifti; jo vet Bashkia, po edhe Qisha. Purçilli i bëri, e i bën, nderë “sa munden” Bashkisë s'Frasnitës; Purçilli i bëri, e i bën, nderë “sa s'dihet” Eparkisë së Ungrës.

Kur një Fracjonë numron më priftra se çdonjëter katund të Eparkisë; kur katundi i Purçillit, fracjonë e Frasnitës, ka më Kunxlier/Consiglieri se krieqendra/capoluogo e Bashkisë; pretëndon/pretende Nderë/Rispetto. E meriton. E ndëse jo nani, kur?

Drejtori

“Zëri i Arbëreshvet”

(Purçill-Eianina / Cs-Italia // 1972- 1982)

Autorë e Shkrime *

- Agricola** – Pollino reclamizzato (2-3/72);
- Altimari Franco** (ka Maqi/Cs) – Prima settimana di cultura albanese a S.Demetrio Corone, cronaca (10/77);
- Badallaj Imri** (ka Prizreni/Kosova) – *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit geg* (10/77);
- Basile Francesco** (ka Kastërnexhi/Cs) – Casali Albanesi in un documento del 1488 (4/72); *L’Araldica: e perché no?*; Giovanni Laviola: Ferdinando Cassiani nel pensiero e nell’azione, recensione (5/73); *Geografia feudale della Calabria*; Appunti sulla situazione linguistica degli Arbëreshë (13/80);
- Belmonte Vincenzo** (ka Strigari/Cs) – *Te prëhri i gjelles*, poezi (13/80);
- Bellizzi Domenico/Vorea Ujko** (ka Frasnita/Cs) – *Ndonjëherë / Ulu mbanë meje*, poezi; Leggendo “Hroazat”, recensione (1/72); Zef Serembe (1843-1901), il poeta del dolore (I); *Sinfoni indiane*, poezi (2-3/72); I motivi della poesia di Zef Serembe (I); *Jan Pallak*, poezi (4/72); I motivi della poesia di Zef Serembe (II); (5/73); *Kudo që të jesh*, poezi (5/73); Nicola Misisi e gli Italo-albanesi (I); (6-7/73); *Këngë e shkuar*, poezi (8/74-75); *Natën*, poezi (10/77); Buzëdhelprri: Hapa mbi kalldrëm, recensione (11/78); *Vallëzim*, poezi (12/79); *Drita e zemrës*, poezi (13/80); *Gjendja ime* (1-2-3), *Çerdhja, Çirim*, poezi (14/81);
- Bellusci Mariangiola** (ka Pllatani/Cs) – *Një dhënderr u nis e vate suldat e i vëllai kështu vate i këndoj nuses tij*, vjersh (10/77); *Borë*, poezi (11/78);
- Bellusci papas Antonio** (ka Frasnita/Cs) – Gli Illiri e la genesi della lingua albanese e degli albanesi (a Tirana una sessione di studi su -) (4/72); *Fjalë dhe shprehje Idiomatike arbëreshe të Shën Kostandinit Arbëresh* (6-7/73);
- Bilotta papas Bernardo** (ka Frasnita/Cs) – *Kriati i Dors’s frasnjot / Çivjtjoti ç’vate e u skomollis*, sonetti (in Fletë Gazmore) (10/77); *Mbi Kungullin e Marsit ndrë Zakonet e Frasnitës* (sonet me bishtin (13/80); *Mbi varrin e të ndrçimit shok Enrik Kremonese t’Anjonit* (14/81);
- Besa (Roma)** – La Poesia Albanese oggi, cronaca (5/73); Frangjisk Andon Santori: Brisandi, Lleticja e Ulladheni (a cura di I.C.Fortino) (11/78);
- Blaiotta Franco** (i lerë Purçilli/Cs) – L’Associazione (1/72)
- B.R.** – Besa (2-3/72);
- Braille Lino** (ka Purçilli/Cs) – *Kujtimi i trimërisë sime*, poezi; *Mëmë*, rapsodi (14/81);
- Brunetti Clemente** (ka Pllatani/Cs) – *Kavallela*, rrëfim (8/74-75);
- Bruno Rosa** (ka Frasnita/Cs) – Aggiorniamoci, Ministero permettendo, cronaca (10/77);
- Bruno Vincenzo** (ka Çifti/Cs) – Per una legge che non arriva, Appello ai singoli (6-7/73);
- Bugliari Angelo** (ka Shën Sofia/Cs) – *Vjershe* (13/80);
- Buzëdhelprri (ka Purçilli/Cs) – Shih: Giordano Agostino**
- Calimà Erminia** (ka Ferma/Cs) – *Biri gjalpir* (përrallëz), - ka teza e A.Saccomanno-s (5/73);
- Camodeca Rosina** (ka Spixana/Cs) – *Vjersha ka Spixana* (8/74-75);
- Capparelli Angelo** (ka Firmoza/Cs) – Luigi Palermo, pittore italo-albanese (4/72);
- Capparelli Josafatte** (ka Firmoza/Cs) – *Mëma që nganëi të birin*, përrallëz (6-7/73);
- Capparelli Mioneone Orazio** (ka Firmoza/Cs) – *Re Gulëllmit*, poezi (10/77);
- Cassiano Domenico** (nga Vakarici/Cs) – Note per una storia delle popolazioni albanesi nel feudo di S.Adriano (14/81);
- Castellano Francesco** (ka Çifti/Cs)) – *Alla Calabria*, (traduzione in albanese di E.Giordano), poesia; (5/73);
- Cataldi Leonardo** (ka Çifti/Cs) - *Besa gravet e besa qenvet*, përrallez (8/74-75);
- Catanese Ermelinda** (ka Shën Vasili/Cs) – *Acquaformosa*, monografia (dalla sua tesi di laurea) (1/72); *Aneddoto di Acquaformosa* ibidem) (8/74-75);
- Catapano Giuseppe** (ka Frasnita/Cs) – *Rina- Kthimi* (I parte), poemetto arbëresh (6-7/73); *Hyu*, poezi (14/81); *“Menelau i lënë”*, poemetto in versi (15/82).
- Ceraja Jakup** (nga Mitrovica, Kosovë) – *Kënga e tokës nënë* (poemë) -I- (5/73); *Kënga e tokës nënë* (poemë) -II-; (6-7/73);
- Cortese Gennaro** (ka Ungra/Cs) – Saluto del Presidente (1/72); Emilia Russo: L’Abbazia del Patirio, recensione (5/73); Contro l’apartheit (6-7/73); Quando i cani mordevano i porci; Franco Domestico: Turismo in Calabria,

Autorë e Shkrime *

- recensione (8/74-75); Questi bistrattati Arbëreshë; Stelvio e Pollino, disuguaglianza tra massicci / Saggi consigli d'Istituto a Civita, cronache; F.Fusca: Gemme d'amore, recensione; (10/77); Per chi non può seguire la via maestra (13/80);
- D'Amore Concetta – Mirella Schiano di Zenise** (antropologhe dell'Università di Napoli) – Gli Italo-Albanesi del monte Pollino (Cosenza): presentazione dei dati metrici e morfometrici (13/80);
- Damis Angelo** (ka Ungra, Cs) – Enzo Domestico Kabregu (8/74-75);
- De Biase Rosalba** (ka Shën Kolli/Kr) – *Ghuçia*, rrëfim (tratto dalla sua tesi di laurea) (8/74-75); *Fjalë të Urta*, da S.Nicola dell'Alto, *Carfizzi e Pallagorio* (10/77);
- De Luca Torina** (ka Frasnita/Cs) – “Të Bijtë e Shqiponjës” volano a Piana, cronaca (10/77);
- De Martino Leonardo** (ka Katundi/Av) – L'Omero Albanese, poesia su G.De Rada (5/73);
- De Padova Carmine** (ka Shën Marcani/Ta) – *Mama*, canzone (11/78);
- Dedja Fener** (pseudonim) (kosovar) – *Kosova*, poezi (10/77);
- Di Lena Matteo Giorgio** – (ka Munxhufuni/Cb) – *Kënka malli* (11/78);
- Di Vasto Francesco** (da Castrovillari/Cs) – I resti archeologici di Ietticelle, in agro di Castrovillari (6-7/73); Nota sull'archeologia della zona di Frascineto-Ejanina (11/78); Rinvenimento nella zona del Casale di Castrovillari (12/79);
- Dushko Vetmo** (ka Frasnita/Cs) – **Shih: Solano papas Francesco**
- Emmanuele Demetrio** (ka Çifti/Cs) – Per lo sviluppo dei paesi arbëreshë; Carnevale di ieri e di oggi (1/72); Tradizioni contestate?; Le Vallje a Civita / A Lungro, riunione dell'Aiadi, cronaca; Turismo e Folklore (2-3/72); Itinerari turistici: lungo la strada della salvezza; Seminario di studi per insegnanti e cultori italo-albanesi; (4/72); Usanze di Carnevale; Riunione a Civita: Collegio di S.Adriano al bivio, cronaca; (5/73); Il Pollino sud-occidentale (6-7/73); A San Demetrio Corone, incontro sugli Italo-Albanesi (8/74-75);
- Fasanella Annamaria** (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80);
- Ferrari Epifanio** (ka Frasnita/Cs) – *Versi di sdegno*, da Frascineto (6-7/73); *Gjuha Arbëreshe, Ujit*, poezi (8/74-75); *Verës*, poezi (10/77); *Dashuria*, poezi (dalla tesi di A.Giordano) (11/78); *Vjershe ka Frasnita* (dalla tesi di A.Giordano) (13/80);
- Ferrari papas Giuseppe** (ka Frasnita) - *E Ikura*, rapsodia musicata (6-7/73);
- Ferraro Brasacchio Mario** (ka Gizzeria/Jaxeria, Kr) – Albania, poesia (12/79); Gli Italo-Albanesi per l'Europa unita, editoriale (13/80);
- Filardi Diana** (ka Çifti/Cs) – Civita, monografia (dalla sua tesi di laurea) (2-3/72); *Çoti dhe e jëma e urtë*, përrallëz ka Çifti (dalla sua tesi di laurea) (11/78);
- Fishta Gjergj** (shqiptar), *Gjuha shqipe*, poezi (tradotta in italiano da papas E.Giordano) (1/72)
- Fortino F.Eleuterio** (ka Shën Benedhiti/Cs) – Papas Antonio Bellusci: Canti sacri albanesi, recensione (2-3/72);
- Frascono Giosafat** (ka Firmoza/Cs) – *Shpia e vjetër*, poezi (1/72); *Ndallandyshtja e njeriu*, poezi (2-3/72); *Firmoza*, poezi (6-7/73); *Ture u mbytur*, poezi (11/78); *Dy nëndor*, poezi (12/79); *Nusez*, poezi (14/81);
- Frate Ettore** (ka Ruri/Cb) – Mostra degli artisti dilettanti dei paesi italo-albanesi di Portocannone, Campomarino, Montecilfone e Ururi (11/78); Da Ururi, nuovo circolo culturale / La sete nel Basso Molise, il problema a Palazzo Madama dal 1950: le accuse e le soluzioni positive, cronache (11/78); La scuola aprirà le porte alla lingua delle minoranze albanesi, slovene e greche?, cronaca (13/80);
- Friuli Rosetta** (ka Shën Marcani/Ta) – San Marzano di San Giuseppe, monografia (sua tesi di laurea) (11/78);
- Fusca Francesco** (ka Spixana/Cs) – Spezzano Albanese, 4 marzo 1668 - Dal rito greco al rito latino: Per un prete di troppo (8/74-75); Editoriale (10/77); Disgregazione dell'uomo nell'arte di Damiano Minisci (10/77); *Prishtina*, poezi (11/78); Franco Azzinnari: pittore-poeta scapigliato (11/78); *I pari mall*, poezi; Ibrahim Kodra e Zëri i Arbëreshvet; Il problema linguistico a San Demetrio Corone; (14/81);
- Giangreco Pasquale** (ka Kastrofila/Cs) – Lettera aperta ai veri cultori di Frascineto (14/81);
- Giordano Agostino/Buzëdhelpr** (ka Purçilli/Cs) – La poetica del Bilotta: *Dreqdreqi*; *Nganjë dha këshile / Një herë hapu buzën*, poezi; Bashkim/Unione; (1/72); *Fletë Gazmore* (2-3/72); *Liria*, poezi; Alla ricerca della danza; Festeggiamenti pasquali a Frascineto 1972, cronaca (2-3/72); *Fletë gazmore*; *La Shkulqia di B.Bilotta* (I); *Lypsja ka turp / Pendimi s'ka ëmër*, poezi; (4/72); *Fletë gazmore (po jo aq)*; (5/73); *La Shkulqia di B.Bilotta* (II); *Një fund të kujtimit* (5/73); *Fletë Gazmore*; Introduzione a Rina- Kthimi (I parte), poemetto arbëresh di G.Catapano; Angelo Marinus ha esposto ad Avignone; (6-7/73); *Fletë gazmore*; “*Martesa*” (III) di B.Bilotta – Il poeta e il suo

Autorë e Shkrime *

ambiente; *Për ty, Arbëresh*, poezi; *Jehona i përmallohet Zërit*, cronaca; *Mirë u pafshim, vëllezër!*, intervista a Xhevat Gega e Rexhep Zllatku; Ernesto Koliqi è morto, cronaca; Il Punto (8/74-75); Nascita e prima infanzia del bambino, nella tradizione folclorica di Frascineto-Ejanina (9 – numero speciale '76); Culto della Lingua e movimento risorgimentale in B.Bilotta; *Një katundi që sot nuk flet arbërisht*, poezi; Vorea Ujko: Mote Moderne, recensione (10/77); Antenne e inchiostro arbëresh, editoriale; *Fletë gazmore*; *Bota Arbëreshe*, poezi; Shën Mëria Këtye Lartë a Eianina, cronaca; Kalendar i Arbëreshvet, recensione (11/78); Frascineto, monografia (dalla sua tesi di laurea); *Fletë gazmore*; *Fjalë të urta Arbëreshe*; *Nganjë kemi një shpi*, poezi; Attilio Morelli, poeta della natura / Angelo Marinus, come dipingere in albanese (12/79); Ejanina, monografia (dalla sua tesi di laurea) (13/80); ...*Dhe do të jesh burrë*, poezi (13/80); *Proverbi di Frascineto-Ejanina / Nuk di sa duar, Kujtimi, Sensacion, Demagogjia, Gazi yt, Sot vargjet e mia*: poezi // Kosova, stop ai maltrattamenti serbi / Primavera folk Arbëreshe 1980 / Arbëreshë in Tv / Tirana, è morto Eqrem Çabej / S.Demetrio Corone, 1° Festival della Canzone Arbëreshe / Prishtina, / 7° Seminario Internazionale di cultura Albanese per stranieri / Saint Vincent, incontro internazionale “Lingua e Città” / Cosenza, istituita la cattedra di Dialetti albeni dell’Italia Meridionale / Caraffa, è iniziato il corso di lingua arbëreshe / Frascineto-Civita, attività del prof. Agostino Giordano, docente di lingua arbëreshe / Giornate della Cultura Kosovara, nei paesi arbëreshë siciliani e calabresi / Terremoto a Barile, Maschito e Ginestra / Frascineto, fondata la Radio Libera Frascineto / Roma, Convegno nazionale delle Minoranze linguistiche organizzato dall’A.I.D.L.C.M. / Grupi folk arbëresh i Shën Kollit në Shqipëri / Në Detroit ndërtohet Kisha Katolike shqiptare / Milano, 1°Convegno culturale Italo-albanese organizzato da L.Mitidieri / Macchia Albanese, Convegno su G.De Rada / Lungro, rinnovo delle cariche nell’Aiadi / Piana degli Albanesi, è morto mons.Pernicario / Cosenza, fondazione della Lega Italiana di difesa della Minoranza Arbëreshe / S.Demetrio Corone, II* Edizione del Festival della Canzone Arbëreshe / IV* Settimana di Cultura Albanese / Frascineto, incontro con il pittore Ibrahim Kodra / Milano, è in allestimento mostra fotografica sulla realtà arbëreshe in Italia / Primo censimento degli albanofoni della provincia di Cosenza, cronache culturali // Vorea Ujko, Stinat e mia, recensione; Pietro Napoletano, Një jetë që biret, recensione; Lidhja-Unione, rassegna di informazione della comunità italo-albanese del SS.mo Salvatore di rito greco-bizantino di Cosenza, diretta da papas A.Bellusci, recensione; / *Se të shërosh gastritin, fol hapët: saktësime* (14/81); Presentazione di “Menelau i lënë” di Giuseppe Catapano (15/82)

Giordano Agostino (senior) (ka Frasnita/Cs) – *Mësime të urta*, poezi (10/77);

Giordano papas Emanuele/Jobi (ka Frasnita/Cs) – Come scrivere in albanese; La basilica di San Pietro Apostolo, in Frascineto; *Tradhëtarët*, poezi; *Fjalë t’Urta arbëreshe*; *Lozje*; Cronaca; Una nuova grammatica albanese; *Hymni i Arbëreshvet*, muzikë; Alfabeto Albanese (1/72); *Dorëngushti, komedi në katër akte*; *Mejtim*, poezi; Regole e note grammaticali sul nominativo dei nomi; *Fjalë të urta*; *Fjalim në rastin e inaugurimit të selisë së Shoqërisë Kulturore Arbëreshe*, cronaca; Stato attuale e prospettive della cultura arbëreshe; Gaetano Tricoci: Il sito di Sibari, recensione; *Vdekja e Skanderbekut*, pentagramma (2-3/72); *Dorëngushti*; *Lozie. garë me thesin, Rrola ose Rrolza*; *Fjalë t’urta*; Giuseppe Catapano: Contestazione contestata, recensione; *Kur leve ti vashë*, pentagramma (4/72); Të Folmet Arbëreshe (I); *Fjalë t’Urta*; *Martesa e Skanderbekut*, pentagramma (5/73); Të Folmet Arbëreshe (II); Girolamo De Rada, in margine al LXX anniversario della sua morte; Francesco Bugliari: Vita di mons.F.Bugliari; *Petkat e të mirat tona...*, pentagramma (6-7/73); Alfonsino Trapuzzano: Storia di Gizzeria.../ Malandrinaggio e Brigantaggio nel territorio di Gizzeria dal 1450 al 1883., recensioni; *Mjekrari*, pentagramma (8/74-75); Editoriale (9 – numero speciale '76); *Seminari i trejtë i Kulturës shqiptare për të Huaj*, cronaca; *Rexhep Zllatku: Me Arbëreshët, recensione*; *Rinë, dergojme ajrin / Moj garofull që lulëzon, vjershe malli*, pentagramma; (10/77); *Ankthi i kohës*, poezi; Centenario della Lega di Prizren (1878-1978) / Madre Teresa a Shkup, cronache; Francesco Bianco: *Dictionarium Latino-Epiroticum / Matteo Giorgio Di Lena: Gli Albanesi di Montecilfone / Zef J.Oroshi: Katër Ungjijt dhe Punët e Apostujvet*, recensioni; *Kujtomi sa për ne / Kush m’e jëndi triesën*, pentagramma (11/78); Gli Arbëreshë: un popolo venuto dall’Oriente; *Italo-shqiptari*, poezi; *Kënka Skanderbekut / Kostondini e Jurëndina*: pentagramma; (12/79); *Aforizëm*, poezi; *Fjalë të Urta* (13/80); // Un manoscritto inedito albanese di V.Dorsa, recensione / Namik Resuli: I più antichi testi albanesi, recensione / Enzo Gatti: La vita degli Etruschi, recensione / Giuseppe Del Gaudio: Darsma e Jaxerisë, recensione; Karmell Candreva: Shpirti i Arbërit rron – Arbëreshi tregon, recensione / C.B.Massolini e U.Buttafava: Vocabolario Albanese-Italiano, recensione / V.Golletti Baffa: Libri im i parë, recensione / Vincenzo Belmonte: Vjershe, recensione // *Moj ti mëma ime (valtım), Kalimera*

Autorë e Shkrime *

- Llaxarit (kalimere)*, pentagramma (13/80); *Frasnitës*, poezi; Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, recensione; D.Simon Filipaj, Besëlishja e re, recensione; Hysen Voci, Fjalor italisht-shqip, recensione; don Lush Gjergji, Nëna Jonë Tereze, recensione; P.Damiano Como: Una diocesi della chiesa italo-albanese, recensione; Albino Greco: la tutela giuridica della minoranza albanese, recensione; Maria Greco: La casa dei Gjomarkaj, recensione; Alfonsino Trapuzzano: La donna calabrese di ieri e di oggi, nella vita e nell'arte, recensione; Jup Kastrati: Jeronim De Rada, jeta dhe veprat, recensione; Karmell Kandreva: Mendime, recensione; Degë e Blertë, antologji e poezise së sotme arbëreshe, recensione; Arbresh, periodico dell'Associazione culturale italo-albanese “Jeta” di Torino, recensione; V.Golletti Baffa, Libër këndimi i programuar, recensione; Giorgio Marano, Vaccarizzo Albanese, recensione; Nijazi Sulça, Kthimi i mërgimtarëve, recensione; / *Vjershe e Graxeta di Frascineto-Ejanina: Shkova ka dera jote, Kisha një gardulliqe, Gjithë m'e thojn se vinej kjo ditë, Një meatë ka mali vija; Ngreu, nerënxë, e lidh dhomatët; Njëmacetë kisha bushkuar; Lule ç'ka Brasilli u mbjodhe, Ti manushaqe, Sonde dolal e kam këndonj, J ulule të ktij sheshi, Garofull puturuz, Udha re duket spazët, Moj macetë me majuranë*: pentagramma (14/81); Editoriale (15/82); **Grobi Antonio** (ka Frasnita/Cs) – Arte: parola molto in voga; Mario Zabré, il pittore dei paesaggi romantici (2-3/72); pikturë të tija zbukuruan faqet e para të numrave 1 e 2-3/1972 të revistës Zëri i Arbëreshvet;
- Gjonlekaj Gjek John F.Kennedy**, *kampion i paqes dhe i lirisë*, recensione (14/81); **Hareza/Letizia Miraglia** (ka Ejanina/Cs) – *Ëndrrat e të qënët*, poezi (13/80); **Iriu Domenico E.** – Ferdinando Elmo (6-7/73); **Kastrioti Emil** (shqiptar) – *Kënga e dy dragojve*, poemëz epike (4/72); **Këngëshitësi** – *Kallakeqit*, poezi (4/72); **Kodra Ibrahim** (shqiptar) – *Besa e Shqipërisë*, poezi (14/81); **Krasniqi Mark** (kosovar) – *Antonio Bellusci: Argalia*, recensione (11/78); **Liguori Totorja** (ka Spixana/Cs) – *Poezi popullore* (10/77); **mnb** (pseudonim) – *Pika e Pikës* (10/77); **Marafioti Giorgio** – Gli Arbëreshë visti da Giorgio Marafioti (4/72); **Marano Giorgio** (ka Vakarici/Cs) – (Punti salienti della sua relazione) “Funzione delle organizzazioni” (2-3/72); **Marchese Delia** (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80); **Marinus Angelo** (ka Frasnita/Cs) - piktur; pikturë të tija zbukuruan këta numra të revistës Zëri i Arbëreshvet: 8/74-75, nr.10/1977, nr.11/1978; nr.12/1979; artikuj mbi artin e tij dualtlin mbi këta numra të Zërit: nr.6/7-1973, nr. **Mastrota Giuseppe** (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80); nr.12/1979; **Mattinò Nicola** (ka Ungra/Cs) – *Nuk di*, poezi; Questi bistrattati Arbëreshë (1/72); *Sot e djë*, poezi (2-3/72); Questi bistrattati Arbëreshë (2-3/72); **Mauro Demetrio** (ka Shën Mitri/Cs??) – *Kur isha i vogël...*, përrallëz (8/74-75); **Miglio Agostino** (da Castrovillari/Cs) – Di un antico epiteto della Madonna del Castello in Castrovillari (Cs) (5/73); **Minervini Cristina** (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80); **Minisci papas Pietro** (ka Strigari/Cs), La morte di Mons.Giovanni Mele, cronaca (12/79); *Miranda Luca* (ka Purçilli/Cs) – *Akilli*, poezi (10/77); **Miranda Maria** (ka Purçilli/Cs) – *Vjershe*, ka Purçilli (6-7/73); *Vjershe e Graxeta*, ka Ejanina (8/74-75); *Vjershe ahmarrjeje* ka Ejanina (dalla tesi di A.Giordano) (11/78); *Gjuha Arbëreshe*, poezi (13/80); **Mitidieri Lino** (ka Purçilli/Cs) – La Fratellanza, poesia (tradotta in albanese da E.Giordano) (8/74-75); *Kush thot se vera s'është e mirë*, teatër (12/79); *Rrojta është një thërrime*, poezi; Come ti dipingo una Redazione (14/81); **Moccia Alfio** (ka Shën Bendhiti/Cs) – S.Benedetto Ullano e Marri, monografia (6-7/73); **Mollo Domenico** (ka Kastërnexhi/Cs) – *Satira*, poezi popullore (dalla tesi di Mollo papas G.B.) (10/77); **Mollo papas Giovanbattista** (ka Kastërnexhi/Cs) – *Parambote Pllatanjotravet*, vjershe popullore (dalla sua tesi di laurea su Castroregio) (8/74-75); *Parambote* (dalla sua tesi) (11/78); **Napoletano Pietro** (ka Ferma/Cs) – Incontro con Grobi (1/72); *Një faqe e bardhë/Fitimtari dhe i munduri*, poezi (2-3/72); *Gjella*, poezi; *Vjershe ahmarrjeje/Versi a dispetto*, (raccolti a Firmo da -) (4/72); *Era nuk e di*, poezi (5/73); *Vjershe ahmarrjeje/Versi a dispetto*, (raccolti a Firmo da -); (5/73); *Vjershe dashurije*, da Firmo (6-7/73); *Vet krenaria të mban* (8/74-75); *Graxeta*, da Firmo (8/74-75); *Vdiq*, poezi (10/77); *Graxeta*, da Firmo (10/77); **Nik Dhuminku** (nga Qana/Cs) – *Durimi i pësuar*, (stralcio da un suo romanzo) (13/80);

Autorë e Shkrime *

Një ka Ferma (Cs) – *Lypset gjë*, poezi (1/72)

Pace Francesco/Leshkuqi (ka Purçilli/Cs) – *Liri*, *Mbledhje*, poezi (1/72); *Shoku*, poezi (2-3/72); *Shqipërisë*, poezi (4/72); *Mjaft!*, poezi (5/73); *Parisi*, poezi (12/79);

Pagano Alessandro (da Castrovillari/Cs) – *Cantico*, poesia (traduz. in albanese di Gennaro Cortese) (6-7/73); *Un sogno trascolora / In San Giovanni / La nostra lontananza / Penombra*, poesie (8/74-75); *La tua giovinezza* (11/78); *Sulla strada dei giochi*, poesia (13/80);

Pandolfo Lucia (nga Mashqiti/Pz) – *Vjershe popullore* (13/80);

Parrotta Mariella (ka Spixana/Cs) – *Spezzano Albanese*, monografia (4/72); *Vjersha / Gruaja e besmë*, da Spezzano Albanese (6-7/73); *Vjershe malli* (dalla sua tesi di laurea; narr.: Antonio Oriolo, Angelina Zuddio, Maria Cofone) (11/78); *Vjershe ka Spixana* (dalla sua tesi di laurea) (13/80);

Passarelli Igor Gaetano (ka Frasnita-Hora/Cs) – *Per una rilettura storico-artistica della Chiesa di San Pietro di Frascineto* (11/78); *Alcune note sulla costumistica italo-albanese* (13/80);

Perrone Luca (ka Purçilli) – *Fluturat qajnë me diellin mbrënda ndër ndenat*, poezi (10/77); *Zhegu rreh korzin*, poezi (11/78); *Stuhia dërmon lisin*, poezi (12/79);

Pisarro Pasquale (ka Ungra/Cs) – S.O.Capparelli: *Vdekja e nuses* (1/72); Da S.Sofia / XI edizione de “La Primavera degli italo-albanesi”, cronaca (2-3/72); A Civita, Frascineto, Ejanina e Firmo tradizionali manifestazioni folkloristiche, cronaca (5/73); Ungir “Mera” nëng bëfet më; *Aneddoti e versi d’amore*, da Lungro; (6-7/73); *Vjershe*, da Lungro (8/74-75); *Nuove cariche nell’Aiadi*, cronaca; *Un giornale sonoro da Chieuti*, cronaca (8/74-75); *Vjershe e Fjalë të Urta*, da Lungro; (10/77);

Pittelli Antonio (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80);

Randelli Mink/Domenico (ka Purçilli/Cs) – *Lamtumirë*, poezi (4/72); *Jeta ime*, poezi (5/73); *Kujtime*, poesia (6-7/73);

Raviotta Calogero (ka Kuntisa/Pa) – *Tata e arra*, poezi; *Gli Arbëreshë in Lombardia*, cronaca (12/79); *Associazione culturale a Contessa Entellina / Comunità degli Italo-Albanesi a Milano*, cronache (13/80);

Redaciona – *Il nostro impegno, editoriale; Riviste in redazione* (1/72); *Lettere in redazione* (Emil Kastrioti, Jakup Ceraja, Giovanni Puppo); *Perseverare, editoriale; Il corso residenziale di lingua albanese / Personale di pittura di Grobi / A San Basile*, discussi i problemi italo-albanesi, cronaca; *Costantino Mortati, vicepresidente della Corte Costituzionale; Libri e Riviste in Redazione* (2-3/72); *Lettere in Redazione* (Emil Kastrioti, Lec Shllaku, Ludovico Colacino, Hava Hoti/Flutura Ibrani, papas Antonio Bellusci, Franco Basile/Di Giorgio Francesco, Giampietro Emmanuele, Nino Rusciano); *La Lingua e gli Arbëreshë; In margine al Seminario di Cosenza, idee e fatti / Una iniziativa del Consiglio Comunale di San Demetrio Corone / Sempre sul Pollino / Dall’Albania / Da Civita / Da Palermo*, cronaca; *Movimento Culturale Arbëresh; Dati statistici sui paesi Arbëreshë; Libri e Riviste in Redazione* (4/72); *Lettere in Redazione* (A.I.D.L.C.M., Ullmar Qvick, Gustavo Buratti, Pierino Pisarri, Maria Delfina, Mihal Hanxhari); *Dopo un anno: qualche riflessione, editoriale; Ricorrenza del LXX° Anniversario della morte di Girolamo De Rada; Una penna al servizio del Mezzogiorno / Quando l’elettronica minaccia la tradizione / A Lungro: Corso di Lingua e letteratura Albanese, cronaca; Libri e Riviste in Redazione* (5/73); *Lettere in Redazione* (Mink Randelli, Michele Jannelli, Vincenzo Goletti Baffa, Sepa Katapanit, Mahmud Hysa); *De Rada e noi, editoriale; Non esageriamo!; Libri e Riviste in Redazione; Cronaca* (6-7/73); *Lettere in Redazione* (Karmenuçi Stamile, Muraglia Silvia, Enxin/Vincenzo Golletti); *Editoriale; Një her.., përrallëz ka Puhëriu* (dall’archivio di Zëri); *Un editoriale sbagliato; Ejanina, Vëllamja 1975, cronaca; Mozione conclusiva Corso Aiadi di Guardia Piemontese 23-29 novembre 1975, cronaca; Aiadi: Bando di concorso per gli alunni delle scuole dell’obbligo dei Comuni albanofoni d’Italia, sul tema: Ricerche sulla cultura arbëreshe del mio paese, cronaca; Besa ’76, cronaca; Discussione, a Spezzano A., su decreto legge insegnamento albanese, cronaca; Indagine antropologica sugli Arbëreshë, cronaca; Anno Santo 1975, cronaca; Libri e Riviste in Redazione* (8/74-75); *Lettere in Redazione* (Nijazi Sulçoglu, Ludovico Alberto); *IV Centenario del Collegio Greco di Roma; Alla ricerca dell’onda libera, a S.Demetrio Corone; Parrocchia di Rito Greco a Cosenza; Corso di lingua e cultura albanese a Ejanina; Artigianato albanese a Ejanina; Martedì di Pasqua a Civita; Regione, a te la parola!; In attesa del placet regionale, un esempio da seguire, da S.Giacomo di Cerzeto; Un ponte di cultura con gli Shqiptarë; La tradizione a Frascineto ha 500 anni ma non li dimostra; Personalizziamo i giovani arbëreshë; Speriamo che sia la volta buona; Una zucca caricata a salve, a Frascineto; Schermo Kosova, cronache; Libri e Riviste in Redazione* (10/77); *Lettere in Redazione* (Saverio Leggio, Antonio Sinishtaj, Carmine Stamile); *Nuovo Consiglio Centrale dell’Aiadi / Una parrocchia*

Autorë e Shkrime *

greco-bizantina per gli Arbëreshë di Cosenza / Accordo tra i sindacati confederali della Scuola e i rappresentanti delle minoranze linguistiche in seno al Cnpi / Pasqua 1978 a Frascineto: concorso di Poesia per ragazzi e manifestazione folkloristica, cronache; Francesco Di Vasto: Castrovillari Antica, recensione; Libri e Riviste in Redazione (11/78); Se il sangue non si è annacquato, editoriale; Lettere in Redazione (Mario Ferraro Brasacchio: Lettera aperta agli Italo-Albanesi), Nijazi Sulçoglu, Ullmar Qvick, Plinio Zilli, Leonardo Lala); E' morto Jakov Xoxa / Il premio Balzan a Madre Teresa / Skanderbeg a Parigi / Arbëreshë ad Argirocastro / Prima Scuola Albanese in Canada / Arbëreshë in Albania e Kosova / *Shoqatë e re në Bruksel* / Vallje '79 a Civita / Gruppo folk di Tirana in Italia / Lingua albanese in Basilicata / Un anno fa moriva G.Gangale / Lingua albanese a Civita e Frascineto / Convegno a Barile-San Costantino Albanese / Incontro-dibattito a Civita / Organismo e partito pan-arbëresh / Le Vallje, cronache; // Ramazan Hysa: Fjalor i Astronomisë, recensione; Niko Qafzezi: Fjalor i Bujqësisë, recensione; Dom Simon Filipaj: Bibla e ilustruar, recensione; Giuseppe Ferrari: Storia della Letteratura albanese, recensione; Canti albanesi registrati in cassetta) a Chieuti, recensione; Giuseppe Gangale: Arberisca IV, recensione; F.Di Vasto: Per Castrovillari, recensione; K.Kandrea: Shpirti i Arbërit rron, recensione; I Trovieri, antologia, recensione; La Chiesa Ortodossa d'Albania, num.spec."Oriente Cristiano", recensione; Kalendar i Arbëreshvet, recensione; Francesco.Fusca: F.Cassiani e A.Ribecco, recensione // Libri e Riviste in Redazione (12/'79); Lettere in Redazione (Lec Shllaku, Alicia Bodily, Gjon Gjomarkaj, Calogero Raviotta, Giorgio Marano) // A Madre Teresa di Calcutta il Premio Nobel per la Pace / Circolo culturale-ricreativo a Ejanina / Circolo Vincenzo Dorsa a Frascineto / Coordinatore delle Biblioteche Arbëreshe / 3* Settimana di Cultura albanese a S.Demetrio Corone / Lingua Albanese a Frascineto e Civita / Strade albanesi a S.Cristina Gela / Scuola Albanese in Grecia? / Associazione a Piana degli Albanesi / Albanesi a Schiavonea / 60° Anniversario Istituzione Diocesi di Lungro / Specializzazioni di Educazione Linguistica Arbëreshe / E' morto padre Giuseppe Valentini / Sht.K.Gjeçovi, nel 50° anniversario della morte / Visita del Papa a Grottaferrata / Terremoto in Albania-Kosovo / A Prishtina il 6° Seminario di Cultura Albanese / Eqrem Çabej compie 70 anni / Aleksander Moisiu, nel centenario della nascita / I° Convegno calabro-arbëresh / Aiadi e organismo unitario / Il rilancio dell'Ucia / Il Governo non conosce gli Arbëreshë / Associazione Kundisa a Contessa Entellina / Seminario di studio a Frascineto / XVI centenario della morte di San Basilio / Centenario della nascita di A.Xhuvani / il 20 aprile '80 tutti a Ejanina, cronache // Libri e Riviste in Redazione / Curiosità culturali del 1978-79 – poeti arbëreshë sulla stampa albanese (13/80); Un decalogo per gli Arbëreshë, editoriale / Lettere in Redazione (S.T.Gabrani, Gjek Gjonlekaj, Lino Braile) / Libri e Riviste in Redazione (14/81);

Rugiano Lorenzo (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80);

Rusciano Nino (ka Kastërnexhi/Cs) – *Flamuri* (11/78);

Saccomanno Annamaria (ka Ferma/Cs) – *Firmo*, monografia (dalla sua tesi di laurea) (5/73);

Santarcangelo Maria Luisa (ka Shën Marcani/Ta) – *Fjalë të urta* ka Farneta (dalla sua tesi di laurea) (11/78);

Schirò Giuseppe Di Maggio (ka Hora e Arbëreshvët/Pa) – *Lirim*, poezi (10/77);

Schittini Rosa (ka Çifti/Cs) – *Dica mendime mbi gjuhën arbëreshe* (13/80);

Scirchio papas Vittorio (ka Shën Vasili/Cs) – *Biri shkapërdar*, traduzione in arbëresh di un brano del Vangelo (6-7/73);

Selvaggi Giuseppe (ka Kasana/Cs) – Antonio Grobi: da una lettera di Giuseppe Selvaggi (4/72);

Selvaggi papas Vincenzo (ka Purçilli/Cs) – *Niku dhe bretkosa*, përrallëz (1/72); *Il soldato albanese*, di F.A.Santori; *Djemtë e ubrihut*, poezi; *Kopshtari*, *Delmiri*; Epistolario arbëresh; *Lozje djemsh / Beku beku / Pulëza / Cimb cimbiku*; (2-3/72); (a cura di -): *lettera di Achille Parapugna*, *Breçka* (V.Fabbricatore ka Shën Sofia), *Birthe i mëmës* (filastrocca ka Mbuzati); *Nëmë* (4/72); *Gjëgëgjëza/Indovinelli* (5/73); *Filastrocche*, da Macchia Albanese (8/74-75); *Indovinelli* (10/77);

Serra Alessandro (ka Spixana/Cs) – S.Adriano, la celebre chiesa dei Basiliani di Calabria (4/72);

Sinishtaj Ndue Antonio (shqiptar) – Una lettera, poesia (11/78);

Solano papas Francesco/Dushko Vetmo (ka Frasnita/Cs) – *Tregim veror* (8/74-75); Francesco Antonio Santori e il teatro albanese; *Para derës*, poezi (10/77); *Pranverë*, poezi (11/78); Lluca Perrone: Dërrudhez, recensione (11/78); *Qeni i fqinjit*, fabul (12/79); *Lisi*, një fabul (13/80); Un dono dall'America: America Meravilhosas di Lino Braile, recensione; (14/81);

Stamile-Candrea (ka Shën Japku/Cs) – Intervento al Seminario di Studi per insegnanti e Cultori italo-albanesi (4/72);

17) La ë (shwa) ty Nsermit: Nsermi bie pypara shwany (ë); singky e bukury, po dhimbje pyr neve arbyreshy pse ngk’o e mir sa ty thomi e ty shkruemi si dduhet gjuhyn arbyreshe ççy ka kughuer, mo se mo Shi’ Nikoh, zhanorat kute reshtuer ty vyshirtyr hundora pse ato çç’e fjasnjyn vinjin kka Greçia e rrinjin te Italia e kany ndier ndikimin, tingkughin ty gkuhys e Greçies, e Romys, e ty Italies (lytishtys). Kio shwa ë ndonjy hery kyghohet si a, e, i, o, u. Radha e kish ndie e e kish shkruer me e ty ndrishme.

Ghangkali, kkur shwa oshty e heshtur (pa zha) ve –y; kkur e thomi ty kughuer, ket’e shruemi ty kughuer, si e thomi. Pyr neve, mo se mo pyr diallet, ty shkruemi ë e ty digkomi zzilla zhanore oshty, oshty shumy ty rondy e ty llikk, veçç se ngky shkruemi vrytetjen e birmi gjuhyn e momys.

18) E llomi pyr njetyr hery ata ççy ddejm ty thejm mo gjaty.

* Soteparet, artikujt e papa Janit Giudice, ka Shën Kolli, do të botohen vet në formën grafike të Alfabetit të Monastirit (D.)



BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE

protopapas Emanuele Giordano:

| | |
|--|------|
| <i>Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230</i> | € 10 |
| <i>Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160</i> | € 10 |
| <i>Himne Bixantinë – 2005 – ff. 217</i> | € 10 |
| <i>Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.)</i> | € 5 |
| <i>FJALOR edic. 2000 - ff. 715</i> | € 30 |
| <i>Shpata e Skanderbekut di B.Bilotta – 1967 - ff. 217</i> | € 15 |
| <i>Folklore albanese in Italia (1957) (fotok.)</i> | € 5 |

(+39) 0981-32539 / jetarbreshe@libero.it

aspirazione nei riguardi degli albanesi era piuttosto di natura politica. Egli prestò aiuto all’ormai vecchio ed impoverito Radha nel momento in cui pagò le notevoli spese per la stampa del suo libro. Luigi Lorecchio, continua Gangale, al contrario, era manifestamente abbastanza valido come poeta e scrittore (malgrado che la maggior parte dei suoi versi sia andata perduta).

14) Immediatamente dopo il Congresso che, d’altra parte, fu frequentato dai calabro-albanesi, boicottato dai siculi-albanesi e ostentatamente ignorato dagli Skipetari, apparve un piccolo quaderno: “*Abbecedario della Lingua albanese*”, che spiegava le regole di scrittura che erano state discusse durante il Congresso che, per quanto riguarda lo stile, erano state scritte da Radha; il quaderno fu pubblicato “a spese del nobile Cav. Uff. Anselmo Lorecchio”.

15) Una delle ultime esortazioni di Lorecchio agli skipetari si trova nelle “*Questioni albanesi*”, Catanzaro 1898, p. 69: “...Faccio pertanto voti affinché nella stessa guisa che esso (alfabeto e ortografia) è stato adottato dal Congresso e conseguentemente dalla “Società Nazionale” tra noi Albanesi d’Italia sia parimenti accettato dalla “Società degli Albanesi” in Bucarest e adottato nelle scuole della Madre Patria” (Dr. G.T. Gangale, Arberisca, Universität Kopenagen, November 1970, pp. 1-8; traduzione dall’originale dattiloscritto in tedesco).

16) Interessante un articolo sul Congresso di Corigliano con i nomi dei partecipanti e dei comuni che vi aderirono ufficialmente per scritto. La raccomandazione di Rada al Lorecchio: “Mos ndzini fakjeny e sheite e fialles toony me shkronjaty ty huexa” [Non sporcate il volto santo della nostra parola con lettere straniere].

17) Rilievi: Anselmo propone la shwa con la “ë”... segno bello, ma sofferenza per noi arbyreshy perché inadatto per esprimere con precisione lo sviluppo della lingua arberisca che ha chiarificato, specie in amk 9, le vocali evitando difficili nasali, perché quelli che lo parlano vengono dalla Grecia e risiedono in Italia ed hanno subito l’influsso greco, latino ed italiano. Tale è, a volte deve essere resa con a, e, i, o, u. Rada al suo posto ha usato diversi tipi di e. Gangale, propone la y quando essa è muta; quando essa si è schiarita, fatto diffuso nell’Arberia, propone di renderla con la vocale chiara in cui si è tramutata. Fra le altre cose, Gangale ha lasciato uno studio analitico sull’uso delle lettere del sistema di Monastir, supinamente accettato, senza una valida critica scientifica e didattica. Lasciamo per un’altra volta quello che vorremmo dire più a lungo.

Paolo Emilio Savino

Nga Djadhori, jatrua bular, e nga bulureshja zonja Mëria Kuçit, ndë 16 të shën Mitrit 1839 u le, Mashqit, Pali Emili Savino, i diti i shtat bilva.

Kle vënë nga jati ta Kollexhi Nacionall i Foxhës që kur kish adhe 6 vjet; ish një djal ma tru shumë të zgjuara kaq sa ai veç kle marr nga Universitata Rregjit kur kish vetëm 14 vjet; muar llàurean ndë “Letra e Fillosofi” kur kish adhe 16 vjet. Pas muar llàurean ad honorem ndë Mediçina ta viti 1859 kur kish 20 vjet. Mbësotji mirë gluhan lëtirë, grekë, franxhezë, spanjollë, portugezë, tedeskë e shqipë; u vu të studhjoj Disenj e Muzikë e u diplomua ndë Arpë e Pjanofort.

Tek viti 1859 bëri një udhëtim kulltural tura vatur ndë universitetët e biblioteket të Italias, prana u pruar prapa e vata Napul ku kle mirëpritur e marrë ndë rradhët kullturore e njohu atje një kunesë që a desh i pë pak mot. Pas që u shua kjo dashuri, u pruar ta shpia tij Mashqit ku, pë di vitra, u vu të shëroj të vapkta a sëmur pa paguar e, shumë herë, i ndihij tura dhënë turrest pë të blijan bukan e mëdhëçinat atirva që kishan më hri.

Zgldhi të shkruamët e shënd Allfonxit e dishiroj të bëhij këlllogjër Terezjan; nga Roma, ku kish vatur si “pellegrin”, shkruajti jatit e jëmës pë të i thoj sa lëshohij nga ata e bëhij llaxarast i shën Vinxhenxit di Paoli. Bëri novixjatin Parixhë, vate misjonar ndë Merkat, India, Cina e Australia, sprishi kudo fjalana a Krishtit. I vapkët, i lodhët, i smur ma ethan a verdhë, po ma adhe shumë fuqi shpirti e mendje, erdh ndë Itallja ku kle direktor shpirtëror ta Orfonatrofi Vernerit të katundit Campagna (SA), rrojti tura parkalesur ma “murtfikaciona” e tura studhjuar pa prëjtur kurrë; e vdiq ditan 27/4/1915.

Kle polliglot, poligraf e apolojist i math e shkruajti shumë libra: *Besa e Pabesa përpara tronit të shkenxës, Manjetizm Ipnotizm e Spiritualizm, Letra Regjit, Parlamendit e Senatit, Kuestiona Romanë, Besimi Bibjas, Manual du misioner, Katolicism och Protestantism* e “Çë isht Pisa?”.

Nga ki burrë arbëresh, i shkëlqier e i urtë, na ka të mbësomi të jemi të niprat a Skënderbeut, që kle e ka të jet adhe sod drita jonë që luftojti turkun pë të mbajam e ruajam gluhan jonë e besan a krështerë.

Giuseppe Chiaffitelli

jatrua, nga Mashqiti (Pz)

Dal nobile medico Teodoro e dalla nobildonna signora Maria Cucci, il 16 ottobre del 1839 nacque a Maschito don Paolo Emilio Savino, il secondo di sette figli.

Dal padre fu messo nel Convitto Nazionale di Foggia quando aveva appena 6 anni; era un ragazzo di intelligenza molto vivace e precoce, tanto che, in modo eccezionale, venne iscritto all’Università Regia di Napoli a 14 anni appena e, dopo due anni, prese la laurea in Lettere e Filosofia quando aveva solamente 16 anni. Poi a 20 anni nel 1859 prese la laurea ad honorem in Medicina e Chirurgia; apprese bene il latino, il greco, il francese, lo spagnolo, il portoghese, il tedesco e l’albanese, coltivò il Disegno e la Musica, diplomandosi in Arpa e Pianoforte.

Nell’anno 1859 viaggiò per l’Italia visitando università e biblioteche, indi ritornò a Napoli dove fu ben accolto ed ammesso nei salotti e conobbe una contessa che lo amò per poco tempo. Spentosi questo amore, ritornò a Maschito dove per due anni si mise a curare i malati poveri, gratis; spesso li aiutava dando anche i soldi ai più bisognosi perché comprassero il pane e le medicine. Lesse gli scritti di Sant’Alfonso e desiderava farsi monaco Teresiano. Recatosi a Roma in pellegrinaggio, di là scrisse una lettera ai genitori per comunicare che si faceva frate lazzarista di San Vincenzo de’ Paoli e fece il noviziato a Parigi.

Andò missionario e diffuse instancabilmente per più di 40 anni la Parola del Vangelo in molti luoghi: America, India, Cina e Australia.

Ammalatosi di febbre gialla, povero e stanco, ma con ancora molta forza di spirito e di mente, venne in Italia dove fu direttore spirituale nell’Orfanotrofio Vernerit di Campagna (SA) e visse pregando e studiando indefessamente; e morì il giorno 27/4/1915.

Fu poliglotta e apolojista insigne e scrisse molte opere: *Fede e Incredulità davanti al tribunale della Scienza, Magnetismo, Ipnatismo e Spiritismo, Lettera al Re, al Parlamento, al Senato; La Questione Romana, La Religione della Bibbia, Manuel du Misioner Katolizism, Materialism; “Che cos’è l’Inferno?”*

Da questo uomo illustre e sapiente arbresh impariamo ad essere anche noi degni nipoti di Skanderbeg, che è stato, ed è ancora oggi, il nostro faro che lottò contro il turco perché mantenessimo e conservassimo la nostra bella lingua e la fede cristiana.



Raffaele Bloise

ka Ferma (Cs)

Jeta

Se jeta ju xhirar e vate koc'aposhta
 J'u furnun burrat andiku
 Neng janë më burrat ç'ishin një herë!
 Si ata burra andiku nani neng lehen mo
 Ndo ç'xhirarin gjithë jetën
 Neng gjën mangu një !
 Ndo ç'priri prapt oj një burr andiku
 M'thonej : « Kush janë nani ktà shamarikul? »
 Nani ngjatjin vet oj atà lesh
 E kush m'vo riqinin nd'ata vesh
 Atà pënxùn se jeta ashtù ish një herë
 Ndo ç'kishin një çik turp neng ndreqshin nd'atë manerë
 Më nisëshin këmba këmba
 E m'shtjtin atë mandjel
 E kush veni forestë e kush veni kardjel
 Me atë gaçë e atë capulë m'vejin tur'e këndurë
 Atà ishin kutjendë se bukën e kishin bushkùr
 Ai forxhar me atà fngjil tur'e xhirartur at'vëndal
 M'bëjinë petkonjë pir atë gajdhur e atë kal
 Ai barbër ç'nëng bir një ditë
 Pir një menxë grur kish shurbenej një vit
 Ai skarpar tur'e shulluar kish prit kur vinej gushti
 Sa t'i jipjin atë çik grur
 E me di fiq të thata e një rrogjik me verë
 Skalisjim nd'ata grur me një çik buk e hromer
 E me një pikez verë e tur'e çakalisur
 Këndojoen kalimeret me atë masar aprisu
 Ai masar me atë simnatur
 Pregarni atà shëjtra sa t'bëni shum grur
 Anata ndë i kish vatur se si thonej ai
 Veni e ringraxjarnej atë Zonjën Shën Mëri.

IL MONDO - Il mondo è cambiato, è andato sottosopra /
 Non ci sono più gli uomini di una volta! / Non ne trovi uno
 neanche se giri tutto il mondo / Se dal passato ritornasse un
 uomo / si chiederebbe : "Chi mai sono questi uomini da
 strapazzo?"/ Capelli lunghi, orecchini / Queste le
 caratteristiche dei giovani d'oggi! / Il mondo non era così una
 volta! / Ci si vergognava a conciarci in questo modo!/
 Lunghi cammini a piedi, mantelli sulle spalle / Asce, zappe,
 così ci si recava al lavoro cantando / Per la soddisfazione di
 aver guadagnato il pane quotidiano. / Il fabbro rigirando il
 carbone / realizzava zoccoli per somari e cavalli./ Il povero
 barbiere che non perdeva un giorno di lavoro / per la razione
 di grano doveva stentare un anno./ E il misero calzolaio
 suolando le scarpe / aspettava il mese di agosto per il
 compenso del lavoro fatto / E durante la mietitura un frugale
 pasto di fichi secchi, / pane, lardo e vino. / E falciando le messi
 i contadini intonavano canti /e pregavano i Santi per un
 abbondante raccolto / E quando tutto andava secondo i loro
 desideri / ringraziavano la Regina del Cielo.

Francesco Scaravaglione

ka Spixana (Cs)

Jetë arbëreshe

Kur ca her dal ka shpia
 vete jasht ku më hapet gjitonia
 shpi të vjetëra pa njeri
 të mbullitura sikur jan filaqi...
 Shoh ballkune pa një lule
 e te grastat të thajtura trandafilet....
 duket se moti ju ndrrua
 e te katundi gjithësë' vate ju shua!
 Si një zjarr pa fngjil, si jë mëm pa një bir
 si një det pa më verë, si një mal pa më borë
 si një lot pa një qar, si një dashuri pa mall
 çë te zëmra më deznjën një hall
 çë më vret daledalë....

E thërres sa më fort ndër vinele si një pac
 sa të zgjonj te katundi kush neng ka më një cik forcë
 e të vete zgjonj kush fjë, kush neng pënxarën kush rri
 qet
 sa të dhezmi ndë gjitoni kët jet arbresh
 se është e fjë, se edhe neng vdiq....

Te një sexh i shtënur një pjak
 ruan kallet te duart e një lotë
 bie posht te faqa e grisur
 e pundaret te trolli më i thajtur...

E një djal çë fjet litirë
 vete e pien ndë ç'rri mir
 u i ruanj e më lehet një pen
 se neng është më si një her
 kur te sit një pjakariq
 kish i dhezur si një drit
 një shkëndil pjot me zjarr
 e një mot pjot me ar Liri
 çë sillnej mbrënd te zëmra e madhe një magji

e neng di si kam e thom:
 më duhej se kur prirsha mbrëndë
 më dhezej ndë zëmër si një rëçet
 e neng të ndihsha maj si vet
 si të ndihem vet nani i mbullitur mbrënda ndë shpi
 ku më bën vet kumpanj vet një qetsi
 e një jasht pa shesh, pa një jet arbresh!

Klara Kodra

nga Tirana

E kam zili detin

E kam zili detin.
Me njerin krah ai
Pushton të pathyerin,
Krenarin, të patremburin
Atdheun tim,
Me tjetrin rrok shterngueshëm
Të ëmblën, gjuhë-tingëlluesen,
Diell-veshurin, rrobë-bleruarën
Vendlindje të nënës*.

E kam zili detin.
Unë s'i rrok dot dy brigjet,
Prandaj zemra
Për të dyja më digjet.

*) Italinë

S'është ende vonë

S'është ende vonë.
Flokët ende më ndrijnë.
(po është shkëlqim i argjendit
Më tepër se i floririt).

S'është ende vonë
Në faqe
Trëndafilat ende çelin.
(po janë trëndafila muzgu, jo
agimi).
Veç zemrën kam të kuqe.
Veç zemrën e kam flakë.
S'mund të më thoni plakë.

Nebih Bunjaku

nga Prishtina

Ç'të bëj u pa ty

Ç'të bëj unë pa ty
kur ti më mungon
si i verbëri pa sy
zemra gjak loton

ç'të bëj unë pa ty
kur ty larg të kam
gojë e zemër dry
mbret vetmie jam

Ibrahim Kadriu

nga Prishtina

Të jesh shkrimtar *

Kur je shkrimtar
një botë krejtësisht tjetër je
formuar në vetën e parë
mbahesh gatitu
me mundësi sundimi
me të krijuarën shtesë kohë
me peshë të veçantë
ardhur me vetminë e ditës dhe natës
si ushtar i disiplinuar
pas ushtrimeve të rrezikshme
dhe presin urdhrat nga krijuesi

Nuk del bir nëne të jetë më i pu-
shtetshëm
se ai që i mban në rresht
ndjesitë e të gjitha rrafsheve
për t'i veshur mysafirët
që zënë vend në faqe librash
me rroba masash të caktuara
me stoli shkuar stolive
derisa qëndrojnë e presin stinët
të kapërcejnë nëpër to
sipas urdhrat të shkrimtarit

Të jesh shkrimtar
e ke botën tënde të plotë
në të s'mund të futen kuvend as qe-
veri
as programe partish
as policë e administratorë
s'arrijnë t'i vënë gishtat as grushtet
as me korruptim
në oborrin e tij nuk hyjnë
dyert askush s'mund i çel

Të jesh shkrimtar
kulla ndërton e shtron rrugë
nuk pret prokurime as donatorë
truproje e këshilltarë

mbesin pa bukë
shkrimtarit vetëm letra i duhet

Të jesh shkrimtar
s'ke kohë të vdesësh
i ke të zëna të gjitha orët
me dashuritë
e me ndonjë gotë
je i tëri i zgjuar e s'të duhet gjumi
kur je vetëm
por jo i vetmuar
je mbret
pa stoli pa roja
e oborrtarë
dhe vetëm pena di të trimërojë
të ruaj pushtetin e plotë

Të jesh shkrimtar
tërë botën
e mban n'sirtar
nën dry të shpirtit larg të tjerëve
dhe ke kohë për kohën e saj
që ikë përditë
me zhurmë shurdhuese
me kundërmim

Të jesh shkrimtar
Kosova të falet tërësisht
me këngë e me vaje priten e zë në
çdo stinë
asgjë nuk mban të mbyllur
derisa strehohet në varg
me gjithë peshën e dashurisë
të mbetet në përjetësi
ashtu siç është
kokë-lartë

* Poezi e zgjedhur nga vëllimi më i ri,
"Frymëmarrje në shtjellë".

ç'të bëj unë pa ty
si nata pa hënë
si malet pa lisa
si fëmija pa nënë

ç'të bëj unë pa ty
si toka pa qiell
si qielli pa yje
si dita pa diell

Ç'të bëj unë pa ty...

Zef Chiaramonte

letrar, nga Sëndahstina (Pa)

Mëmës time, ditën e lamtumirës

e para fjalë çë na del ka goja
je ti Mëme
Mo' të duam kur qeshëm
Mo' të kërkojmë kur klamë
Mo' kur gagonalisemi fëmijë
Mo' kur trima luftojmë për liri
Mo' kur na i japën me dy krerë shkupinjtë
Mo' kur jemi sëmur e pa fuqi
Mo' kur dehemi pa verë
Mo' kur edhe pleq njëqint-vjeç
ngë dimë si zëhet vendi i mbrazët
çë lë ti

A MIA MAMMA, NEL GIORNO DELL'ADDIO -

la parola che per prima balbettiamo / sei tu Mamma /
Mamma ti vogliamo nella gioia / Mamma ti cerchiamo
nel dolore / Mamma se bimbi a scroscio ridiamo / Mamma
se giovani libertà vogliamo / Mamma se ci tirano le pietre
/ Mamma se ammalati e senza forze / Mamma se ubriachi
senza vino / Mamma quando pur giunti a cent'anni /
colmare non sappiamo il vuoto di te /
che ci lasci.

(Palermo, 25. 12. 2012)

Schirò Demetra

bibliotekare, nga Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Thurje shkumje

Të lip
pasqirimit të ujërave
dhe
erës të algave

Shpirti
i këllonave¹ të rara
shuhet lart
tue dishiruar zjarre
të pëlhurave të shqerra²

Brënda
thurje shkumje
shkrihen
frihen
teksa tërhiqen
dejtjit gjeshur³ gjumi

TRAME DI SPUMA - Ti chiedo / ai riflessi / delle acque
/ e / all'afrore / delle alghe // L'anima / di colonne reverse
/ spira lontano / anelando fuochi / di tele lacerate // Dentro
/ trame di spuma / si disfano / si compongono / al flusso /
di risacche impigrite

1) i shtyllave; 2) të çjerra; 3) i mbrujtur.

Carmine Stamile

mjeshtër arbrishtit, ka Shën Japku (Cs)

Jeta është e bukur

Jeta është e bukur për atë çë ndien adurin e luleve edhe kur ato janë të musharmë;
Jeta është e bukur për atë çë ndien sapurin e pemeve edhe kur ata janë të sfarmë;
Jeta është e bukur për atë çë di e godhirën ngjiret e detit edhe kur ujët është trubull;
Jeta është e bukur për atë çë sheh dritën e ijëzëve edhe kur qielli është i vrëjtur;
Jeta është e bukur për atë çë di e qeshën me djalërat e di e qanë me ata kur i çahen lodhërat;
Jeta është e bukur për atë çë di të dhuronj një gaz, kur nëng ka faregjë të ja jap, atij çë i ndën dorën;
Jeta është e bukur për atë çë ka harë kur mund ndihënj atë çë nëng rri mirë ;
Jeta është e bukur për atë çë do mirë ngaherë shoken o shokun edhe se ajo o ai nëng e meriton;
Jeta është e bukur për atë çë gjën ngadita motin sa të shoqëronj atë çë jeton i vetëm;
Jeta është e bukur për atë çë qeshën ngaherë e është i mirë sa të 'shehënj shërtimim e tij ditullor;
Jeta është e bukur për atë çë bie, po di të ngrëhet e di të verë përpara pa mallkuar;
Jeta është e bukur për atë çë di të përqafonj burrin i bazhdunisur ndë kurm e ndë shpirt e di t'e ndihënj sa të mund
ndërrohet;
Jeta është e bukur për atë çë di të ndëlenj e di të dashuronj gjithë ata çë e duan keq;
Jeta është e bukur për atë çë ngadita hiripsën Perëndinë për atë çë i jep, tuke thën: Zot, u bëftë ngadita dùamja
jote.

Buzëdhelpr

ka Purçilli (Cs)

Qetësia ime, mëria jote

Të trubullova ajrin që nduke
të meringova edhe ujit që pive
E çdo fjalë mirmagë
mbi qetësinë tënde
e çdo fjalë mjegull
mbi sytë e tu
e çdo fjalë kamnua
mbi ndjenjat e tua
e çdo fjalë helm
mbi buzët e tua
E nani që të trubullova ajrin e ujit
e të dënova qetësisë
e të mjergullova sytë
e të kamnisa ndjenjat
e të helmova buzët,
nani do të qetem edhe u
Qetësia ime
mëria jote
Qetësia jote
mëria ime

Pierfranco Bruni *

mëmatacë spixanjote, ka Sullarënxa (Cs)

1.

| | |
|--------------------------------|----------------------------|
| Forse | Thomse |
| A ricordare il vento | kur mbanj mend ajrin |
| Ascolto | gjëgjënj |
| Il gioco della tua voce | lozjen e zërit tënd |
| Che segna | që shënon |
| La vita dei giorni camminanti. | rrojten e ditëvet ç'ecjën. |
| Ora | Nani |
| Ti avverto | të ndienj |
| Come un volo d'aquila | si nj'fluturim shqiponje |
| Nello spazio | te hapësira |
| Che ha raccontato | që rrëfyejti |
| In un solo attimo | te një tul herë |
| Il tuo e il mio tempo. | motin tënd e timin. |

(pruar arbërisht Agostino Giordano)

* Poesia tratta dal volume **“Come un volo d'aquila”** (Mio padre mi diceva di amare con la passione del guerriero), pag.19, (senza titolo, contraddistinta solo dal numero 1), a cura del Centro Studi e Ricerche Francesco Grisi, coord. edit. di Micol Bruni, Edizioni Nemapress, Roma/Alghero 2013.

Giuseppe Gallo

mësue arbrishti, ka Shën Marcani (Ta)

Trëndafilë t'egra

Prapa nde një mur
të njuti masi gjëmës hëngrë
ka moti, mjellër ec
gje ka kush, kaq
e adhe kaq mot prapa,
rronjën një parë rrëze

trëndafilë t'egra.
Kur ishtë moti, nxjerrën
lule të bardha si borë.
Ndë mes gjithë ato glimbe
e shtrunfune të fiqëve,
duken si nuse që
jesën e vënjën kurorë.
Ato trëndafilë t'egra
janë kaq e adhe kaq
të ndarë, se, kur i vren,
zëmëra të 'blohët gaz.

LA VITA È BELLA - La vita è bella per chi sa apprezzare il profumo dei fiori anche quando questi sono appassiti; / La vita è bella per chi sa gustare il sapore dei frutti anche quando questi sono molto maturi; / La vita è bella per chi riesce ad ammirare i colori del mare anche quando l'acqua è torbida; / La vita è bella per chi riesce a vedere la luce delle stelle anche quando il cielo è nuvoloso; / La vita è bella per chi sa sorridere con i bambini e sa piangere con loro quando i giocattoli si rompono; / La vita è bella per chi sa regalare un sorriso, quando non ha niente da dare, a chi gli tende la mano; / La vita è bella per chi prova gioia ad aiutare gli ammalati; / La vita è bella per chi sa amare ogni giorno la sua compagna o il suo compagno, anche se non lo merita; / La vita è bella per chi riesce a trovare un po' di tempo per fare compagnia a chi vive solo; / La vita è bella per chi sa sorridere sempre e sa nascondere agli altri le sue pene quotidiane; / La vita è bella per chi sa alzarsi quando cade e sa andare avanti senza imprecare; / La vita è bella per chi sa abbracciare chi è sporco nel corpo e nell'anima e lo sa aiutare a pulirsi; / La vita è bella per chi sa perdonare ed amare tutti quelli che gli fanno del male; / La vita è bella per chi ogni giorno sa ringraziare il Signore per quello che gli dà, e sa dire: Signore, sia fatta sempre la tua volontà.

At Leonardo De Martino, françeskani arbëresh

Alma Dema, doc. proc.

Universiteti "A.Moisiu", Durrës

Leonard de Martini (*it. De Martino*), preku për herë të parë tokën e stërgjyshërve të tij, në vitin 1856, i veshur me zhgunin françeskan. Bashkë me misionin e tij fetar, sillte me vete, nga brigjet e Pulies, dëshirën e madhe për ta parë Shqipërinë të çliruar, zonjë të madhe, ashtu si e kishin lënë stërgjyshërit e tij shekuj më parë.

U vendos, së pari, më banim në Shkodër, aty ku ishte edhe kryeqendra jo vetëm e *Urdhrit Françeskan*, por e gjithë Veriut të Shqipërisë. Duke kaluar pjesën më të madhe të kohës së tij me shkodoranët e me malësorët e zbritur nga Malësia e Dukagjinit a gjetkë, zuri ta linte dialektin arbëresh të trashëguar brez pas brezi e të përdorte dialektin geg, dialekt të cilin e përdori si në shkrimet ashtu edhe në të folurën e tij të përditshme.

Pas takimit të parë me Shkodrën, u vendos në Troshan (*Kuvendin e Troshanit*), i cili ndodhej mes Zadrimës dhe Mirditës. Në këtë kuvend, përveçse me Fishtën (*tek i cili ushtroi një ndikim të madh*), pati mundësi të takohej, njihje e zhvillonte veprimtarinë e tij sa fetare aq edhe atdhetare edhe me At Shtjefën Gjeçovin, Imzot Vinçenc Prennushin, At Anton Harapin, At Pashko Bardhi etj.

Qëndrimi i tij në krahinën e Zadrimës e vu në kontakt me mendësinë e banorëve, me zakonet e me traditat e tyre, por mbi të gjitha me gjuhën e pasur frazeologjike.

Krijimtarinë e tij, si fillim e nisi me vjershat italiane, vargu e ritmi ishte klasik, për shkak të kulturës klasike që kishite marrë në të ri të tij. Megjithatë, trajtat e gjuhës italiane të krijimtarisë poetike, i shkriu me vargëzimin e gjuhës shqipe.

Kështu, Fishta, krijon me varg 9, 10, 11 dhe 12 - rrokësh (Lahuta e Malcis, Shtëpia Botuese Alb-Ass, 2001); Prennushi, kryesisht, me varg 8 - rrokësh (*Gjeth e lule, Botime Françeskane, Shkodër, 2006*); De Martini krijon në vargun 11 – rrokësh, të alternuar me vargun 12 – rrokësh të tingëllimave të Mjedës.

Ai ishte ndër themeluesit e tingëllimit në poezinë shqipe të shkruar. Ai përcolli, ndër të tjera, edhe forma të ndryshme poetike e metrike, qoftë kur u mbështet në poezinë tonë gojore të pasur, qoftë kur shartoi forma nga tradita letrare italiane ose nga tradita të tjera letrare. (*Njëmendësia e fjalëve, A. N. Berisha*)

Ma e madhja dit'e motmotit prap i a mrrini,

Gjith hije e gjith gazmend po vjen ndër ne;

I nalti Zot dorën e vet na shtrini,

U zdrop prej qiellit Fjala e u duk mbi dhe.

Por ai shkruan edhe në 8 - rrokësh, ashtu si në viset ku rapsodia e kreshnikëve është ndarë nga lahuta dhe ka filluar të shoqërohet me instrumente të tjerë, si për shembull, me çifteli dhe 10 – rrokëshi tipik, është kthyer në 8 - rrokësh.

Për dashni t'ka ardhë ky mik,

Me t'ba nder e jo me t'fik,

Si t'kesh mish, venë e raki,

Mrapa ishalla, për dhunti.

Na çon Zoti një tepsi

Na çon petlla e makarona,

Edhe 'i bib', në kjoftë e dona.

Ashtu si vihet re edhe në vargjet e mësipërme, karakteristikë e vargjeve të De Martin, është humori. Duke dashur të japë me kuptuar tashmë, njeh dhe përdor mirë jo vetëm gjuhën e folur, por edhe frazën, ritmin dhe rimën që krijon ajo. Por, sidoqoftë, pavarësisht meritës që i takon në lëvrimin e saj, nuk është e vështirë të dallohet në të, edhe përdorime jo të dialektit apo fjalorit frazeologjik të të folmes shkodorane, zadrimore a mirditore.

Për karshi me gatimin tradicional shqiptar e aq me shumë malësor, petulla, ai vë pjatën tradicionale italiane: makarona, pjatë e cila, në Shqipëri ka hyrë shumë më vonë [*kujojmë që kapakët e librit të jetës së tij janë 1830 - 1923*], por nga ana tjetër, nënvizon leksemën bib, që sipas dialektit shkodoran, do të thotë, një rosë e vogël, akoma e parritur mirë, gjë që dëshmon aftësinë e tij për të përdorur gjuhën shqipe, edhe me kuptime figurative e domethënëse.

Poeti françeskan, si për të përligjur momente të tilla në poezinë e tij në **L'arpa di un italo-albanese**, 1881 (Gli Albanesi, fq. 384), shprehet se shqiptarët, e sidomos pjesa shkodorane, kanë trashëguar shumë nga sundimi

At Leonardo De Martino, françeskani arbëresh

Venecian, duke gërshetuar herë – herë edhe mënyrën e jetesës.

Nga ana tjetër, në fillim të strofës, përmendet *miku*, si institucioni më i lartë i shqiptarëve, e rolin e tij në marrëdhëniet ndërpersonale, De Martini e përdor edhe në funksion të rimës, por edhe për të thelluar më tej sensin e humorit, që u përmend më sipër: *me t'ba nder e jo me t'fik!*

Ai, ishte i pari (pas Santorit) që shkroi pjesë teatrale shqip, përtej brigjeve të Adriatikut. Bëhet fjalë për Nata e Këshnellave, vepër e përfshirë në HARPA ARBNORE. Jo vetëm shkroi shqip, por edhe u shqua, madje si nismëtar i këtij drejtimi, në përkthim. Në lidhje me këtë Koliqi E. thekson: “*Në shqipe qe ndër ma të parët, qi me guxim kunorzue nga suksezi mâ i plotë, vûni dorë në përkthime të vështira nga auktorët mâ të përmendun italianë. Në vjerrsha patriotike ose me subjekt fetar shfintë në përdorim nji pasunî bukur të gjânë fjalësh. Trajta metrike, mâ ndërlikueme t'italishtes, i shartoi mâ i pari në vargënim t'onë.*”

Duke mos iu shmangur deri në fund, misionit të tij fetar, pjesa më e madhe e poezive të De Martinit (Martino-s), të shkruara në gjuhën shqipe, janë jo vetëm me fabul fetare, por edhe me argument të fortë fetar, ku poeti shprehu ndjenjat e veta përballë të gjithëpushtetshmit, Krishtit, Shën Mërisë dhe shenjtorëve të tjerë të kishës katolike.

Një tjetër meritë që i njihet Atit De Martino është se ai ishte ndër të paktët aktivistë që njihen deri më sot, që në trojet shqiptare të kenë filluar të shkruajnë shqip, në fillim të viteve 60 të shekullit XIX-të. Në këtë mënyrë, puna e tij (dhe e bashkëkohësve të tjerë me të) nis ringjalljen, ripërtëritjen e traditës letrare në trojet shqiptare.

Këtë fakt e gjejmë të theksuar po nga Koliqi E., i cili shprehet se gjuha e katundeve shqiptare (theksojmë këtu, kryesisht Lezhë, Zadrimë, Mirditë, Gomsiqe), në krijimtarinë e De Martinit, ka mbetur gjithkund e pastër, e thjeshtë, harmonioze dhe e fuqishme. Kjo gjuhë e kjo e folme krahinore *bâni me gurgullue në letersin t'onë valen e shprehjeve popullore.*

Ruga e hapur dhe e shtruar nga De Martini, do të ndiqet e do të pasurohet më tej, edhe nga shkrimtarë të tjerë të viteve 20 – 40, në Shqipëri e sidomos nga françeskanët, urdhër të cilit, ai, i shërbeu me devotshmëri, për të paktën 40 vjet.

Për të ruajtja, levrimi dhe përdorimi në letërsi, nënkuptonte edhe ruajtjen e ekzistencës e të qenesisë shqiptare e të atdheut të tyre.

Le ta ilustrojmë këtë kuptimësi qenësie me vargjet (sonetin) kushtuar Don Anton Sak Bytyçit:

*Dojshin por s'muj, arbnoren gjuh t'braktisur
M'e ngjall me shpirt: se ashtu, si trim qi e mshini
Berrin n'goj t'ujkut qi e pat vjedh ergrini
Kishim m'e pshtue dhën tòn aq fat' braktisun!*

Punës dhe veprës së tij i atribuohet edhe përgatitja shpirtërore dhe atdhetare që bëri për poetin e madh kombëtar At Gjergj Fishta. Rosalin Petrota shprehet ndër të tjera se “... në moshën e vet të njomë, me mësimet e marra nga Misjonari i madh dhe patrioti italo – shqiptar, thithi dashurine për atdheun dhe besnikërinë kundrejt kishës katolike dhe urdhrit të Shën Françeskut”.

PADRE LEONARDO DE MARTINO, FRANCESCO ARBËRESH - Il breve sguardo che abbiamo dato alla vita, all'opera e all'importanza della personalità di Leonardo De Martino, porta all'attenzione del lettore una figura che ha avuto molta influenza nella vita culturale-artistica dell'Albania nella prima metà del sec.XX. Il padre francescano ha portato una ventata di aria nuova in tutto l'ordine francescano diventando “rimestatore” della lingua dei suoi antenati, lavorando con essa e mettendo in risalto il suo suono autoctono.

Non solo col lavoro religioso, missione a cui era stato incaricato in Albania (ricordiamo che De Martino battezzò il grande poeta Gjergj Fishta), ma anche con la sua capacità scientifica, ha dato un contributo prezioso nella promozione del genere poetico, nella traduzione della lingua albanese al di là dei confini, nei chiarimenti sullo stato giuridico individuale dell'albanese al tempo di Skanderbeg e nel contributo essenziale nell'evidenziare i valori spirituali e nazionali degli albanesi.

Il lavoro e il suo servizio religioso si sono concentrati principalmente al confine tra la Zadrima e la Mirdita (il Convento francescano di Troshan); lavoro e tempo che gli fece conoscere non solo le personalità più in vista del suo ordine francescano, ma anche la parlata, il dialetto, le forme idiomatiche della lingua dei suoi antenati, mezzi di comunicazione, che lui assimilò, elaborò e presentò al mondo intero. Il suo viaggio attraverso l'Albania, per più di 40 anni, rimane come un dovere dei giorni odierni che va studiato sia sul piano sincronico che in quello diacronico, sia sotto l'aspetto storico che antropologico.

Letërsia Arbëreshe në tekstet shkollore parauniversitare shqiptare

Asime Feraj, doktorante

Vlorë

Si hyrje të këtij shkrimi dua të sjell disa fjalë nga Androkli Kostallari rreth vlerave të letërsisë arbëreshe dhe jehonës së saj në mbarë kombin: “Përpjekjet për lëvrimin e gjuhës amtare, për ta ruajtur për ta zhvilluar atë nëpërmjet shkrimit, e bënë shqipen e shkruar një mjet për të ruajtur vetqenien etniko-gjuhësore e kulturore, për të mbajtur sa më të gjalla lidhjet me Dheun-mëmë, një mjet bashkimi shpirtëror, zhvillimi e përparimi për shqiptarët kudo që janë. Shkrimi i i shqipes ka dhënë fryte me vlerë të veçantë jo vetëm për diasporën, por për gjithë kombin tonë.”¹

Janë këto vlera të padiskutueshme të letërsisë arbëreshe e cila hodhi themelet e letërsisë sonë kombëtare, ka qenë dhe vazhdon të jetë e pranishme në Shqipëri. Por sa, dhe si, njihet letërsia arbëreshe në shkollat tona. Nxënësit tanë njihen me letërsinë arbëreshe në rrugë të ndryshme si: ajo është e përfshirë në tekstet shkollore parauniversitare me kryeveprat e Jeronin De Radës, Gavril Darës; në antologji të letërsisë shqipe me autorët Lekë Matrënga me “E mbësue me Krishterë”, Jul Variboba “Gjella e Shën Mërisë së virgjër”, Jeronim De Rada me: “Këngët e Milosaos” dhe “Këngët e Serafina Topisë”; Gavril Dara “Kënga e sprasme e Balës”; Zef Serembe me poezitë: “Vrull”, “Për lirinë e Venetisë”, “Elegji” dhe “Fytyra e saj”; në botime të përshtatura për moshat e reja shkollore të cilat përdoren në bisedat letrare në orë të veçanta, ku vepra punohet e plotë, jo fragmente; në pyetjet për provimet e maturës shtetërore, ku rëndësia merr një tjetër vlerë. Portreti i Jeronim De Radës rreshtohet pranë figurave të shquara si: Naimit, Samiut, Kristoforidhit, Veqilharxhit, që me veprat e tyre mbajtën të ndezur dashurinë për atdheun dhe gjuhën shqipe.

Gjithashtu pjesë nga Serembe si poezia “Vrull”, G. Dara “Beteja e Vajkalit”, kënga dhe vallja arbëreshe sjellin një atmosferë plot emocion në konkurset dhe festat kombëtare.

- Sa përfshihet l.a. në tekstet shkollore: 2 orë në klasën e VI të VII të VIII, IX nga 65 orë kemi 3% të orëve letrare l.a dhe 5 orë në kl. X: nga 65orë gjithsej, afërsisht 8% të orëve; në klasat XI dhe XII nuk kemi të përfshirë tekste letrare nga kjo letërsi, edhe pse në programet e mëparshme janë trajtuar Serembe dhe Dara.

- Çfarë përfshihet dhe si trajtohet lënda e zgjedhur nga letërsia arbëreshe në tekstet tona. Ajo që bie menjëherë në sy është informacioni i bollshëm për autorin dhe kërkesat rreth materialit gjuhësor. Për më konkretisht hedhim një vështrim mbi pjesët e trajtuara në çdo klasë:

Në klasën e VI kemi “Kënga e Dhoqinës”.² Në përmbledhjen e këngës theksohet se kjo është një gojëdhënë e vjetër qindrvajçare, ku nëpërmjet ngjarjeve prekëse, shprehet ideja se, kur shqiptari jep besën ngrihet edhe nga varri. Prandaj quhet edhe “Balada e Besës”. Kënga vlerësohet si ndër më të bukurat e krijimtarisë popullore shqiptare. Në analizën gjuhësore dhe stilistike dallohet kontrasti, shndërrimet dhe krahasimi “Një në prak e një në derë, plasën si qelqe me verë”. Efekti stilistik, për ta dhënë vdekjen e nënës dhe së bijës tronditëse, të paharrueshme. Nxënësit njihen me format e vjetëruara të shqipes si: dolla-dolla; derënë-derën; me cin arçë-me cilin erdhe etj...

Në klasën VII kemi fragmentin “Mara”³ shkëputur nga “Kënga e sprasme e Balës”, pjesë e përshtatur në prozë. Kjo e bën më të lehtë të kuptuarit e pjesës dhe analizën e personazheve. Edhe kërkesat gjuhësore ndihmojnë në nxjerrjen e vlerave artistike dhe gjuhësore të veprës; përmendim këtu veçimin e mbiemrave në shkallën krahasore për nxjerrë në pah cilësitë e personazheve.

Në klasën e VIII kemi përsëri nga “Kënga e sprasme e Balës”, fragmentin “Kënga e Beratit”⁴, por tashmë në vargje. Në kërkesat e ndryshme gjuhësore veçojmë dallimin e vetave brenda vargut “vamë t’i flisnim s’u përgjigji...”, forma pohore në kundërvënje me formën mohore, veta e parë shumës me vetën e III njëjës, për të zbuluar idenë e vazhdimësisë së qëndrësës me gjithë humbjet e mundshme.

Detyra për të mësuar përmendësh 10-15 vargje, jo vetëm ndihmon në shijimin e pjesës, por edhe pasuron të folurit me fjalë e shprehje popullore.

Në klasën e IX kemi: “Këngët e Milosaos”⁵, kënga e parë dhe e dytë. Për autorin thuhet se De Rada është një figurë qëndrore në letërsinë shqiptare. Ai i dha kësaj letërsie vepra me vlerë të lartë artistike: “Këngët e Milosaos”, “Serafina Topia”, “Skënderbeu i pafan”. De Rada u mor me letërsi, estetikë, gjuhësi e publicistikë. Më 1898 – ’99 botoi “Autobiografinë”. Në pjesën tjetër letrare “Një letërkëmbim me Lamartinin (Fragment nga Autobiografia e De Radës)”⁶ thuhet se është një veper mjaft mbresëlënëse dhe me vlera të çmuara dokumentare.

Poema epiko-lirike “Këngët e Milosaos” shënon veprën e parë të letërsisë shqipe me vlera të larta artistike, që u përshëndet nga studiues e poetë të shquar të Evropës. Në qendër të kësaj vepre vihet historia e dashurisë së Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës, me Rinën, vajzën e një familje të thjeshtë. Vlerësimi i Kadaresë i shton vlerat veprës,

Letërsia Arbëreshe në tekstet shkollore parauniversitare shqiptare

ngjall interesin e nxënësve për pjesën dhe i nxit për të qenë më mirëpritës ndaj saj.

“Kur lexon këngën e parë, të duket sikur hap një dritare kundrejt detit dhe të magjeps e të lbyr sytë ajo dritë, ata tinguj...” - shkruan Kadare.

Kënga e parë të mbush me dëshira dhe ëndrra për jetën. Kënga e dytë do të na njohë me Milosaon dhe Rinën,- theksojnë autorët.

Tekstet shoqërohen me aparat pedagogjik, me pyetje rreth të kuptuarit. Detaje për kohën portretin e personazhit, komenti shprehje vetëvesi: “Mos më je nga dheu i huaj? / Kur i vogël, në Selanik vajta, vashat nuk ishin / në katund me kaq hir”, apo: “Ngriti ballët e zbuluar”.....

Për stilin dhe gjuhën. Gjetja e figurave stilistike: fshihet dielli / dhe rrëzoi hijen e lisit / Gjaku im te lumi i Vodhit (shpjegohet emri i lumit Vodhi dhe kërkohen vlerat e tjera që fiton fjala këtu, si dhe simbolika e lumit. Ndërtimin sintaksor “...në një të trembur hare”.

Detyrat: Gjeni poezinë “Kroi i fshatit tonë” të Lasgush Poradecit dhe bëni krahasimet me këngën e dytë të Milosaos. Ose Arbërishtja është një variant i shqipes, që flitet nga shqiptarët e Kalabrisë. Vini re disa dallime të kësaj të folmeje...

Një pjesë tjetër e kësaj shtëpie botuese është “Orioni” nga Xhuzepe Skiroi Di Maxho, duke plotësuar me pjesë nga natyra të gërshetuara me elemente mitologjike. Kjo e bën më tërheqëse dhe të kuptueshme pjesën.

Në klasën e X⁷ kemi “Këngët e Milosaos”: Kënga e I, II, V, XVI, XXII, dhe e XXX.

Në këtë grup orësh flitet për subjektin e veprës, për idetë dhe motivet, për formën e rrëfimit dhe strukturën, për personazhet dhe frymën kombëtare. Studim teksti vazhdon me gjetjen e figurave letrare, llojin e vargut. Rubrika me njohjen e fjalëve të vjetra të gjuhës shqipe si: mandili-shami që mbajnë gratë në kokë; çere-fytyrë, pamje; vucën-bucelë; forëmadhja-më e forta, më e guximshme; buzëhieshme-buzëqeshura; frushullon-fëshfërin; suvalë-valë, dallgë; kuptimi i tyre motivohet lehtë dhe ndihmon në të kuptuarit e pjesës, por ndërkohë i bën nxënësit më të mprehtë nga ana gjuhësore për të kapur ndryshimet fonetike, morfologjike apo leksikore, që shqipja ka bërë në shekuj.

Interes shfaqin edhe kërkesat e detyrave në këto tema. Kërkesës ‘Kthe në prozë dhe në gjuhën letrare’, nxënësit i duhet një kohë e caktuar për t’u marrë me çdo fjalë. Kjo i jep mundësi të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje arbërisht, të cilat mund të përdoren si ilustrime në orët e “Historisë së gjuhës shqipe”, apo “Gjuha letrare dhe dialektet”.

Përfundime

Të gjitha këto flasin për një punë të kujdeshme që bëhet në shkollat tona në përzgjedhjen cilësore të pjesëve letrare përfshirë këtu edhe pjesë nga letërsia arbëreshe, e cila hodhi themelet e letërsisë sonë kombëtare. Megjithatë gjendja duket e mirë, ka vend për një përfaqësim më të plotë jo vetëm me autorë të mirënjohur, por edhe të atyre bashkëkohorë. Letërsia arbëreshe zë rreth 3% të orëve letrare në programet tona. Kjo flet për një numër jo të mjaftueshëm orësh pasi në këtë cikël zhvillohet edhe letërsia e avancuar. Përfshirja e kësaj letërsie në provimet e maturës shtetërore i jep asaj vendin që meriton në formimin kulturor dhe estetik të brezit të ri.

Shenime: 1) A. Kostallari, *Studime filologjike 3*, Tiranë, 1986, f. 21; 2) *Botimet shkollore Albas, Gjuhë shqipe 6*, f. 90; 3) *Botimet shkollore Albas, Gjuhë shqipe 7*, f. 99; 4) *Botimet shkollore Albas, Gjuhë shqipe 8*, f. 31; 5) *Shtëpia botuese Arbëria, Gjuhë shqipe IX*; 6) *Shtëpia botuese Arbëria, Gjuhë shqipe IX*; 7) *Centrum Production, Tiranë, 2009, f. 42.*

LA LETTERATURA ARBËRESHË NEI TESTI SCOLASTICI PRE-UNIVERSITARI ALBANESI -

In questo articolo ho trattato quanto, e come, è presente la letteratura arbëreshe nei testi scolastici pre-universitari albanesi.

In questi ultimi vent’anni, la Scuola in Albania ha subito profonde riforme, che hanno interessato anche i testi scolastici.

I testi degli alunni alcune volte hanno subito cambiamenti profondi, sia nella forma che nel contenuto.

La compilazione dei testi da parte di un autore o di più autori ha fatto sì che i testi cambiano di tanto in tanto, manca il lavoro di un gruppo di redattori; spesso si nota che, a causa dello studio linguistico, viene trascurata parte degli autori albanesi, sostituiti con autori e brani stranieri. Però, diverso trattamento è riservato alla letteratura arbëreshe: questa continua ad essere presente, grazie agli indiscutibili valori delle sue opere, come un obbligo per questo ramo della letteratura albanese, ma anche per una personale formazione dei redattori dei testi, che sono stati educati ai valori artistici di questa letteratura. Più presenti sono le opere di autori come: Girolamo De Rada con “I Canti di Milosao”, che piace e viene accettato dai giovani; Gabriele Dara il giovane con “L’ultimo Canto di Bala”; ma con rammarico vediamo che resta fuori il poeta lirico Zef Serembe o autori contemporanei come Vorea Ujko ed altri.

In ogni modo voglio sottolineare che se anche la presenza della Letteratura Arbëreshe è soddisfacente intorno al 3%, deve occupare un posto più ragguardevole nei nostri testi scolastici d’Albania.

Recension

Arbërishtja në një “Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë”

prof. dr. Emil Lafa

Universiteti i Tiranës

Vreshti, rrushtë dhe vera janë aq të vjetra sa dhe jeta e shoqërisë njerëzore. Koha kur zë e piqet rrushtë ka qenë dhe është një gëzim për të gjithë. Hardhia (dhria) i shpërblen njeriut mundimin që ka bërë, djersën që i ka rrjedhur duke punuar vreshtin, duke e i hedhur pleh e duke bërë gjithë ato që do vreshti. Pastaj rrushtë mbush kanistrat e koshat, mbush butet dhe nis e bëhet musht e verë. Të gjitha këto punë e shërbise janë shkruar e mbledhur tani në një libër. Ai që e ka shkruar librin, është profesor Andrea Shundi i Universitetit Bujqësor të Tiranës. Libri që e shihni, është **“Enciklopedi për vreshtarinë dhe verëtarinë”**.

Prof. A. Shundi i ka miq e të njohur thajse të gjithë ata që kanë vënë vresht dhe që nxjerrin verë e raki në Shqipëri. Një pjesë kanë qenë edhe studentë të tij. Po ai, duke punuar për këtë libër, ashtu si edhe për librat e tjerë që ka shkruar më parë, e ndjeu se vreshtaria (mjeshtëria e atij që vë dhe mban një vresht, *viticultura*) dhe verëtaria (mjeshtëria e atij që rrushtë e bën verë të mirë, *vinicultura, enologia*) janë dy nga mjeshtëritë më të vjetra të shqiptarëve, aq të vjetra sa dhe gjuha shqipe. Prandaj i gjurmoi këto mjeshtëri kudo ku jetojnë shqiptarët, në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi, në Greqi (te arbërorët e te çamët) dhe ndër arbëreshët e Italisë. Pra kjo enciklopedi nuk është fryt i një pune vetëm në kabinet, por edhe i një pune të madhe në terren, duke u takuar me dhjetëra e me dhjetëra specialistë. 3200 artikuj që ka ky libër për vreshtarinë e verëtarinë, të vendosur në rend alfabetik, përfaqësojnë jo vetëm një enciklopedi teknike, po edhe një enciklopedi të përvojës (eksperiencës) mijërvjeçare dhe të kulturës popullore shqiptare në këtë fushë. Titujt e artikujve janë dhënë edhe anglisht e italisht (p.sh. **Hardhi:** *Grapevine, Vine; Ceppo, Vigna, Vite; Verë:* *Wine; Vino*), dhe shoqërohen rregullisht me një a disa sinonime. Rreth 500 foto e skema ilustronjë e konkretizojnë përmbajtjen e një vargu zërash nga gjithë aspektet e prodhimit e të përdorimit të rrushtit e të verës dhe të vlerave të tyre. Autori, ashtu siç ka mbledhur me kujdes çdo gjë që ka të bëjë me vreshtin, me dhrinë, me rrushtë e me verën, ka mbledhur edhe emërtimet, termat, fjalët e tyre, dhe kështu kemi të kjo enciklopedi besoj edhe mbledhjen më të pasur të fjalëve, të shprehjeve e të proverbave (fjalët e urta) që kanë të bëjnë me vreshtin e me verën. Autori ka vënë në libër gjithë sinonimet që ka mundur të mbledhë me kujdes kudo ku ka vajtur vetë dhe nëpër librat që ka lexuar. Më kujtohet se një ndër fjalët e urta apo proverbat e parë që na kanë mësuar në shkollë, është: *“S’bëhet vreshti me urata, po me shata, me lopata!”*. Vera bashkë me bukën janë simboli i jetës, janë vetë jeta dhe këtë na e thotë fjala e urtë arbëreshe *“Bukë e verë dhe më gjë (asgjë tjetër)”*. Edhe urimi arbëresh *Rroftë gjuha jonë sa buka e vera!* do të thotë rroftë në jetë të jetëve, mos vdektë kurrë!

“Enciklopedia” e prof. A. Shundit ka vlera teknike të padiskutueshme edhe për vreshtarët e verëtarët arbëreshë dhe për cilindo dashamir të verës, sepse vreshtaria e verëtaria arbëreshe është e lashtë, vjen nga dheu i vjetër i Arbrit dhe ka qenë e mbetet një ndër burimet kryesore për ekonominë e jetesën e arbëreshëve. Habitesh kur mëson nga kjo enciklopedi dëshmitë e kultivimit të hardhisë dhe të përdorimit të verës te Shqiptarët që nga lashtësia!

Prof. Andrea Shundi (1934) është si vera e moshuar, një specialist me përvojë (eksperiencë) të gjatë; ashtu është edhe “Enciklopedia” e tij, që e meriton me të vërtetë titullin enciklopedi, se brenda në të janë të gjitha ato që ka krijuar njeriu brez pas brezi për vreshtin e për verën. Autori i ka shpjeguar bukur, qartë, shkoqur, thjesht, që ta kuptojnë të gjithë. Sa është munduar për anën profesionale të librit, aq ka pasur kujdes që ta shkruajë me një gjuhë shqipe të pastër e të qartë, të përdorë gjithë ato fjalë që ka dëgjuar e ka mbledhur andej-këtej nëpër vreshtat e atje ku bëhet vera. “Enciklopedia për vreshtarinë dhe verëtarinë” është edhe një përpjekje e lavdërueshme për të kodifikuar terminologjinë teknike të kësaj fushe. Këtu nënkuptohet edhe pasurimi i saj me neologjizma, siç janë edhe fjalët *verëtar* e *verëtari* të formuara bukur sipas shembullit të fjalëve *vreshtar* e *vreshtari*. Ky është një shembull për t’u ndjekur edhe nga specialistë të tjerë që botojnë vepra të ngjashme. Mua, si njeri që jam marrë tërë jetën me punët e gjuhës shqipe, më bën përshtypje të thellë, që në këtë “Enciklopedi”, që është një libër teknik, gjuha shqipe e këtushme me arbërishten gjallojnë për bukuri së bashku dhe plotësojnë njëra tjetrën. Kemi të bëjmë me një mbushull në arbërisht, duke arritur në 650 terma, sinonime, fjalë të urta, thënie, gjëza, doke, këngë, rite, mite etj. Një varg termash dhe sinonimesh të arbërishtes vërtet përbëjnë thesar për gjuhën shqipe të sotme, sepse janë me prejardhje nga brumi i lashtë i saj dhe jo vetëm tingëllojnë hijshëm, por janë edhe të përshtatshme teknikisht. Si të tilla mund të përmendim: *bancim* – lidhje e shermendeve dhe e lastarëve, *biljezë* – fidan, *ciarlë/cice* – kanë, *fillear* – lastar, *fytim* – mbëltrim, *kryerinë* – bucelë, *lisarjel* – pjergull, *ncëtim* – shartim,

Arbërishtja në një “Enciklopedi për vreshtarinë dhe verërinë”

ngallim dhe ngjepsje – ngjërëm, *nocull* – bërsi, *pénjith* – dredhçë, *pishnesë* – doli, *rrimurtatje* – rienësim, *shkëmesje (me kmesë)* – krasitje, *shtrydhore* – trokull, *shungasje* – larosje etj.

Po për kë e ka shkruar prof. A. Shundi këtë enciklopedi? Enciklopeditë shkruhen për të gjithë! Ndër këta “të gjithë” përfshihen: së pari ata që merren me mjeshtrinë e vreshtarisë e të verëtarisë si profesionistë ose si amatorë; pastaj të gjithë ata që duan të dinë më shumë për vreshtin, për rrushtë, për verën. Enciklopedia është dhe një manual i kulturës në këto fusha. Aty mëson karakteristikat e llojeve të ndryshme të hardhive, të rrushit e të verërave. Mëson t’i shijosh vetë më mirë dhe të ndiesh më shumë kënaqësi duke pirë nga një qelq verë në shtëpi e në shoqëri.

Autori, prof. dr. Andrea Shundi ka bërë përpjekje për të përdorur një gjuhë sa më se të dëlirë e të qëruar, madje e ka pasuruar me terma për vreshtarinë dhe verëtarinë, duke i shqipëruar ato. Nga ana tjetër, ka qëmtuar dhe paraqitur 3200 sinonime për termat përkatës. Për shembull, termi *shermend* përplotësohet me sinonimet që e qerthullojnë: *degëz, hark, mashkullor, saramendë, spalë*. Së fundi, të 800 fjalët e urta që autori i ka vendosur në artikuj të caktuar, lehtësojnë kuptimin dhe gjallërojnë përmbajtjen e vetë artikullit përkatës. Është e habitshme se sa shumë fjalë të urta, shprehje e thënie të ndryshme, po edhe gjëza, doke etj. për vreshtarinë e verëtarinë gjallojnë tek Arbëreshët. Ato përbëjnë pa dyshim një tjetër dëshmi të lashtësisë dhe të traditës që kanë pasur këto dy veprimtari në botën arbëreshe. Si margaritarë mund të vlerësohen: “*Ai qiparis dhe ajo hardhi e bardhë, që i qarkohet përjetë*”, “*Bukë e verë dhe më gjë (asgjë tjetër)*”, “*Bukë e shërbyer, verë e matur*”, “*Fyto (mbëlto) hardhi edhe në prill*”, “*Hardhia, mbretëresha e pemëve*”, “*Me një vresht e me një palë (pajë/prikë), marton një bil (bijë)*”, “*Oj e bukura si vera!*”, “*Rroftë gjuha jon sa buka dhe vera!*”. Fjalët e urta apo përthëniet në arbërisht, shprehin urtësinë popullore dhe mishërimin e këtyre dy veprimtarive për mbijetesën dhe mirëqenien e Arbëreshëve. Përmbajtjen e artikujve teknikë në “Enciklopedi”, këto fjalë të urta e filozofojnë dhe e ndriçojnë më tej. Botimet arbëreshe dhe më gjerë që janë përdorur nga autori, arrijnë në 19 tituj, ku vendin e parë e zënë fjalorët e hartuar nga autorët Emanuele Giordano, Gaetano Gerbino, Giuseppe Filippini, Giuseppe Gallo, Pasquale Scutari, si dhe nga prof. Kolë Kamsi), po ashtu antologjitë e botuara nga papas Antonio Bellusci; autori ka nxjerrë materiale edhe nga leksiku i të folmeve të një vargu trevash arbëreshe, që ka përgatitur Universiteti i Kalabrisë nën drejtimin shkencor të prof. Franko Altmarit, si edhe materiale të tjera arbëreshe që janë mbledhur nga Enrico Ferraro dhe Francesco D’Agostino (www.mondoarberesco). Meritë e profesor Shundit është se ai disa terma dhe fjalë të urta i ka qëmtuar drejtpërdrejt nga goja e arbëreshëve te katundet përreth Kozencës dhe rreth Tarantos. Qëmtimi dhe paraqitja e këtyre termave, sinonimeve dhe fjalëve të urta në “Enciklopedi”, sikurse ka vepruar prof. A. Shundi, përbën një shembull të mirë për gjithsecilin që shqipen e arbërishten i sheh si njësi themelore të shprehjes dhe të ndërgjegjes mbarëshqiptare.

“**Enciklopedia për vreshtarinë dhe verëtarinë**” ka 870 faqe të formatit të madh. Shtëpia botuese “Vllamasi” e ka punuar me kujdes nga aspekti teknik, ka zgjedhur një letër të mirë dhe lidhja e librit është gjithashtu e mirë. Për gëzimin e autorit dhe të miqve e kolegëve të tij libri doli nga shtypi në nëntor 2012, kur festohej 100-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë kombëtare.

LA LINGUA ARBËRESHE NELL’ENCICLOPEDIA DELLA VITICOLTURA E DELL’ENOLOGIA” -

Alla fine dell’anno scorso, è stato pubblicato a Tirana, dalla casa editrice “Vllamasi” (vedi su internet: botime vllamasi) l’Enciclopedia della Viticoltura e dell’Enologia, 870 pagine, formato grande (255x187 mm) e con molte fotografie e schizzi. Ne è autore prof. Andrea Shundi (1934) dell’Università dell’Agricoltura di Tirana. Egli è conosciuto anche come autore e coautore di una serie di opere sulla viticoltura e sull’enologia. L’Enciclopedia è una sintesi delle sue ricerche e della sua lunga esperienza in questo campo, includendo anche la stretta collaborazione con molti colleghi e con vignaioli e noti produttori di vino.

Andrea Shundi in questa Enciclopedia ha voluto descrivere, valorizzare e interpretare l’esperienza e la tradizione di tutti gli albanesi nella coltivazione dell’uva e nella produzione del vino, cioè ha inserito nella sua Enciclopedia anche la Kosova, i paesi in cui abitano gli albanesi di Macedonia e del Montenegro, e così anche i paesi arbëreshë d’Italia e gli Arbërorë (Arvaniti) di Grecia, visitando personalmente quei paesi e studiando molte fonti scritte. L’opera è molto ricca, ha 3200 articoli in ordine alfabetico. Il titolo dell’articolo è dato anche in inglese e italiano. Negli articoli dell’Enciclopedia ci sono decine di termini arbëreshe per la vigna e l’uva e inoltre molti proverbi arbëreshë. L’Enciclopedia è utile non solo per quelli che hanno vigna e producono vino, ma anche per tutti quelli a cui piace l’uva e il vino. Essa contiene conoscenze multiformi e valide per una vasta cerchia di lettori.

Letërsia Romantike Arbëreshe

Kastriot Marku, doktorues

Tiranë

Matteo Mandala, *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*; përktheu e redaktoi: Gëzim Gurga; Botues: “Naimi” - shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë 2012, 376 ff.

Trashëgimia letrare arbëreshe i është paraqitur përgjithësisht lexuesit të zakonshëm dhe atij profesional brenda kufijve zyrtarë të shtetit shqiptar, në trajtë të shqipëruar me përshtatje në gjuhën standard, si një materie gjuhësore e letrare për përdorim masiv larg teksteve origjinale. Bazuar në këtë problematikë, botimi i Prof. Matteo Mandalasë *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe* sjell një risi në studimet filologjike shqiptare. Përmbledhja studimore ka tetë kapituj, parë secili si një studim më vete.

Në studimin e parë të titulluar: “The crux[...] is the phrase “double lyrical narrative” për një interpretim të poemave dhe të poetikës së De Radës”, Mandala ka arritur të na japë një provë bindëse origjinare të historikut diakronik të botimit të këtyre teksteve. Studimi është një skicë interpretuese e poetikës deradiane dhe përmes tij ka shterruar këqyrjen e imët të të dhënave në dukje krejt sipërfaqësore, por me rëndësi të dorës së parë në ndërtimin gjenetik të këtyre veprave. Vetëm kështu ai mbërrin ta vendosë i qetë në shtratin interpretues qasjen kontesktuale si njësi të përvijueshme për një histori të receptimit dhe vlerësimit në poemave të De Radës. “Prejardhja e mitit pellazgjik: Jeronim De Rada dhe Giovanni Emanuele Bidera”, na shtie në një rrugëtim interesant të historisë së lindjes, përhapjes dhe shndërrimit të mitit pellazgjik prej dijetarëve arbëreshë, një histori kjo që nis që në shekullin XVIII, për të mbërritur tek autorët dominues Jeronim De Rada dhe Giovanni Emanuele Bidera, si pikëmbërritja e promovimit të këtij miti parak të arbërve në një kontekst të ri me përmasa kombëtare në prag të Rilindjes Kombëtare, si një promovim i mitit të lavdisë së të parëve, si mit i hershmërisë. Mandala, duke lënë përanash rrethanat historike, na shtie me këtë punim ndër disa të tjera imtësi ndërkulturore në këtë fillimrilindje duke dashur të skajojë kështu përsaktësime të reja sa i takon fillimeve të romantizmit shqiptar. Studimin “Për botimin kritik të Kënkës së sprasëme të Ballës: shënime filologjike paraprake”, autori duke parë pamjaftueshmërinë e leximit të kësaj poeme ndërmerr edhe një interpretim leximor krahasues të saj shqip dhe italisht si dhe skajon disa çështje autoriale të lidhura drejtpërdrejt edhe me tekste të tjera të De Radës duke përfunduar se kjo poemë e cila i dha Gravid Darës një vend nderi në letërsinë shqipe erdhi si rezultat i zotësisë së tij autoriale, frymëzimit dhe shtysës fillestare të të atit Andrea Dara, si dhe ndikimit të Alessandro Manzoni-t (autori më i dashur i Darës), prej të cilit ky huazoi njësimin e reales me idealen/të vërtetën duke u përpjekur të ndërtojë një krijim letrar mbi fakte të dokumentuara, një synim ky i fshehtë që ishte një element i njohur i romantizmit, që natyrisht Dara e solli në letërsinë shqipe me risitë e tij të përveçme.

Studimi “Për botimin e veprës letrare të Françesk Anton Santorit. Disa probleme ekdotike paraprake”, ka për objekt të tij problematikën e përgatitjes së një botimi kritik të veprës së këtij autori, si rrjedhojë edhe e problematikës lidhur me kalimin e dorëshkrimeve të tij dorë më dorë në biblioteka të ndryshme publike e private (Kozencë, Kopenhagë, Tiranë, si dhe në arkivin privat të Zef Skiroit), çfarë paraqet edhe vështirësi të identifikimit dhe klasifikimit të tyre, gjë që ka justifikuar në njëfarë mënyre mosmarrjen seriozisht të kësaj pune nga ana e studiueve të krijimtarisë së tij. Në studimin ndërdisiplonor “Çështje paraprake të botimit të veprave të Zef Skiroit”, Mandala ka lënë mënjanë shkaqet e hollësishme të përjashtimit të padrejtë të këtij autori nga historia e letërsisë shqiptare, duke u kufizuar në njoftimet e detajuara për botimet e tij të shumta (disa prej të cilave të qarkulluara me vonësë si dhe të tjera vepra në dorëshkrim), duke stabilizuar kështu problemet e tejskkrimit të këtyre veprave, me ç’rast ndërton një kronologji të këtyre botimeve dhe më në fund përmbyll gjithë punën kërkimore të këtij projekti me finalizimin, kujdesjen dhe përgatitjen e botimit vetë, duke kryer kështu një restaurim të plotë filologjik të të gjithë veprës së këtij autori. Punimi tjetër, ai me titull “Aspekte dhe momente të formimit rinor të L. Pirandello-s dhe të Z. Skiroit”, na shpërfaq lidhjet mes dy shkrimtarëve të sipërpërmendur, në një kontekst kulturor dhe njerëzor të përbashkët. Hulumtimi dhe gjetja e letërkëmbimit mes tyre, e kthen këtë punim si një pikë reference me rëndësi e që do të paraqiste interes për të tjera punime krahasuese në të ardhmen. “Gjurmime leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë”, është udhëtim i autorit në rrjedhat e leksikografisë arbëreshë përgjatë katër shekujve mbështetur në dëshmitë dorëshkrimore, kryesisht fjalorëve të shqipes dygjuhëshe etimologjikë të autorëve Nilo Catalano, Gjergj Guzeta, Nikollë Keta, Pal Skiroi, Dhimitër e Zef Kamarda, Zef Skiroi, Marko La

Letërsia Romantike Arbëreshe

Piana etj. Përmbledhja mbyllet me punimin “Një self-made man arbëresh në kohë trazirash. Mbi poezitë e pabotuara të Trifonio Guiderës.

LA LETTERATURA ROMANTICA

ARBËRESHE - Nel sec.XVII ci fu una Pre-Rinascita negli ambienti arbëreshë d'Italia, che ha poi alimentato con idee e ispirazione la grande Rinascita Nazionale nei territori Albanesi, nel sec.XIX. Questa è la tesi principale del libro di studi dell'albanologo arbëresh prof. Matteo Mandalà, nel volume *Studi Filologici sulla letteratura romantica arbëreshe*, che porta una novità negli studi filologici albanesi, nel senso che appare evidente che il sistema culturale arbëresh assunse quelle caratteristiche nazionali moderne un secolo prima che iniziasse la Rinascita nazionale albanese.

Negli otto studi della raccolta l'autore dà una interpretazione nuova dei poemi e della poetica di De Rada; un itinerario interessante della storia della nascita, diffusione e trasformazione del mito pelasgico da parte degli intellettuali arbëreshë, una storia questa che parte fin dal sec.XVIII, per arrivare agli autori principali Girolamo De Rada e Giovanni Emanuele Bidera; note filologiche preliminari per la pubblicazione critica dell'“Ultimo canto di Bala” di Gabriele Dara; alcune questioni preliminari della pubblicazione delle opere di Zef Schirò, alcuni aspetti e momenti della formazione giovanile di L.Pirandello e di Zef Schirò, basati sulla corrispondenza intercorsa tra i due; una ricerca sulle correnti della lessicografia arbëreshe; come anche uno sguardo sulle poesie inedite di Trifonio Guidera.

grua-ja, sf., donna
 grurë-t, sn., grano
 grusht-i, sm., pugno
 grykë-a, sf., bocca, gola
 guçë-a, sf., apoplezia, morte improvvisa
 guli-a, sf., torso di cavolo
 gur-i, sm., pietra, sasso, rupe
 guralë-a, sf., petrosa
 gurgull-i, sm., sorso
 gurgullë-a, sf., allocco, gufo di montagna
 gushë-a, sf., gozzo
 gusht-i, sm., agosto

GJ

gjak-u, sm., sangue
 gjakùn, avv., in qualche luogo
 gjalmër-mri, sm., laccio, legaccio, filo
 gjalpër-pri, sm., serpente
 gjallë (i,e,të), agg., vivo, vivace, attivo
 gjas, v.intr., assomigliare, sembrare

Fjalor Arbërisht - Italisht *

Giordano protopapas Emanuele

leksikolog, ka Frasnita (Cs)

(vjen ka numri 73)

gërvishënj, v.tr., graffiare, raschiare, lacerare
 gërryenj, v.tr., raschiare, grattugiare
 gëzim-i, sm. gioia, divertimento, entusiasmo
 gëzonj, v.tr.intr., rallegrare, godere
 glasë-a, sf., escremento di gallina o di uccelli
 gobaçe-ja, sf., pezzo di legno da ardere
 gogësim-i, sm., rutto
 gohjë-a, sf., gozzo
 gojë-a, sf., bocca, gola
 gomaradhe-ja, sf., maceria, rudere, ammasso di pietre
 gonë-a/-ja, sf., angolo, contrada
 gorrixë-a, sf., perastro
 gosh-i, sm., uomo grossolano, ottuso di mente
 gozhdë-a, sf., chiodo
 graminë-a, sf., burrone, precipizio
 gramisënj, v.tr., precipitare, distruggere
 graxetë-a, sf., stornello cantato dalle donne
 grep-i, sm., forchetta
 grerëz-rza, sf., vespa
 grihëz-hza, sf., lima; vipera
 grisënj, v.tr., consumare, sciupare, finire
 gropë-a, sf., fossa, buca

gjashtë, agg.num.card., sei
 gjashtëdhjetë, agg.num.card., sessanta
 gjashtëmbëdhjetë, agg.num.card., sedici
 gjatë (i,e,të), agg., lungo
 gjëgjëz-gjza, sf., faccenda, cortesia
 gjëgjënj, v.tr., ascoltare, comprendere, ubbidire
 gjel-i, sm., gallo
 gjelbër (i,e,të), agg., verde
 gjellë-a, sf., vita, esistenza; cibo
 gjër-i, sm., ghio
 gjërë (i,e,të), agg., largo, comodo, vasto
 gjëshënj, v.tr., impastare
 gjëtkë, avv., altrove
 gjëthe-ja, sf., foglia
 gjëzdhisënj, v.intr., passeggiare, vagare
 gjë-a/-ja, sf., cosa, oggetto; animale
 gjëllinj, v.intr., vivere, cibarsi, nutrirsi
 gjëm-i, sm. / gjëmë-a, sf., fulmine
 gjëmb-i, sm., spina

* Ka “Fjalori” i E. Giordano-s, (15/ka më)

Letërsia dhe Pavarësia e Shqipërisë

Pas përkujtimit të 100-vjetorit të Pavarësisë e krijimit të shtetit shqiptar nuk është aspak pa vend të flitet për marrëdhëniet mes këtij momenti kaq të rëndësishëm historik, proceseve që e paraprinë dhe e pasuan, dhe sistemit letrar shqiptar. Pa përsëritur

teoritë e kuptimet e tyre në lidhje me konceptin e lartpërmendur e duke vlerësuar kontributet e studiuesve mbi sist. Letrar këta 20 vitet e fundit, duhet thënë se roli e rëndësia e letërsisë ishte e dorës së parë si për arritjen e mëvetësisë së Shqipërisë, ashtu dhe për jetëgjatësinë e kësaj të fundit. Në mënyrë paradoksale varësia thuajse totale, e theksuar e letërsisë ndaj jetës politike, shoqërore, kulturore në vend që ta mbyste produktin e saj, e kthente në shembullin më sublim të mbijetesës e forcës përtëritëse përmes himnit që ajo i ngrinte gjuhës. Nuk dëshmohej thjesht ekzistenca e një gjuhe, por fuqia e saj. Një gjuhë e ndaluar fliste me tonet e dhimbjes por dhe të shpresës dhe dëshirës, numëronte plagët që kish marrë por ëndërronte një jetë normale, megjithëse me drojë e në mënyrë të thjeshtë i transformonte e i bënte të vetat krijimet e poetëve pararendës si evropianë dhe lindorë.

E në rast se me gjallimin e saj të përdishëm në jetën e vështirë ajo tregonte qëndresë e karakter, me krijimet sado të brishta poetike, ajo bënte të prekshëm dhe real shpirtin e një kombi të tërë. Ishte ky shpirt që do të kërkonte trupin si territor.

Atdheu i krijuar prej forcës së fjalës ka paraprirë shpesh vendosjen e kufijve gjeografikë dhe ka qenë baza mbi të cilin është ngritur ideja e kombit. Me gjithë përkufizimet e shumta për kombin, që lidhen me të drejtën e gjakut ose të tokës, të gjitha kanë të përbashkët faktin se ideja e tij mbështetet mbi kujtesën. Në të gjitha vështrimet kujtesa, memoria e përbashkët, konsiderohet si baza mbi të cilën ndërtohet ndërgjegjja kombëtare.

Kombi nënkupton një të shkuar

Marrëdhënia mes tri dimensioneve: së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes realizohet pikërisht nëpërmjet ndërtimit të një kujtese. Dhe kjo kujtesë nuk është grumbullim faktesh të ndryshme, ajo është vendosje faktesh sipas rendit, rregullimi i tyre sipas një koherence që krijon një hapësirë dhe një trajektore, kjo kujtesë është narracion.

Si mund të krijohej ideja e një tërësie, kur pjesa më e madhe e shqiptarëve e kishin të pamundur të merrnin vesh ç'ndodhte jashtë mjedisit që vetë terreni i thyer kufizonte? E vetmja mënyrë ishte të dëgjonin e t'i bënin të tyre të këngët me ngjarje të vjetra e të reja që ato rrëfenin.

Imazhi real, i drejtpërdrejtë që gjithkujt i krijohej për natyrën, ridimensionohej në poezi, ku fuqia e çdo elementi të kësaj realeje merrte përmasa të shumëfishta. Vërtet malet, bjeshkët, fushat, bregoret, çukat, krojet, ishin pjesë e jetës së gjithsecilit, por përmes tyre, përmes paraqitjes së vazhdueshme të tipareve të shqiptarit, historisë së tij, në poezi krijohej ndjesia dhe besimi i prejardhjes prej së njëjtës origjinë, i tërësisë së përbashkët, për shkak të gjuhës, të zakoneve dhe të kësaj historie të jetuar që gjente vend në krijimet poetike.

Shqipëria e krijuar prej autorëve pararendës të Pavarësisë ndërthur në imazhin e saj përfytyrime të niveleve të ndryshme që i përkasin sa botës reale dhe asaj religjioze, mitologjike, folklorike.

Poetët arbëreshë përmes imazhit që tek ta kish krijuar kujtesa, transmetimi i traditës së të parëve, sillnin vazhdimisht në krijimet e tyre atdheun e ëndërruar që ndërthurte kujtesën me dëshirën. E gjithë veprimtaria e tyre do të ishte një kontribut i paçmuar për njohjen jo thjesht të çështjes shqiptare, por edhe të kulturës e traditave të tij. Një tjetër imazh që është në qendër të krijimtarisë së tyre është ai i aristokracisë shqiptare, i princërve, princeshave e luftëtarëve, përmes të cilit jepen disa pamje të qëndresës shqiptare, jo thjesht në aspektin e luftës, por dhe të ruajtjes së traditave e të nënshtrimit të ndjenjës, kur është fjala për të mirën e përgjithshme. Siç e kemi përmendur në një tjetër vështrim mbi De Radën, Në rast se përkatësia shqiptare e dëshmia e ekzistencës së një entiteti shqiptar dilte tërthorazi në veprat e autorëve të shek. XVI - XVII, në veprën e De Radës është parësore. Shpallja e ekzistencës së një kombi shqiptar me gjuhën, historinë e traditat e papërsëritshme bëhet prej tij në disa plane e nëpërmjet disa drejtimeve. Në këtë mënyrë përpjekje që në formë të pa organizuar ishin bërë prej shekujsh, janë tashmë pjesë e veprimtarisë së një figure të vetme. shkrija e një Shqipërie të përfytyruar dhe mjedisit Kalabrez zë vendin qendror në veprat e tij. Tek "Milosao" ai këtë mjedis arbëresh e transferoi në Shkodër. De Rada krijoi nëpërmjet veprës së tij një Shqipëri ideale jo thjesht me virtytet e zakonet e saj karakteristike, por me një shtrirje të prekshme hapsinore, imazh ky që i jepte vizionit ngjyrën e profecisë.

prof. as. dr. Laura Smaqi

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
Universiteti i Tiranës

Letërsia dhe Pavarësia e Shqipërisë

“Skanderbuku i pafan” e çonte lexuesin nga Arta e Himara, në Krujë, Shkodër, Dibër, Mirditë, Elbasan, pra nëpër një territor gjeografik që ka ekzistuar si në vitet 1418 - 1440 të veprës, e vazhdonte të ekzistonte edhe në fundin e shek. XIX. Ky imazh sintezë në planin hapësinor e kohor, Kalabri e Shqipëri, shek. XV me shek. XIX. dhe lidhja mes shqiptarëve brenda kësaj hapësire që qendërohet dhe në martesën e princeshës së Artës – Serafinës së Topiajve me Nikollë Dukagjinin, është imazhi që duhet përçuar tek shqiptarët e shek. XIX.

Imazhi i Shqipërisë si territor gjeografik është mjaft i pranishëm dhe në krijimet e autorëve të tjerë të shek.19-20. Peizazhi e elementet e këtij territori na shpalosen prej Naimit, me një ngjyrim të fortë emocional.

*O malet e Shqipërisë që mbani kryet përpyjetë / Tëmerr e frikë përhapni, përpini qiejt e retë! / Keni shkëmbënj, gërxhe, lisa, lumënj dhe dëborë në gji*¹

Ajo natyrë që preket përditë prej shqiptarëve është vetë Parajsa, me malet më të bukura, fushat më të blerta, krojet më të kulluara, vendi i lulëzimit, i shkëlqimit. Në tekstet religjioze çështja e krijimit kuptohet si akti hyjnor i krijimit ose si universi i krijuar i natyrës. Në fakt këto dy aspekte janë shpesh të lidhura, duke qenë se natyra luan një rol të rëndësishëm në historinë e Lidhjes, të Aleancës së Zotit me njerëzit.

Te Fishta Hëna dhe Dielli mund të dalin fare mirë dëshmitarë të kësaj të vërtete, ashtu siç marrin pjesë në betimet e përditshme të shqiptarëve.

*Edhe hana do t'a dije,/Edhe dielli do t'ket pa,/Se per qark ksaj rrokullije,/Si Shqypnija i vend nuk ka!*²

Ndonëse terreni shqiptar e ka malin si elementin më të kudogjendur, brenda poezisë nëpërmjet tij ndërthuret realja, bota mitologjike dhe religjioze

Jo rrallë mali është simbol i pavdekësisë, parajsa jonë tokësore. Majat që duken se prekin qiellin, përveçse motive të bukura piktorale, janë rezidenca e hyjnive, e cilësive superiore të shpirtit, e forcave vitale. Pika kulmore e një zone të tërë, maja e malit që duket se zhytet në qiell, paraqet përfundimin e evolucionit njerëzor që synon ta çojë njeriun në kulmin e zhvillimit të tij.

Siç është dekori, po aq të fuqishëm janë dhe njerëzit. Toskët e gegët si dy rrfë qi shkojnë tue djegë, nëpërmjet simbolit të rrufesë, duket se vënë në vend vullnetin dhe urdhrin e të Plotfuqishmit.

Si zjarr qiellor, me forcë të parezistueshme, bipolare, ajo ka qenë simbol i plotfuqishmërisë krijuese e shkatërruese të Hyjnisë që gjeneron e shkatërron në të njëjtën kohë, instrumenti dhe arma hyjnore; simbol i veprimit transformues të Qiellit mbi tokë, por dhe i shqiptarit që do atdheun, e që me fuqinë e kësaj dashurie djeg e shkatërron gjithçka e gjithkënd që prek lirinë e tij. Imazhi Apokaliptik, mitologjik dhe evokimi i historisë së lashtë bashkohen e rrisin intensitetin e përshkrimit.

Jo vetëm si territor gjeografik, por në poezinë e këtyre poetëve, Shqipëria është shumë më tepër, është vend i shenjtë

*Dhe besoninë qëmoti / Që në Shqipëri rrij Zoti, / Vij rrëmet 'i njerëzisë / E i falej Shqipërisë*³

Naimi e P. Vasa e japin në metamorfozë të vazhdueshme imazhin e Shqipërisë. Shkallë pas shkalle shfaqet imazhi femëror, që kalon në imazhin e një nëne, e pastaj te territori (malet e fushat), tek vendi me të mirat e të këqijat e tek njerëzit që janë pjesë e tij.

Ti ke pas qenë një zonjë e randë, / Burrat e dheut të thirrshin nanë.

Ke pasë shumë t'mira e begati, / Me vajza t'bukra, e me djem t'ri / Gja e vend shumë, ara e bashkina / Me armë të bardha e pushkë ltina / Me burra trima, me gra të dlira: / ti ndër gjithë shoqet ke kene ma e mira

*Ishte mëm' e trimërisë / Edh' e zonj' e urtësisë / Shqipëria kurdoherë*⁴

Përmes Historisë së saj, është një pamje tjetër me të cilën ajo shfaqet, gjithçka që ka lidhje me të jepet me superlativa. Duket se brenda letërsisë hyjnë Historia, Gjeografia, Antropologjia, gjithçka e këtyre fushave mbështillet estetikisht.

Imazhi femëror i Shqipërisë ka qenë i vazhdueshëm në poezi. Për shkak të rrethanave dhe të dëshirës për të qenë pranë ligjërimit popullor, për të pasur sa më efekt, ajo është konceptuar në ditët e vështira si nënë pa djem, me nder të nëpërkëmbur, si e ve e gjorë, mbretëreshë pa kurorë. Në rastet e përmendura imazhi i saj ka qenë i lidhur me atë të femrës pa përkrahje, që bëhet më lehtë pre e egërsisë sipas botëkuptimit popullor. Për Fishtën:

*... teper keq Shqypnija e ngratë ka ngelun, / Teper pa nderë pse nami i saj asht shkelun*⁵

P.Vasa: *Eni t'vajtjomë Shqypninë e mjerë, / Qi mbet'e shkretë pa emn, pa nder*

Por, përkundër këtij aspekti të pafavorshëm social, imazhi femëror gjithmonë ka bashkuar dobësinë me fuqinë, ajo ka burimin e pashtershëm të fuqisë së jetës e mbetet simboli më i fuqishëm i lidhjes së njeriut me tokën.

Letërsia dhe Pavarësia e Shqipërisë

Po këta autorë në momentet e besimit e të dëshirës do t'i drejtoheshin:

Shkundu pluhnit, prá Shqypni, / Ngrehe ballin si mbretneshtë,

Pse me djelm, qi ngrofë ti n'gji, / Nuk mund t'quhesh, jo, robneshtë.⁶

Hyp fronin, prá, e sundo, Shqypni, m't' liru'mit.⁷

Për Shqipërinë /Ditët e mira /Paskëtaj vijnë, /Shkoi errësira; /Lum kush të rronjë,ta shohë zonjë!⁸

Jo vetëm e shkuara, por dhe historia e përditshme vihet në skenë dhe lejon nëpërmjet kësaj të kuptohet në mënyrë kronologjike ajo që shqetëson vendin, çfarë i ndodh atij dhe mënyrën se si ai kundërvepron ndaj asaj që i ndodh. Përveç se duke tematizuar të shkuarën, ndihmohet krijimi i një memorieje dhe duke tematizuar ndryshimet aktuale. Poezia e Fishtës, duke qenë më e vonë në kohë paraqet në këtë aspekt një dokumentacion të gjendjeve të ndryshme historike e shpirtërore të kombit, vendosur në një bosht kronologjik. Ajo dhuron një pasqyrë të historisë ditë pas dite. Përmes saj është e mundur të kuptohen situatat, aspiratat, reagimi, në njërin apo tjetrin çast historik.

Poezitë janë shkruar gjatë kohës që po përcaktoheshin kufijtë e Shqipërisë, të cilët për fatin e saj të keq ngushtoheshin herë pas here. Hedhim një vështrim mbi disa prej poezive: “Atdheut” është shkruar në 1902, “Pëng nderimi”, “Meshtari i malcis”, “Njij misjonari franciskan” në 1909, “Hymni i flamurit kombëtar” në 1913, “Ditën e të shuëmvet” në nëntor 1913, “28 nanduer 1913” në dhjetor 1913, “Nji gjamë desprimit” në maj 1914, “Per paqe t'Europës” në 1916, “Emancipacioni i kombit shqypstar” në nëntor 1920, “Shqypnija e lirë” në 28 nëntor 1921, “Burnnija” në tetor 1922. Shpresa, urimi, dëshira, zhgënjimi, zemërat e mallkimi shoqërojnë lirikat që u korrespondojnë momenteve kur fati i Shqipërisë ndodhej në udhëkryq.

Vështrimi i Fishtës është i brendshëm, ndjek me kulmin e vëmendjes dhe emocionit gjithçka që ndodh, ndryshe nga poezi të autorëve të tjerë që evokojnë të shkuar e të tashme, por me distancë e nostalgji.

Së fundi duhet thënë se krijimi poetik është një e mirë simbolike e paçmueshme në kohërat e vështira, është objekt krenarie, që dëshmon kapacitetin për të krijuar. Poezia merr prej kësaj një status fetishi, idhulli, bëhet një objekt identifikimi dhe bashkimi, duke qenë treguese e ekzistencës së kombit dhe të rangut, vendit të tij në botë. Si krijim që e lidh njeriun me sferat më të larta, qoftë dhe me vetë Krijuesin, ajo provokon krenari, sidomos te popujt që aspirojnë të përbëjnë një komb. Shqipëria e këtëre autorëve është ftesa që i bëhet çdo shqiptari për ta krijuar dhe mbrojtur atdheun të cilit i përkasin, duke e shkruar atë brenda vetes e njëkohësisht duke e parë veten si pjesë e pandashme e tij. Kjo është pikënisja e “krijimit” të Shqipërisë reale si shtet i pavarur, pa këtë përpjekje të vazhdueshme që daton shumë më herët se shek. XIX, por që organizohet në shkallën më të lartë në këtë periudhë do të ishte shumë e vështirë të realizohej mëvetësia e saj. Duke dëshmuar ekzistencën e një gjuhe, që pavarësisht kushteve, gjallonte e linte dëshmi jo vetëm ekzistence, por dhe përpunimi artistik, duke i ftuar shqiptarët që të njihnin vetveten si pjesë e një kombi që duhet të kishte vetëdijen e të qenit unik e i pangatërrueshem me të tjerët, ashtu siç ishte gjuha e tij, duke i bërë të njohura traditat e gjithshka të mirë që mbante brenda vetes e që shpesh shqiptarët nuk ishin të vetëdijshëm, letërsia merrte një rol që shkonte shumë përtej asaj që zakonisht ajo mishëron apo dhe synon, ajo kthehet në një frymë që udhëheq e merr përpara gjithshka pozitive e me vlerë për arritjen e asaj që është më qenësore për një komb, ekzistencën e tij.

Shënime : 1) Frashëri, N., Bagëti e Bukqësija, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” 1995, f.24; 2) At Gjergj Fishta, Mrizi i Zânave, Botimi VIII, Botime Françeskane, Shkodër, 2007. Të gjitha citimet janë marrë nga ky botim; 3) Frashëri, N., Parajsa dhe fjala fluturake, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” 1995; 4) Po ai, po aty.; 5) At Gj.Fishta, “Mrizi i Zânave”, vep. e cit., f. 37; 6) Po aty, f. 2-3; 7) Po aty, f. 5; 8) Frashëri, N., “Shpreh”, Lulet e verës, bot.cit. f.102.

LA LETTERATURA E L'INDIPENDENZA DELL'ALBANIA - Dopo la commemorazione dell'Indipendenza dello Stato Albanese, non è affatto fuori luogo parlare delle relazioni fra questo momento così importante storicamente e dei processi che l'hanno preceduto e seguito, e il sistema letterario albanese. Senza ripetere le teorie e i loro significati in rapporto al concetto succitato, va detto che il ruolo e l'importanza della letteratura era di prima mano, tanto per il raggiungimento dell'indipendenza dell'Albania quanto per la sua longevità. Paradossalmente la dipendenza quasi totale, accentuata, della letteratura dalla vita politica, sociale, culturale, invece di soffocare il suo prodotto, la restituiva ad esempio più sublime della sopravvivenza della forza rinnovatrice attraverso l'inno che essa innalzava alla lingua. Non si testimoniava semplicemente l'esistenza di una lingua, ma la sua forza. Una lingua proibita parlava con i toni della sofferenza ma anche della speranza e del desiderio, contava le ferite che aveva subito, ma sognava una vita normale,

Letërsia dhe Pavarësia e Shqipërisë

anche se con paura e in modo semplice trasformava e faceva sue le creazioni dei poeti precursori, tanto europei quanto orientali.

La Patria creata dalla forza della parola ha preceduto spesso la determinazione dei confini geografici ed è stata la base su cui è stata fondata l'idea della nazione. Con tutte le molte delimitazioni per lo Stato, che si legano al diritto del sangue o della terra, tutte hanno in comune il fatto che la sua idea si basa sulla memoria. Sotto tutti i punti di vista, la memoria comune viene considerata come la base su cui si costruisce la coscienza nazionale.

L'Albania creata da autori precursori dell'Indipendenza hanno intrecciato nella sua immagine idee di vari livelli che attengono tanto al mondo reale quanto a quello religioso, mitologico, folklorico. Essa è l'invito che si fa ad ogni albanese per creare e difendere la Patria a cui appartengono, facendola fondere dentro di sé e contemporaneamente guardando se stessi come parte indivisibile di essa. Questo è il punto di partenza della "creazione" dell'Albania reale come Stato indipendente; senza questo sforzo continuo sarebbe stato molto difficile la realizzazione della sua indipendenza. La letteratura, testimoniando l'esistenza di una lingua, che indipendentemente dalle condizioni, viveva e generava testimonianze non solo di esistenza, ma anche di elaborazioni artistiche, invitando gli albanesi a riconoscere se stessi come parti di una Nazione, che doveva convincersi di essere un tutt'uno e indivisibile con gli altri, così com'era la sua lingua, facendo conoscere le tradizioni e tutto ciò che di buono aveva dentro di sé. La letteratura, così facendo, assumeva un ruolo che andava molto al di là di ciò che generalmente lei incarna o a cui mira: essa diventa un'anima che guida e si carica di tutto ciò che di positivo e di valido è di aiuto per il raggiungimento di quella che è la cosa principale per una Nazione, la propria esistenza.

Spiralizmi, lëvizja e re letrare

Laureta Petoshati

shkrimtare, nga Vlora

Spiralizmi (lat. Spiralismo), është një lëvizje letrare e lindur në Shqipëri pas rënies së diktaturës komuniste në fillim të viteve 1990. Ai është një konceptim i tërë estetik dhe jo vetëm një çast i historisë letrare: bën paraqitjen e veprës letrare jo vetëm me fuqinë e fakteve, por edhe me lidhjen organike të zhvillimeve dialektike dhe historike të ndërthurur me vetëdijen e personazheve. Dihet që vetëdija nuk është e lindur, por ajo ka karakter shoqëror pasi lind dhe zhvillohet në marrëdhëniet njerëzore të epokave të caktuara historike. Spiralizmi, ndryshe nga realizmi socialist që vendosi hendeqe dhe krijoi mangësi që nuk lejuan krijimin e një realizmi të përkorë, të mundëson aftësinë për të shprehur realitetin me vërtetësi tronditëse në kohën që kemi ndryshim cilësor të botëkuptimit njerëzor dhe shfaqje të formave të ndërgjegjes shoqërore. Kulmin e tij spiralizmi e gjen te romani historik. Spiralizmi është një revolucionarizim tërësor i strukturës së romanit artistik me bërthamë historike në tërësi dhe atij historik të mirëfilltë në veçanti pasi pasqyron një botë poliedrike, zhvillim personazhesh të të gjitha niveleve, një eksperiencë kolektive bazuar në ideale të lirisë, demokracisë dhe të vlerave njerëzore, si dhe në sinqeritetin e ndjenjave me të cilat bëhet përshtetja. Gjithë personazhet, që kryesisht nuk hamendësohen por janë realë, pavarësisht emrit që u vendos autori, nuk e humbasin unitetin dhe koherencën dhe gjatë veprimtarive të tyre të ndërgjegjshme nuk ka boshllëk, ka hop, pra kalim nga një cilësi më e vjetër në një cilësi më të re. Dihet që një veprë letrare ka përmasat e veta kohore dhe hapësirnore. Koha e veprimit artistik, pra kohëzgjatja e ngjarjeve, mund të përfshijë disa muaj,

disa vjet, por edhe disa shekuj, por në spiralizëm shkruhet me hollësi se si e ardhmja ka lindur nga e shkuara, proceset e kalimit tregohen me vërtetësi tërëse si një detyrim moral i autorit ndaj shoqërisë së cilës i paraqet produktin letrar të ndërthurur me talentin e tij. Në spiralizëm vepra shtjellohet në një vijimësi kohore dhe brenda narracionit kemi shoqërim idesh ku përfytyrimet, ndjenjat dhe mendimet si dukuri psikike kanë vetinë për të tërhequr njëra tjetrën në formë spiraleje, ku një dukuri sjell në vetëdije një dukuri tjetër me të cilën është lidhur në një farë mënyre. Në përshtetjet e mirëfillta historike që u janë besnike vendeve, datave dhe njerëzve që ndikohen nga prania e njëri-tjetrit dhe ajo e natyrës kemi një spiralizëm psikologjik, një përshtetje që ndërthur në formë spiraleje bashkëveprimin e natyrës me ndijimet, perceptimet, ngacmimet, ndjenjat, mendimet, përshtetjet e vazhdueshme dhe gjendjet e brishta shpirtërore që japin mesazhe të thella nga një personazh tek tjetri, por nuk mungon as Ens Realissimum (qenia më reale), pra Zoti.

Spiralizmi, ndryshe nga realizmi, i cili është art demokratik, por hera herës bën dhe theksim të tepruar të disa elementëve të realitetit, është një lëvizje letrare që nuk e ndryshon ndjenjën e masës apo të shtrembërojnë realitetin. Madje spiralizmi, ndryshe nga natyralizmi që interesohet për nevojat fiziologjike të personazheve, interesohet dhe jep dalëngadalë nëpërmjet ndryshimeve sasiore ndryshimet cilësore që ndodhin në jetën dhe ndërgjegjen e personazheve. Në spiralizëm kemi hop cilësor të ndërgjegjes së personazheve brenda një hapësire dhe kohë të

Spiralizmi, lëvizja e re letrare

caktuar. Kur spiralja e zhvillimit të narracionit brenda një veprë letrare, sidomos të romanit historik, është me shumë fibra ose nënshtresa, atëherë kemi multi-spiralizëm. Kjo vlen edhe për veprat poetike në përgjithësi dhe poezinë në veçanti që japin një zhvillim spiral të ndjenjave dhe mendimeve duke dhënë një cilësi të re, apo duke shfaqur shkallë-shkallë në një hapësirë kohore të përcaktuar gjithë atë që ka në mendje poeti si mesazh poetik.

Si vepra të spiralizmit shqiptar mund të përmendim romanet “E penguar” e Ismail Kadaresë, “Feri i Çarë” i Visar Zhitit, “Nata e Sofie Kondilit” e Koço Kostës, trilogjinë “Vështroni Meduzën” e shkrimtares vlonjate Vilhelme Vranari, si dhe romanin “Rikthim në Ventotene” të shkrimtares vlonjate Laureta Petoshati. Mund të themi pa frikë se forma të hershme të spiralizmit janë gjithashtu dhe veprat autobiografike “Retë dhe Gurët – intervistë me vetvete” e shkrimtarit Petro Marko, si dhe “Rrno për me tregue” të at Zef Pllumit.

Ndërsa si vepra poetike të spiralizmit shqiptar mund të përmendim vëllimet 10, 11 dhe 12 të kolonës “Shtirati i Prokustit” të Miliano Stefës, vëllimin me poezi “O Tomorr në Pekin” me 60 poezi nga Kina të poetit Sinan Kërpaçi, vëllimin poetik “Kasollja e internimit” i poetit disident Dalan Luzaj, vëllimi poetik “Gjethi i kuq” i poetit Eqerem Canaj, etj. U takon estetëve shqiptarë që ta studiojnë këtë lëvizje të lindur në mënyrë të vetvetishme mbas rënies së diktaturës, por që shpreh një filozofi të re në lëvrimin e letrave apo më mirë në paraqitjen e të vërtetave historike me anë të letrave shqipe.

Kongreset gjuhësore dhe Shqipja

dr. Zamira Alimemaj

lektore në Universitetin I.Qemali, Vlorë

Dihet se qysh nga Buzuku më 1555, e deri në vitin 1908, kohë kur u mbledh Kongresi i Manastirit, për të shkruar shqipen janë përdorur 60 variante alfabetesh¹, ndër të cilët po përmendim: alfabetin origjinal të Matrëngës, alfabetin me shkronja greke të dijetarëve të Voskopojës, alfabetet e Todrit, të Veqilharxhit, të Kristoforidhit etj. Ata ishin alfabetet të bazuara kryesisht në alfabetin latin, me ndonjë shkronjë të përzier nga alfabetet e gjuhëve të tjera. Për një popull të vogël siç është populli shqiptar, kjo përbënte një katastrofë kulturore nga pikpëamja e zhdukjes së analfabetizmit. Librat që u shkruan nga priftërinjtë e Veriut p.sh. “Çeta e profetëve” e Bogdanit, nuk lexoheshin dot në Jugun e vendit, ku ishin të përhapura shkronjat greke.

Kjo gjendje shumëvariantëshe e alfabetëve krijonte – siç shprehet M. Domi – “një kaos a një babiloni të vërtetë”² në shkrimin e shqipes dhe përbënte një pengesë të madhe jo vetëm për përhapjen e shkrimit e të diturisë, por edhe për njësimin e gjuhës letrare.

Një alfabet mund të jetë i mirë, ose më pak i përshatshëm, por kriteri i vlerësimit duhet të jetë në radhë të parë se kush e përdor atë. Një alfabet që nuk përdoret në mënyrë praktike është pa vlerë. Shqiptarët kanë humbur shumë kohë me çështjen e alfabetit kombëtar.

Në vitin 1908, në Kongresin e Manastirit, u pranuan dy alfabetet barasvlerëse, ai i Stambollit dhe ai latin që përdoret edhe tani. Pas Luftës së Parë Botërore, alfabeti i Stambollit, edhe pse kishte baza të mira shkencore, praktikisht nuk përdorej më, për shkak të vështirësive tipografike. Alfabeti latin, i cili në kohën e sotme quhet

alfabeti i Manastirit, ishte sajuar mirë nga pikpëamja praktike, sepse mund të shkruhej me çdo makinë shkrimi me tastierë franceze, italiane etj. Përmendim së pari frengjishten sepse ajo ishte gjuha ndërkombëtare më e përhapur, dhe me këtë zgjidhje shqipja, së paku përse i përket alfabetit, gjendej në një nivel ndërkombëtar. Mirëpo shqiptarët që ishin jashtë vendit e kishin të vështirë ta zbatonin këtë alfabet të ri.

Në atë periudhë, nga njëra anë, bota shqiptare nuk ishte kurrë e njëtrajtshme nga pikpëamja gjuhësore dhe, nga ana tjetër, zgjidhjet e Kongresit të Manastirit nuk mund të quheshin si të pagabueshme. Jashtë vendit ruheshin tradita të veçanta të drejtshkrimit. Kjo gjë vihej re edhe në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj, qofshin këto toponime apo antroponime. Ne shumë përkthime të kohës autoret i shkruanin toponimet e antroponimet e huaja duke ruajtur ortografinë e gjuhës origjinale. Kështu p.sh. mund të veçojmë disa materiale për përgatitjen e Kongresit të Manastirit, p.sh. në një letër të Faik Konicës të botuar në gazetën “Dielli”, nr 36 te datës 3 dhjetor 1909 lexojmë :

“i çelkqyer profesor **Dr. Holger Pedersen**, nga Universiteti i Kopenhages me shkruan një letër të veçantë, nga e cila heq keto rradhë për të venë re...” (Bëhet fjalë për një letër ku Faik Konica shpreh qëndrimin e tij për mbledhjen e Kongresit të Manastirit).

Po kështu, në disa shkrime të Gjergj Fishtës vihet re se emrat e përveçëm të huaj, kryesisht ata anglezë, shkruhen duke zbatuar ortografinë e gjuhës angleze.

Kongreset gjuhësore dhe shkeljet drejtshkrimore të Shqipërisë

Përsa i përket përshtatjes në rasat e lakimit të gjuhës shqipe, herë vihet re veçimi i mbaresës me vizë, e herë shkrimi i saj bashkangjitur me emrin. Për shembull, në një shkrim të titulluar “George Gordon Byron” ndër të tjera ai shkruan: “...*Byroni* qe bir’i një familje të vjetër aristokrate...”. “...Udhëtimi i parë i *Byronit* në dhe të huaj u zgjat për dy vjet...”³

Kristo Floqi, i cili njihet si patriot që ka dhënë ndihmesë të konsiderueshme në mbrojtjen e gjuhës shqipe duke e vlerësuar e cilësuar atë si një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, në shkrimin e tij “Albania the master key to the Neareast” (“Shqypnija çilsi i pare i Lindjes s’afërme”), ndër të tjera shkruan: “...*Fillon me një parathanjë të Mr. Richard Gottheil profesuer.....Z. Dako shum i ka shërbye Shqypnis si delegate i kongresit të Komeve të pa-lirue me në Philadelphia...edhe si përfaqësues i “Vatrës” në Washington D.C.*”⁴

Në vitin 1907 Fan Noli botoi dramën e tij “Israilitë dhe Filistinë”, ku përdori alfabetin e shoqatës shkodrane “Bashkimi”. Ketu ai praktikon shkrimin e emrave të përveçëm të huaj si në original. Ai shkruante :

“... Popull i dheut shegnte te *Israil-it...*”

Kjo dramë u botua disa kohë përpara Kongresit të Manastirit. Në vitin 1910 në Paris u botua një liber shqip me titull “*Mirësia dhe ligësia prej Ghimit Krojes*”. Disa studiues mendojnë se autori i kësaj vepre ishte Nikolla Lako, intelektual e patriot korçar që botoi disa libra në Paris. Lako e botoi veprën e tij pas Kongresit të Manastirit, por me një drejtshkrim pak të ndryshëm nga ç’ishte vendosur në Manastir. Ja fillimi i këtij romani të shkurtër: “*Njerëz që kanë zakone të ven në liman të Liverpoolit n’Ingiltherre, a te Hambourg ne Germani...*”

Ky fenomen i vjetër, ndoshta i harruar gjate periudhes nga Kongresi i Drejtshkrimit deri ne vitet ’90, ka filluar te shfaqet perseri sidomos tani qe gjuha shqipe po perballet me globalizimin.

Në përkthimet e shumë veprave të huaja po rishfaqet prirja e vjetër e të shkruarit të emrave me origjinë amerikane e anglo-saksone sipas ortografisë së gjuhës origjinale, praktikë kjo e ndjekur përpara Luftës së Dytë Botërore dhe në vitet e para të pasçlirimit. Sot vemë re se praktikohen të dyja këto prirje: a) shkrimi i emrave të huaj të përveçëm sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, d. m. th. sipas shqiptimit duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe, dhe b) sipas ortografisë së gjuhë prej nga merren.

Përderisa ne kemi një rregullore të drejtshkrimit të emrave të huaj të përveçëm (sipas shqiptimit në gjuhët përkatëse), çdo mënyrë tjetër e të shkruarit të tyre është thyerje e normës së drejtshkrimit.

Të shkruarit e emrave të përveçëm të huaj sipas gjuhës origjinale nuk është një problem as i panjohur e as i padiskutuar më parë. Ky problem është shtruar për diskutim qysh në Kongresin e drejtshkrimit. dhe aty u vendos që edhe këta emra do të shkruheshin duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe, por sipas shqiptimit të tyre në gjuhën origjinale. Por sot, ndonëse nuk është në përputhje me rregullat e drejtshkrimit në fuqi, përditë e më shpesh, po lëshon shtat me shkrimet në gazeta, në revista dhe në librat që përkthehen nga gjuhët e huaja, të shkruarit e këtyre emrave sipas gjuhës prej nga merren. Madje, kjo ka marrë përmasa të atilla, saqë kanë filluar të lëkundën edhe disa prej gjuhëtarëve, studiues të mirënjohur të shqipes.

Të shkruarit sipas rregullave të shqipes është mënyra që e lehtëson mjaft punën, kur dihet se si shqiptohet një emër i huaj, sepse shqipja është gjuhë e pasur me fonema bashkëtingëllore të cilat plotësojnë pothuajse mjaftueshëm nevojat për shqiptim. Mirëpo kjo nuk do të thotë se gjithmonë kemi zgjidhje të qëlluar. “*Megjithatë, zbatimi i parimit fonetik në këtë rast nuk jep gjithmonë përfundimet e pritura, sepse sipas tij shqiptimi i huazimeve bëhet më të shumtën e herës ose fare pak i përafërt ose i gabuar; dhe ky interpretim i pasaktë fiksohet në një grafi jokorrekte që dhunon kërkesat e domosdoshme të drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit.*”⁵

Këta vitet e fundit, krahas formave normative e në përputhje me rregullat e drejtshkrimit kanë filluar të shtohen rastet e thyerjeve të ndërgjegjshme të rregullave dhe, si pasojë, emrat e autorëve të ndryshëm të huaj, veprat e të cilëve përkthehen e botohen në gjuhën shqipe, po shkruhen sipas gjuhës prej nga merren duke u bërë shkak i thyerjeve të rënda të morfosintaksës shqipe. Këta emra po përdoren pa mbaresën e shquarsisë p.sh. po thuhet: *vizitë e Bush në Shqipëri* (në vend të *vizita e Bushit në*), *udhëtim i Clinton* (në vend të *Klintonit*) etj.

Për “inerci” kjo mënyrë po gjen përdorim edhe në shkurtimet si: *drejtor i KESH, takimi i vendeve të BE, etj.*

Lind pyetja se si duhet të veprimë.

Një prej studiuesve të mirënjohur të gjuhës shqipe, Gjovalin Shkurtaç, që jo pak herë e ka trajtuar këtë problem, mendon se “*ashtu si për çdo rregull e ligj tjetër kur ka shtet ligjor, derisa të ndryshohen rregullat në fuqi, duhet të vijojë zbatimi me përpikmëri i të shkruarit sipas rregullës.*”⁶ . Por situata sot është e tillë që thyerjet e normës në këtë kategori emrash janë të shumta. Sipas studiuesit Gjovalin Shkurtaç, **zbatimi i rregullës së drejtshkrimit tek**

Kongreset gjuhësore dhe shkeljet drejtshkrimore të Shqipërisë

këta emra “ka pasur dhe ka një të mirë të madhe: lehtëson punën e të shkruarit të emrave të huaj, porse edhe e çënon mjaft dhe e dëmton saktësinë dhe rreptësinë e pasqyrimin, si edhe çënon mjaft keqas vërtetësinë anagrafike e vlerat zyrtare burokratike të emrit të personit.”⁷

Pra, nëse do të veprojmë sipas drejtshkrimit të shqipërisë, do të hasim me probleme që kanë të bëjnë me katalogizmin e veprave të një autori, apo me gjetjen e të dhënave për këtë autor me anë të internetit.

“Të shkruarit sipas origjinalit përkatës ka të mirën se mban të patjetërsuar emrin e autorit dhe mbron vlerat anagrafike të emrit, porse nga ana tjetër, shkakton edhe pëshjellim të vërtetë në shqiptimin e emrave të huaj.”⁸ Por kjo mënyrë do të shkaktonte prishje të strukturës morfologjike të shqipërisë si përsëmbull prirja që emrat e huaj të mos marrin trajtën e shquarsisë, apo dhe forma të tjera që i parashtruan më sipër.

Prandaj, “komisionet e pastrimit dhe përkujdesjes së gjuhës shqipe në bashkëpunim e në bashkëveprim sa më të gjerë me masën e arsimitarëve e njerëzve të letrave, të ndjekin dhe të shqyrtojnë nga afër çdo thyerje të normës dhe, kur të jetë e domosdoshme, mund të dalin edhe me propozime për ndonjë ndreqje apo përmirësim të pjesshëm të normës së sotme Mosreagimi ndaj thyerjeve të normës mund të lërë shteg për çarje e plasaritje të rënda të sistemit e të strukturës gramatikore të shqipërisë, të cilat pastaj do të ishte shumë e vështirë të ndreqen.”⁹

Kontaktet e drejtpërdrejta me botën e jashtme dhe ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv po krijojnë një gjendje cilësisht të re në marrëdhëniet e shqipërisë me gjuhët e huaja. Prandaj, “marrëdhëniet e gjera me jetën politike e kulturore të vendeve të tjera na e rishtrajnë çështjen e drejtshkrimit të emrave të përveçëm . Për një varg arsyesish, lexuesit shpesh i duhet edhe trajta e përpiktë e emrit në përdorimin ndërkombëtar. Në praktikën e kohëve të fundit ndeshim disa zgjidhje. Një rrugë e pranueshme do të ishte kjo: kur në tekst përmendet për herë të parë një emër i huaj, të jepet me drejtshkrimin e shqipërisë dhe në kllapa të vihet trajta origjinale. Do të ishte e pranueshme edhe e anasjellta... Drejtshkrimi i shqipërisë nuk ka për detyrë të na mësojë të lexohen gjuhët e botës, aq më keq kur kjo bëhet sipas mendjes të njërit apo të tjetrit. Për gjuhët me alfabet jo latin ka një standard ndërkombëtar, transkriptimi me shkronja latine.”¹⁰ Qysh në Kongresin e Drejtshkrimit u pat parasysh që “drejtshkrimi i shqipërisë duhet në radhë të parë, të jetë i mirë për shqiptarët . Është baza e shëndoshë teorike që i jep edhe qëndrueshmëri drejtshkrimit. Vetëm se kjo qëndrueshmëri duhet kuptuar gjithnjë si qëndrueshmëri relative. Qëndrueshmëri të përjetshme, absolute nuk ka as në gjuhë, pra as në drejtshkrim nuk mund të ketë rregulla përfundimtare në kuptimin absolut të fjalës”.¹¹

Profesor Shaban, Demiraj, në konferencën shkencore të organizuar me rastin e 25-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, shtroi si domosdoshmëri që:

“1. Të riaktivizohet Komisioni Qeveritar për Gjuhën Shqipe;

2. Të miratohet nga Kuvendi Popullor një vendim për të ndaluar përdorimin e fjalëve të huaja nëpër lokalet publike, nëpër reklamat dhe në veprimtari të tjera publike;

3. Të detyrohen gazetaret, revistat dhe shtëpitë botuese që të kenë një a më shumë redaktorë, për të mënjeluar shkeljet e rëndomta të normave gjuhësore, duke përfshirë këtu edhe mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme, si edhe ndërtimet e gabuara sintaksore.”¹²

Shënime: 1) M. Samara, Histori e gjuhës letrare shqipe, f. 105; 2) M. Domi, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, f. 28; 3) Shih M. Ndoja, Lirikat e Fishtës, f. 106; 4) L. Ahmetaj, Për çështjen shqiptare, f. 164; 5) Th. Shkurti, Mbi drejtshkrimin e fjalëve të huazuara nga anglishtja, Kong. I Drejt. f. 312; 6) Gj. Shkurtaj, Emrat e përveçëm të huaj dhe drejtshkrimi i tyre në shqipërisë e sotme, Kultura e gjuhës, f. 141; 7) Gj. Shkurtaj, Po aty, f. 143; 8) Gj. Shkurtaj, Po aty, f.144; 9) Gj. Shkurtaj, Po aty, f. 144; 10) Xh. Lloshi, Mbështetje për gjuhën letrare, f. 59; 11) A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, f. 84; 12) Sh. Demiraj, Shqipja e sotme letrare në prag të sh. XXI, 25-vjet Kong. i Drejt. f. 43.

I CONGRESSI LINGUISTICI E LE VIOLAZIONI ORTOGRAFICHE DELLA LINGUA ALBANESE -

- I contatti diretti col mondo esterno e l'influsso dei mezzi di comunicazione di massa creano una situazione qualitativamente nuova nei rapporti della lingua albanese con le lingue straniere. Nelle traduzioni di molte opere staminate riappare la vecchia vocazione dello scrivere i nomi di origine americana e anglosassone secondo l'ortografia della lingua d'origine, pratica questa seguita prima della Seconda Guerra Mondiale e nei primi anni dopo la Liberazione.

L'intento di questo scritto è quello di fare uno studio storico sullo sviluppo delle regole ortografiche fin dalla creazione del primo alfabeto della lingua albanese e di citare alcuni casi in cui queste regole vengono calpestate.

Pashko Vasa: "O moj Shqypni"

dr. Irena Fistani

Universiteti "Luigi Gurakuqi, Shkodër

Pashko Vasa ka hyrë në fondin e artë të historisë së Shqipërisë dhe të kulturës e gjuhësisë shqiptare, si figurë e ndritur dhe e shquar e Rilindjes sonë patriotike kombëtare. Atdheu dhe populli, gjuha e jonë e dashur dhe arsimit në gjuhën shqipe kanë qenë idealet që e shtynë atë të punojë gjatë gjithë jetës së tij.

Energjinë, fuqinë dhe talentin e vet, ky atdhetar, erudit e diplomat i madh, i vuri në shërbim të çështjes së madhe të çlirimit të Atdheut të robëruar në shekuj. I njohur sidomos me emrin Vaso Pashë Shkodrani, lindur në Shkodër më 1825, mësoi disa gjuhë të huaja si autodidakt dhe fitoi një kulturë shumë të gjerë për kohën, me të cilat bëri që të njiheshin në botë traditat, zakonet dhe kultura e shqiptarëve.

Veprën dhe figurën e Pashko Vasës, duhet t'a perkujtojmë edhe për rolin dhe përpjekjet e tij historike në fushën e diplomacisë, në vitet e vrullshme të Lidhjes së Prizrenit. Shohim që vlerësohet lart dhe me të drejtë nga të gjithë si poet, por po kaq i rëndësishëm është dhe misioni diplomatik i tij, që së bashku me Abdyl Frashërin dhe të tjerë Rilindas të shquar, ngritën zërin nëpër kancelaritë kryesore diplomatike të Evropës të asaj kohe, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve.

Urretja kundër dhunës e shtypjes, e shtyu atë të merrte pjesë fuqishëm rreth vitit 1847, në Itali në luftën për liri të popullit, në një vend të huaj, siç ishte rasti i pjesëmarrjes së tij në luftën e Venedikut, kundër pushtimit austriak. Mori pjesë dhe luftoi me armë në dorë në këtë revolucion, duke u treguar trim dhe me aftësi ushtarake. Aftësi të cilat, pasi u vendos në Stamboll, e ngritën në shkallën e lartë të hiarkisë shtetërore. Nga viti 1883 e deri sa vdiq, më 1892 në Bejrut, ishte guvernatori i përgjithshëm i Libanit.

Gjatë gjithë jetës së tij Pashko Vasa s'ka rreshtur së menduari për Shqipërinë dhe ka dëshiruar ta shohë të lirë, të pavarur, e të kulturuar. Veprimtaria e tij politike fillon në vitet '60 në Stamboll, ku mendjendrituri Vaso Pashë Shkodrani, u njoh dhe veproi përkrah figurave më të shquara të kombit tonë, si: Kristoforidhi, Hoxha Tahsini, Abdyl, Naim dhe Sami Frashëri, Vretoja, Isamil Qemali, etj. Vaso Pasha, së bashku me këta burra mendjendritur të Rilindjes sonë Kombëtare, bënë përpjekjet e para për nxjerrjen e alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe. Ai mori pjesë në përpjekjet për orgnizimin e shoqërive patriotike e kulturore, për krijimin e një alfabeti të shqipes dhe bashkë me Samiun ishte ndër themeluesit e Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip, ku më vonë do të botonin libra, për përhapjen e diturisë dhe arsimit në gjuhën tonë të bukur shqipe. Me këtë synohej edhe ngritja e vetëdijes të popullit tonë, si dhe krijimi i një uniteti kombëtar, shumë i nevojshëm për atë kohë, me qëllim krijimin e forcave të reja, që do t'i shërbenin çështjes madhore kombëtare.

Një nga frymëzuesit kryesorë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Pashko Vasa mbrojti me forcë çështjen kombëtare në Stamboll dhe në qarqet diplomatike jashtë perandorisë.

Ky atdhetar i madh shkroi poezi, prozë artistike, publicistikë dhe libra gjuhe.

Veprat më të rëndësishme të Pashko Vasës janë: përmbledhja me *vjersha "Trëndafila dhe gjemba"*, (1873), ku flet me zjarr e mall për vendlindjen dhe dëshiron lirinë e Shqipërisë. Më 1879 botoi frëngjisht *trajtesën: "E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët"*, në të cilën argumenton lashtësinë e popullit shqiptar, tregon vetitë e tij dhe mbron të drejtat kombëtare. Botoi më 1890 romanin *"Bardha e Temalit"*, të shkruar frëngjisht, ku përshkruan zakone e doke të jetës shqiptare në sfondin e luftës për çlirim kombëtar. Shkroi edhe një *"Gramatikë të shqipes për të huajt"*, (1887). Kryesisht në vitet 1850 – 1860, Pashko Vasa zhvilloi veprimtarinë letrare, ku shprehu idetë e tij patriotike që e frymëzuan dhe e udhëhoqën gjatë gjithë jetës së tij... Por ajo që flet qartë për talentin e tij të fuqishëm poetik, është *vjersha shqipe dhe kryevepra e tij: "O moj Shqypni"*, që zë vend nderi në krijimtarinë e tij.

Ajo nuk është thjesht një vjershë, ajo është "himni" i përjetshëm i shqiptarëve, është manifest poetik i atdhetarizmit, është thirrje për zgjim, për luftë, për bashkim, për ndërgjegjësim patriotik kombëtar. Gjithë krijimtaria e tij lidhet ngushtë me atdheun, me historinë dhe lashtësinë e popullit shqiptar, me mbrojtjen e të drejtave të tij si komb, me zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, përhapjen e diturisë në masat, bashkimi i popullit dhe afirmimi i kombit shqiptar. si komb me vete në Europë. Ai kishte besim të patundur te Shqiptarët dhe me optimizëm shihte të ardhmen e lumtur të tyre. Ndër monumentet e tij shkrimore, kurdoherë mbeti aktuale, e pastër dhe e shëndoshë, sidomos për mesazhet e saj, poezia e mirënjohur: "O moj Shqypni", e cila edhe pas kaq vitesh, nuk e ka humbur vlerën e saj letrare artistike dhe kombëtare! Kjo vjershë është njëra ndër krijimet më të mira të letërsisë sonë, që i përket Rilindjes Kombëtare. Ajo duke qarkulluar dorë me dorë u bë kushtim i kohës, i sepse në të bëhej thirrje për bashkim kombëtar dhe rezistencë të fuqishme kundër lakmive pushtuese të fqinjëve tanë hegjemonistë.

Poezia e Pashko Vasës fillon me një ton vajtues e që perputhet me frymën romantike të kohës. Poeti me një pyetje

Pashko Vasa: "O moj Shqypni"

retorike, që nuk pret as përgjigje, i drejtohet Atdheut të robëruar:

O moj Shqypni, e mjera Shqypni,
kush të ka qitun me krye në hi

Por për t'ja kundërvënë gjendjes aktuale të mjeruar, ai me krenari kombëtare kujton të kaluarën e Atdheut, ashtu siç bënin të gjithë rilindasit, duke personifikuar dhe quajtur Shqipërinë, një "Zonjë e randë, të cilën " burrat e dheut e thirrshin nanë".

Duke evokuar lufrat e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, si dhe të gjithë kryengritjet e parreshtura të vegjëlise kundër sundesit shekullor otoman, ai shprehet:

Kur ka lidhë besën burri i Shqypnisë
I ka shti dridhën gjithe Rumelisë
Ndër lufta t'rrepta gjithkund ka ra
Me faqe t'bardhë gjithmonë asht da.

Në atë kohë, Rumeli quhej ajo pjesë e Ballkanit, që ishte pushtuar nga Turqia dhe prej ku niseshin forcat ushtarake, për të shtypur revoltat popullore në Shqipëri. Duke shkruar kundër kësaj dhune dhe me qëllim për të nxitur krenarinë e ligjshme kombëtare, ai shkruante: "A mos është krim që ta duash vendin tënd? Ajo që është një cilësi dhe një virtyt për të tjerët, s'ka se si të jetë gjë tjetër për ne. Dëshira jonë e madhe për të parë vendin tonë të lirë e bën vullnetin tonë edhe më të fuqishëm, edhe më të shenjtë dhe të pandalshëm"...

Mesazhi i vjershës kulmon me kërkesën për dënimin e ndasive fetare e krahinore, ku ngriti zërin e dha kushttrimin për kryengritje të armatosur, kundër pushtuesve të tokave tona. Ajo u shkrua e frymëzuar nga aspiratat për t'a parë Shqipërinë të lirë, të përparuar e plot dinjitet. Pashko Vasa nuk kishte besim as te faktori i jashtëm as te borgjezia feudale e vendit dhe as te kleri, por bënte thirrjen:

..". Kujt i ban zemra me e lan me dek,
Kët farë trimneshe qi sot asht mek?
Kët nanë të dashtun a do ta lamë,
Që njeri i huej ta shklas me kambë?
Çonju shqyptar prej gjumit, çonju!
Të gjith si vllazën ne nji besë shtrëngoju
E mos shikoni kisha e xhamia,
Feja e shqyptarit ashtë shqiptaria!
Qysh prej Tivarit deri në Prevezë
Gjithkund lëshon dielli vap` edhe rreze
Ashtë toka jonë të parët na e kanë lan'
Kush mos na e prekin se desim t'tanë."..

Figuracioni i pasur e shprehës, epitetet, krahasimet, pyetjet retorike plot ngarkesë emocionale, shkodranishtja e kuptueshme dhe e ëmbël e bënë atë aq ndikues tek masat. Vargu dhjetërokësh i jep poezisë një ritëm marshi, në përputhje me përmbajtjen, duke sintetizuar thuajse gjithë idetë e lëvizjes kombëtare: krenarinë për të kaluarën, dashurinë për vendin, urrejtjen për robërinë, thirrjen për bashkim, vjersha "O moj Shqypni., u bë një nga kryeveprat poetike të Rilindjes.

Poezia "O moj Shqypni", është një nga krjimet më të bukura letrare të Rilindjes sonë. Venia e çështjes së Atdheut mbi çështjen fetare, ishte një fitore e madhe e lëvizjes atdhetare të kohës. Një kapitull të veçantë zënë edhe shkrimet e tija publicistike të shkruara në gjuhën shqipe, por edhe në disa gjuhë të huaja: shkrime këto që u botuan në shtypin e kohës dhe që kishin për qëllim ta bënin të njohur qëndrimin e shqiptarëve.

Vaso Pasha ishte dhe mbeti ndër figurat më komplekse në historinë e Lëvizjes sonë Kombëtare, i mirënjohur si intelektual, historian, publicist, romancier, diplomat dhe atdhetari i shquar, i cili tërë jetën e vet e vuri në shërbim të Atdheut. Kombi ynë për herë do të mburret për fatin e mirë, meqë në gjirin e vet mban me respekt figurat e shkëlqyera si Vaso Pashë Shkodranin. Jeta dhe vepra e Pashkos janë bërë pjesë e pandashme e historisë dhe e letërsisë së popullit shqiptar.

Vetëm një atdhetarizëm i flaktë mund të krijonte vargje me një forcë të tillë, vargje që shpallën parrullën e madhe rilindase se kombi është mbi çdo fë, se "shqiptaria", atdheu, e ardhmja e tij janë gjithçka. Vjersha "O moj Shqypni., është një nga krjimet më të frymëzuara të poezisë shqiptare.

Udhëtimi në Europë i Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vronit

dr. Denisa Tare

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Kongresi i Berlinit (1878) me vendimet e tij synoi të ndryshonte hartën ballkanike. Fuqitë e mëdha po përgatitnin një hartë të re politike për gadishullin Ballkanik, në të cilën Shqipëria u trajtua si zoterim turk. Zyrtarisht Kongresi i Berlinit u thirr për të rishikuar traktatin e Shën Stefanit, që perandoria Ruse i kishte importuar Perandorisë Osmane në përfitim të saj dhe aleateve të saj Ballkanik. Por realisht synimi i vërtetë ishte ajo që u përmend më lart, hartimi i një harte të re politike të gadishullit Ballkanik në kurriz të trojeve të Perandorisë Osmane dhe duke siguruar përfitime territoriale që do të gëzonin shtetet që kishin luftuar kundër Perandorisë Osmane: si Rusia, Bullgaria, Serbia, Rumania dhe Mali i Zi. Kongresi i Berlinit synoi të vendoste një "rregullim" politik në Evropën jug-lindore dhe një "kostelacion" të ri shtetesh në gadishullin Ballkanik që do të zëvendësonte sistemin politik të vendosur me traktatin e Parisit (1856). Në të njëjtën kohë u zgjidhën dhe një sërë çështjesh të tjera që lidheshin me krizën lindore. Në këtë Kongres paraqiten pretendimet e tyre territoriale dhe vendet Ballkanike, pretendime të cilat cënonin hapur tërësinë territoriale të Shqipërisë. Pretendimet kryesore vinin nga dy fqinjët më të afërt Ballkanikë të Shqipërisë, Serbia dhe Greqia. Nëse Serbia pretendonte territoret veriore kryesisht rajonin e Kosovës, Greqia shprehu pretendimet e saj për të aneksuar Epirin, Thesalinë, Kretën dhe pjesën jugore të Maqedonisë. Kongresi parashtroi me 5 korrik 1878 kërkesën për miratimin e rezolutës, e cila është regjistruar në protokollin 13. Sipas tij, Kongresi fton Portën e Lartë - thuhet në rezolutë - që të merret vesh me Greqinë për një ratifikim të kufinjve në Thesali dhe në Epir dhe është i mendimit se ky ratifikim mund të ndjekë luginën e Salamvrias nga krahu i detit Egjë dhe ate të Kallamasë nga ana e detit Jon". Kongresi - thuhet më tej në rezolutën e protokollit 13- ka besim se palët e interesuara do të arrinë të merren vesh; megjithatë, për të lehtësuar konsensusin e bisedimeve, fuqitë janë gati të ndërmjetësojnë ballë për ballë të dyja paleve".¹ Qëndrimi negativ i Kongresit të Berlinit nuk u shpreh vetëm në mohimin e çështjes shqiptare si subjekt të drejtash kombëtare, as vetëm në trajtimin e Shqipërisë si objekt copëtimi territorial në favor të fqinjëve ballkanik por edhe në drejtime të tjera. I tillë ishte dhe neni 23, i Traktatit të Berlinit, sipas të cilit detyrohej Perandoria Osmane të zbatonte "reforma" në krahinat e saj ballkanike. Sipas këtij neni, Perandoria Osmane duhet të zbatonte në vilajetet e Turqisë Europiane rregullore organike (reforma të brendshme) të cilat do të lehtësonin gjëndjen e popullsisë jo turke që do të mbeteshin nën sundimin e saj. E drejta për të ndërhyrë nga ana e Fuqive të Mëdha përmes Portës së Lartë u dha mundësinë që u jepnin këtyre vilajeteve, ashtu siç shkruante Abdyl Frashëri karakter jo shqiptar, por duke i dhënë karakter serb në Kosovë dhe grek në Janinë. Me zbatimin e neni 23 lehtësohej puna për aneksimin e trojeve shqiptare të këtyre vilajeteve nga monarkitë fqinje, dhe vështirësohej lufta e shqiptarëve për bashkimin e këtyre trojeve në një vilajet të vetëm dhe autonom.¹ **Berliner Tageblatt (15 korrik 1878)** shkruante të nesërmen e mbylljes së Kongresit se: *Paqja e Berlinit përfaqson një kompromis, që nuk kënaq askënd, por që garanton paqen në Evropë për një periudhë të shkurtër. Rusia kërkonte shumë pak, Anglia lëshoi shumë dhe më tepër. Austria futi hundët në follenë e grenxave të sllavëve, kurse shtetet e vogla (ballkanike) janë të mërzitura ...Italia dhe Franca u larguan duarbosh dhe mërmëritnin, megjithatë ndërmjetësi i paanshëm fërkon duart, sepse kartat janë përzier asisoj, që koalicioni i planifikuar antigjerman të duket më i pamundur se kurrë. Dhe këtu qëndron fitorja jonë në paqen e Berlinit.*²

Vendimet e Kongresit u pritën negativisht nga masat e gjera popullore, zemërimi i të cilëve u drejtua kundër Fuqive të Mëdha që shkelen të drejtat kombëtare të shqiptarëve, si dhe kunder Portës së Lartë që pranoi copëtimin e tyre. Protokollin 13 i vendosur nga Kongresi i Berlinit synonte caktimin e kufinjve jugore, fakt i cili do të realizohej përmes bisedimeve turko-greke. Reagimet ndaj vendimeve të Kongresit të Berlinit qenë të menjëhershme si në veri dhe në jug, ku përmes programit patriotik të lidhjes dhe me miratimin e gjithë opinionit publik, u kundërshtuan hapur këto vendime përmes peticioneve, memorandumëve.... etj., duke realizuar njëkohësisht dhe mbledhje lokale ku u shprehën fuqimisht për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. por në çastin e duhur. Në ndryshim nga situata në Shqipërinë veriore e cila ishte tepër e rëndë e shoqëruar me ngjarje tronditëse siç ishte revolta e Gjakovës, situata në jug të Shqipërisë ku, sipas traktatit të Berlinit, Greqia siguronte përfitime territoriale, linte shteg për diskutim pasi vendimi nuk ishte i formës së prerë. Ky fakt i dha patriotëve shqiptarë në jug më tepër kohë për t'u përgatitur për të kundërshtuar pretendimet greke dhe për t'i kushtuar kujdes lëvizjes autonomiste. Pikënisje për luftën diplomatike që u zhvillua rreth caktimit të kufirit turko-grek, i cili i implikonte vise shqiptare të Çamërisë, u bë protokollin 13 i Kongresit të Berlinit. Për zgjidhjen e çështjeve të kufinjve jugorë u mbajt në Prevezë një kuvend përmes të cilit do të zhvilloheshin bisedimet osmano-greke lidhur me caktimin përfundimtar të kufirit.

Udhëtimi në Europë i Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vronit

Cili qe qëndrimi i Fuqive të Mëdha ndaj Perandorisë Osmane? Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria vazhduan të ushtronin presion ndaj Stambollit për ta detyruar të zbatonte protokollin 13. Franca mbante një qëndrim pro interesave greke dhe kërkonte nga Porta e Lartë të pranonte rishikimin e kufirit turko-grek në bazë të rekomandimit të Kongresit të Berlinit, të emërtonte komisarët e saj së bashku me ata grekë të shqyrtonin vijën kufitare (të re). Protokollin 13 i Kongresit të Berlinit, dhe neni 24 i traktatit të Berlinit, cënonte fuqishëm tërësinë territoriale jugore. Me propozimin e Frances dhe me pëlqimin e Italisë, fuqitë e mëdha vendosën me 5 korrik 1878 përmes protokollit të 13 të Kongresit të Berlinit të kënaqin Greqinë me përfitimet territoriale në kurriz të Perandorisë Osmane, në sektorin e Epirit dhe të Thesalisë, pa përcaktuar as një kufi të prerë, por duke rekomanduar si vijë në Epir lumin Kalamas, dhe në Thesali lumin Slemvria. Greqia, e bindur se kishte krahas saj fuqitë e mëdha, nuk e llogariti fare faktorin shqiptar, të njëjtën gjë bëjnë edhe fuqite evropiane. Porta e Lartë hezitonte të zbatonte vendimet e Kongresit të Berlinit duke e lidhur këtë hezitim me faktin se zbatimi i këtyre vendimeve do të shkaktonte zemërimin e mbarë shqiptarëve që ndodheshin brenda kufinjve të saj. E shqiptarëve të degëve të Jugut dhe të Epirit, komisarët osmanë në seancën e pestë, dhe të fundit, të mbajtur më 18.03.1879, i ofruan partnerëve të Greqisë një zgjidhje të re. Pasi u konsultua me Stambollin, Muhtar Pasha i rekomandoi Athinës si kompensim një rryp të ngushtë të tokës krahas me kufirin natyror që nisej nga Vollo dhe duke shkuar në Farsalë, Kardhicë, pra duke ndjekur kufirin ekzistues ajo vijë e propozuar përfundonte në lumin Aspropotamos. Por komisioni grek refuzoi ofertën dhe negociatat u ndërpre, dhe më 19 mars ata braktisën Prevezën.² Pas dështimit të dialogut greko-osman marrëdhëniet shqiptaro-greke morën të tatëpjetën. Mbas ndërprerjes së bisedimeve greko-turke, Lidhja zgjodhi Abdyl Frashërin dhe Mehmet Ali Vronin, një tjetër ish deputet dhe anëtar i familjes kryesore të Beratit, si delegat të vet për mbrojtjen e integritetit tokësor të Shqipërisë para qeverive të Fuqive të Mëdha. Delegacioni që shkoi në Evropë u shpërndau qeverive të fuqive të mëdha një memorandum në të cilin ata ankoreshin se që nga dita e pavarësisë greke, helenizimi ishte duke u përpjekur të përgatiste mënyrat dhe mjetet për pushtimin e Epirit. Ata pohonin se Epiri ishte me rëndësi jetike për pjesën jugore të vendit të tyre për shkak të porteve (Prevezë, Artë, Gumenicë, Pargë). T'i jepte Greqisë territoret që ajo kërkonte, donte të thonte që të mos kuptoje dëshirën që ka populli të mbrojë territorin dhe kombësinë e vet. Ato do të luftojnë Abdyl Frashëri shpresonte se do ta realizonte qëllimin e tij që Italia të shprehej për rishikimin e protokollit 13 të Kongresit të Berlinit me të gjitha fuqitë e tyre, nën autoritetin mbrojtës të Perandorisë Osmane, për atdheun, kombësinë dhe gjuhën e tyre. *2 Delegacioni shqiptar u nis nga Preveza më 30 mars 1879. Pasi kaloi 4 ditë në Korfuz rifilloi udhëtimin duke marrë drejtimin për në Romë.* Kur arriti Abdyl Frashëri në Romë kishin filluar të dukeshin shenjat e një qëndrimi të ndryshëm të qeverisë italiane ndaj çështjes së kufirit turko-grek. Zhvillimin e plotë të kthesës e pengonte simpatia e madhe që kishte opinioni shoqëror ndaj helenizmit. Në fund të prillit, delegacioni shqiptar u nis për në Paris, i bindur se atje e priste një punë e vështirë me Vadingtonin filohelen, si autori i vijës famoze kufitare Kallamas-Sallamvria Përgjigja zyrtare që Vadingtoni i dha delegacionit tregonte se kabinetet franceze njihnin Portën e Lartë si të vetmin autoritet me të cilin mund të bisedohej për këtë problem, dhe e përcolli delegacionin tek konferenca e Stambollit me “premtimin” “se do t’i jepte udhezime ambasadorit të tij në Stamboll të kujdesej që të mos u bëhej ndonjë padrejtësi të dyja palëve”.

Po cili qe qëndrimi britanik? Qeveria Britanike ishte e prirë të merrte në shqyrtim çdo ide që do të mënjanonte ndërlikimet e dëmshme për politikën e saj. Gjatë bisedës së zhvilluar, lordi Salisburi i premtoi atyre gjoja garancën e F.Mëdha, që konsistonte në ndërmjetsimin e drejtë parimor të tyre për të gjitha kombet e Ballkanit. ²..... Në Berlin shqiptarët gjetën një pritje të ftohtë, ministri i jashtëm Billov e mori në dorëzim memorandumun e Lidhjes Shqiptare por nuk pranoi dy delegatët e saj. Gjermania u justifikua se “*nuk është e interesuar drejtëpërdrejt në punët e lindjes*”. Udhëtimi i dy delegatëve vazhdon në drejtim të Vjenës më 23 maj 1879. Vjena nuk e fshihte qëndrimin e saj :që të vendosej në Shqipëri zbatimi i protokollit të 13, do u shërbente synimeve të Vjenës. Megjithatë ajo kishte filluar të shqetësohej nga fuqizimi i Lidhjes Shqiptare, e cila gjithnjë e më tepër po tregohej e pavarur ndaj Austro-Hungarisë. Abdyl Frashëri u kthye nga misioni diplomatik jo vetëm me rezultate por dhe me mësim. Nga debatet që zhvilloi me zyrtarë, diplomatë dhe publicistë të vendeve të ndryshme ai nxori konkluzionin se Lidhja Shqiptare duhej ta dendësonte luftën e saj për të drejtat politike. Lidhja shqiptare e Prizrenit në pranverën e vitit 1879 kishte në bilancin e vet një varg suksesesh politike dhe ideologjike, diplomatike dhe organizative. Lufta për mbrojtjen e trojeve Shqiptare ende nuk kishte përfunduar, as detyra e rëndësishme e Lidhjes së Prizrenit për sigurimin e autonomisë aq të dëshiruar nuk qe realizuar .Mesa duket, ishte vetëm fillimi i një etape të re për Lidhjen e Prizrenit dhe realizimin e synimeve të saj.

Shënime: 1) K.Frashëri, vep.e permendur, fq.221; 2) M.Glenny, Historia e Ballkanit 1804-1999, fq 146.

Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

(Prishtinë, 19 gusht -30 gusht 2013)

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit
të Prishtinës

rruga Nënë Tereza, pn. - 10000 Prishtinë (Kosovë)
tel. +381 38 222 970

e-mail: seminari1974@yahoo.com /
bardhrugova@yahoo.com / blertaismajli@gmail.com

Drejtor: Prof. asoc. dr. Bardh Rugova

Sekretar: Prof. ass. dr. Nysret Krasniqi
Sekretare profesionale: Mr. Blertë Ismajli

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studentë e studiues që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht.

Seminari XXXII do t'i zhvillojë punimet në Prishtinë nga 19 gusht – 30 gusht 2013

Drejtorja e Seminarit do t'i mbulojë shpenzimet e vendosjes dhe të ekskursioneve eventuale në Kosovë. Shpenzimet e rrugës për Prishtinë dhe e kundërta i heqin vetë pjesëmarrësit.

Arritja e seminaristëve në Kosovë, më 18 gusht 2013 (e diel).

Hapja solemne e Seminarit XXXII, më 19 gusht 2013 në orën 11:00.

Programi-bazë i Seminarit XXXII:

1. Kurse intensive të mëimit të shqipes (tri shkallë);
2. Ligjërata të veçanta të gjuhësisë;
3. Ligjërata për letërsinë shqiptare;
4. Referime shkencore;
5. Ligjërata të përgjithshme;
6. Tryezë e rumbullakët;
7. Program kulturor plotësues për t'i njohur Seminaristët me bukuritë natyrore, me veprimtaritë kulturore e të mira të tjera në qendra të Kosovës

Sesioni Shkencor (29 – 30 gusht 2013)

- **Gjuhësi:** Studiuesit e huaj për shqipen në pjesën e dytë të shek. XX
- **Letërsi:** Letërsia dhe identiteti

Giordano protopapas Emanuele, Paraklisis, e pjerrë arbërisht, si dorëshkrim / pro manuscripto, Purçill/Ejanina (Cs), Pashkët 2013

Njo njetër pjesë Liturgjike bixantine të pjerrë arbërisht, edhe ndëse jo te forma e fundit. U kish dashur se edhe “Nëndë Kënkat” e kësaj “Lutje Shën Mërisë”, të kishin pasur një përkthim “të qepur ngrah” muzikës bixantino-greke; po këtë herë protopapasi s’patë durimin e duhur.

Schiro’ Di Maggio Giuseppe, Mosto 1860, opera teatrale in tre atti / Mushti 1860, vepër teatrale në tri akte, introduzione di Gianfranco Romagnoli, Pitti Edizioni, Palermo 2013

Autori, pas tridhjetë vjetsh, në njetër herë dorë mbi argumentin e Risorxhimentit Italian, ashtu se si e rruan arbëreshët e Horës, po me një sy më pak idealist. Populli kish parëmëparë problemin e bukës e jo vet t’i venej pas Garibaldiit e të vdisë për të bashkuar Italinë. Rrohet, qeshet e qahet rreth fjalës “Musht”, që identifikon rivolucionarët garibaldinë. E delli artistik/humoristik i Skiròit “zien” bashkë me popullin.

Schiro’ Di Maggio Giuseppe, La’ Kola ngrëjti kryet, një akt i vetëm / Zi’ Cola il rivoluzionario, atto unico, (a cura dell’associazione Culturale Mondo Albanese), Pitti edizioni, Palermo 2011

Revolucionën komuniste e ëndrrjën dhe e prisjën edhe ca shokë të Horës: katër idealistë të çelur, një pronar dherash, realist, që ka komunizmi pret të bëgatet më shumë; dhe e shoqja ‘ këtij, demokristiane. Po revolucionën bolshevike shokët e bëjën te triesa e të bëgatit, nga mbrëma. Njera që La’ Koles, për këtë Revolucionë të rreme, i frihen, e i zë...cilli; dhe e shoqja i përzë jashtë me fshiesën. “Revolucionën e bëri Barku!” - ky rëkimi i...fundit, i La’Kolës .

Bruno Vincenzo, Trupo Antonio, Gjëgjëzat e Lindjes...Çivit / Echi d’Oriente...a Civita, Print Design, Castrovillari 2009

“Libër i shkurtur ku butthoet Klisha e Fjetjes e Shën Mërisë në Çivit”, djovaset tek faqja dy të këtij librit me 34 faqe, shkruar arbërisht e lëtisht, me fotografi e thellime artistike. Një nderim i duhur Qishës ‘ Madhe të Çifitit, që zoti farnetjan Ndon Trupo, prifti i katundit ka shumë vjet, zbukuroi me ikona, mozaike e piktura bixantine. Një libërth i mirë për arbëreshët e për turistët. Një kopje do j dërguar Fermë, zotit Santelli, ç’ka Qishën e Shën Mërisë ‘ Sundes pa ikonostaz.

Bellusci Costantino, D’Agostino Flavia, Arbashkuar – Fjalor italisht-arbërisht-shqip i ilustrua / Dizionario Illustrato Italiano-Abërisht-Shqip – Histori dhe gjuhë arbëreshe të Firmozës, Çifitit, Ejaninës, Fermës, Frasnitës, Ungrës, Shën Vasilit dhe shqipe të Shqipërisë, Collana Minoranze Linguistiche, vol.I^o, Edizioni Orizzonti Meridionali, 2006

Është i pari (I) vëllim i kësaj Mbledhje/Collana: përmban “fjalë të përbashkëta në të folmet e Arbëreshëve të Italisë, variantet e tyre dhe krahasime/confronti me gjuhën e sotme shqipe”. Ky Fjalor na vë përpara, si mbi një tries, gjithë format, ato arbëreshe dhe ato “arbreshine”. Po gruret do ndajtur ka egjra: vet kështu do të dalë jashtë forma arbëreshe leksikore më e mirë. E, ndëse pas leksikut, del jashtë edhe forma gramatikore-sintaksore më e mirë, ahiera do t’kemi Gjuhën Standarde Arbëreshe. ...E kemi prap Vallen!

Arbëria ndër Revistat Shqiptare

(vjen nga nn. 69-71, 73, 74)

“Nëntori”

(vitrat 1981-1990) *

Shkurtaf Gjovalin, *Pasqyrë e qartë e poezisë së sotme arbëreshe*, Në, 8/81,f.228

Vorea Ujko, *Zef del Gaudio – poezi -*, Në,10/81,f.45

Varfi Andrea, *Dhimitër Kamarda – gjuhëtar, patriot dhe demokrat i shquar i rilindjes sonë kombëtare -*, Në,11/81,f.141

Vorea Ujko, *vjersha*, Në,1/82,f.68

Korresp, i Nëntorit: *Poezi originale, plot ndjenjë dhe mendim – diskutim krijues për librin “Këngë arbëreshe” të poetit arbëresh Vorea Ujko*, kronika, Në,10/82,f.248.

Arapi Fatos, *Shënim rreth poezisë së Vorea Ujkos*, Në,1/83,f.76

Vorea Ujko, *vjersha*, Në,1/83,f.98

Varfi Andrea, *Traditat dhe poezia e sotme arbëreshe*, Në,3/83,f.178

Altimari Françesko, *Kolegji arbëresh dhe vetëdija kombëtare tek Arbëreshët në gjysmën e parë të shekullit XIX*, Në,3/83,f.186

Zheji Gjergj, *“Zemër arbëreshe”*, vëllim me poezi nga Xh.Del Gaudio, Në,5/84,f.230

Skirò Xhusepe Di Maxho, *vjersha*, Në,8/84,f.141

Skirò Di Modika Zef, *vjershë*, Në,8/84,f.142

Renda Paskal, *vjershë*, 8/84,f.143

Buzëdhelprri (Jordani Agostin), *vjersha*, Në, 8/84,f.144

Xukaro Kate, *vjersha*, Në,8/84,f.146

Ferraro Matilde, *vjersha*, Në, 8/84,f.147

Hyso Ro., *“Paja”*, komedi e Skirò Xh.Di Maxhos në teatrin “A.Z.Çajupi” të Korçës, Në,11/85,f.234

Ballauri E., *“Burimi”*, poezi nga Vorea Ujko, recensione, Në,5/86,f.241

Vorea Ujko, *vjersha*, Në,7/87,f.133

Buzëdhelprri (Giordano Agostino), *vjersha*, Në,8/87,f.139

Matrangoli Engjëll, *vjersha*, Në,8/87,f.142

Skutari Enca, *vjersha*, Në,8/87,f.144

Shehu Agim, *Bota arbëreshe në faqet e një libri*, Në,6/88,f.61

Kaiku Agron (përgatitur nga -), *Katër letra te pabotuar në Shqipëri të drejtuar Jeronim De Radës*, Në,6/90,f.165

Skirò Zef Di Modika, *vjershë*, Në,12/90,f.102

Skutari Enza, *vjershë*, Në,12/90,f.102

Skirò Xhusepe di Maxho, *vjershë*, Në,12/90,f.103

Belmonte Vincenzo, *vjersha*, Në,12/90,f.104

Ferraro Matilda, *vjershë*, Në,12/90,f.105

Del Gaudio Xhusepe, *vjershë*, Në,12/90,f.106

Xhudiçissi Ofelia, *vjershë*, Në,12/90,f.106

*Numrat 2-9,11-12/1982 s'i gjeta (D.)

Djovas

Jeta Arbëreshe

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

VANGJELI



i pjerrë arbërisht
nga
zot EMANUELE GIORDANO

i pjerrë arbërisht

nga

zot Emanuele Giordano

230 faqe

Euro 10,00

Arbëria ndër Revistat Shqiptare

Studia Albanica

(1964-1990) *

- Riza Selman**, *Thèses sur le trois manuscrits du Catechisme de Lekë Matrënga*, S.A.,1/65,f.125
Le 150° anniversaire de la naissance de Jeronim De Rada, La vie scientifique, S.A.,1/65,f.171
- Bala Vehbi**, *Questions du mouvement culturel albanais dans la correspondance de Dora d'Istria à De Rada*, S.A.,2/66,f.197
- Kodra Klara**, *La figura di Skanderbeg nell'opera del De Rada*, S.A.,2/67,f.207
- Bihiku Koço**, *Les traditions de l'époque de Skanderbeg dans l'histoire des Albanais d'Italie*, S.A.,1/68,f.241
- Dhima Dodona**, *Publications albanaises à l'occasion du 5* centenaire de la mort de Geoges Kastrioti-Skanderbeg*, S.A.,2/68,f.173
- Bihiku Koço**, *Kodra Klara, Vepra poetike e Zef Serembes*, ed.de l'Institut de Linguistique e Litterature, Tirana 1975 – comptes-rendus, S.A.,2/76,f.205
- Domi Mahir, Shkurtaç Gjovalin**, *Francesco Solano, Manuale di Lingua Albanese, Corigliano Calabro 1972* – comptes-rendus, S.A.,2/78,f.191
- Haxhihasani Qemal**, *Antonio Bellusci, Argalia ndër tekstet originale arbëreshë, Cosenza 1977* – comptes-rendus, S.A.,1/79,f.203
Le Seminaire de langue e litterature albanaises pour les étudiants albanais d'Italie, – la vie scientifique, S.A.,1/79,f.238
- Shkurtaç Gjovalin**, *Francesco Solano, Le parlate albanesi di San Basile e Plataci, Quaderni di Zjarri, 1979* – comptes-rendus -, S.A.,1/81,f.201
- Kodra Klara**, *Traits du romantisme de De Rada*, S.A.,2/81,f.101
- Bihiku Koço**, *G. Gradilone, Altri Studi di Letteratura Albanese, Bulzoni Editore, Roma 1974*, - comptes rendus - S.A.,2/81,f.211
- Kostallari Androkli**, *A propos d'une conception de Jeronim De Rada sur la formation de la langue litteraire de la nation albanaise*, S.A.,1/82,f.157
- Altimari Francesco**, *Il movimento culturale della "Rilindja" e il collegio di S.Adriano nella prima metà del sec.XIX*, S.A.,1/83,f.127
- Shkurtaç Gjovalin**, *Sesion scientifique dédiée au 250° anniversaire de la fondation du collège de Shën Adrian*, - la vie scientifique - S.A.,1/83,f.189
- Shkurtaç Gjovalin**, *Le premier congrès International consacré aux minorités ethniques et linguistiques en Italie*, - la vie scientifique - S.A.,1/86,f.255
- Domi Mahir**, *In memoriam: prof.Giuseppe Schirò (junior)*, - la vie scientifique - S.A.,1/86,f.258
- Goçi Ibrahim**, *Quelques lettres de Dora d'Istria envoyées a Hiéronime De Rada*, S.A.,1/89,f.109
- Hidi Agim**, *Au II* congrès International sur les minorités ethniques et linguistiques en Italie*, - la vie scientifique - S.A.,1/89,f.200
- Vicchio Jannone Filomena**, *Observations sur le systeme phonétique du parler arbëreshë d'Acquaformosa*, S.A.,2/89,f.147
- Altimari Francesco**, *Testi albanesi di Calabria e Sicilia nelle opere di Hervàs*, S.A.,2/90,f.127
- Xhufi Pëllumb**, *Un éminent albanais à Constantinople: Nikollë Matranga, juge generale de Byzance*, S.A.,2/90,f.171
- Malltezi Luan, Lorenzo Tacchella**, *Giorgio Castriota Scanderbeg e i romani pontefici nel sec.XV, Verona 1987*, critique et bibliographie -, S.A.,2/90,f.20

* Numrat.2/1964, 2/1965, 1/1967, 2/1973, 1/1974, 2/1975 s'i gjeta (D.)

La Lingua Arbreshe deve assumere l'importanza centrale

Pierfranco Bruni

arkeolog, shkrimtar, poet, gazetar, ka Sullarënxë (Cs)

Cosa è l'Etnicità per una comunità di minoranza linguistica? È solo antropologia, è solo storia, è solo radicamento ad una eredità, ad una tradizione, ad una identità? È lingua, linguaggio, vocabolario della parola? Certamente sì, e resta fondamentale questo elemento, perché senza un "vocabolario" la parola diventa sempre più un taglio dentro l'appartenenza.

L'appartenenza è civiltà, è popolo, è attraversamento di frontiere. Gli Arbresh sono stati sempre una "frontiera" nella dimensione geografica e nella certezza storica tra due mondi che si attraggono: quello dei Balcani e quello Mediterraneo. Soprattutto in un contesto di geo-politica, le etnie costituiscono una chiave di lettura per "catturare" l'anima di una civiltà.

Gli Arbresh sono una civiltà dentro il contesto balcano – mediterraneo e si portano dentro non solo gli archetipi di una griglia simbolica illirica ma anche profondamente radicata in una visione che è sostanzialmente antropologica, ma che diventa (è diventata nel corso delle epoche) metafisica.

Bisogna che la lingua penetri l'antropologia e resti non metafora di una storia ma ontologia dell'anima di un popolo. Il "vocabolario" è chiaramente costituito da sillabe, vocali, ritmi, accenti, ovvero di parole, ma questo "vocabolario" del linguaggio parlato e ascoltato ha la sintesi di un ulteriore processo linguistico che è quello di una semantica marcatamente spirituale.

I Popoli cosiddetti "tagliati" (una volta si parlava di lingua tagliata, ma tanto tempo fa, ovvero quando c'era una diversa attrazione...) sono quelli che rischiano di perdersi nella sconfitta di una lingua sia parlata che scritta. Si salvano se si affida alla lingua sia l'importanza di una semantica del sentire il senso di appartenenza, sia nell'ascoltare il vocabolario che è trasmissione, ovvero comunicazione di linguaggi; che offrono sia un immaginario, sia un legame tra le "scorie" di una "ideologia" dell'identità, sia di un sentire vero di appartenere alla tradizione.

Certo, questo nostro tempo vive la fragilità del tramandare la tradizione. Non si può "giocare" sulla antropologia di un rimando al folclore. O si è dentro una eredità che riesce a trasformarsi in una appartenenza vera non solo in termini di capacità di recepire la memoria o le memorie, - grazie ad una intelaiatura tra lingua e letteratura, contesto territoriale e modelli artistici, tra riti religiosi e recupero di tradizioni pur nella laicità, - o si corre il rischio di perdersi.

È chiaro, comunque, che la lingua deve assumere l'importanza centrale accanto al rito, che è quello chiaramente bizantino. Gli Arberesh si smarriscono dentro il rito meramente cattolico-latino. Perdono le linee

di una eredità. Sono bizantini, sono ortodossi, sono orientali dentro l'Occidente. Questo è un punto focale di una discussione che può abbracciare i due riferimenti: lingua e antropologia. Ma lingua è quella Arbreshe e il rito non è quello latino. Bisogna capirsi, altrimenti si diventa "meticciati" senza un riferimento identitario.

È certo che dall'essere soltanto balcani e adriatici dal punto di vista sia geografico che culturale oggi si è complessivamente mediterranei. Perché il Mediterraneo non è soltanto un arco o un semi-cerchio di mare che lambisce coste e Paesi.

Il Mediterraneo è un sentire, ma è anche un accogliere popoli e civiltà tra mare e terra, in una vasta realtà storica che va dalla Macedonia all'Albania, dalla Grecia alle sponde iberiche. Non è un appunto sul cerchio del globo. Si tratta piuttosto di una misura di culture inclusive. Il mondo Arbresh è un mondo inclusivo che tocca chiaramente la matrice ereditaria che è l'Albania (o i Balcani in senso più ampio) ma è anche il Nord Africa, se si pensa alle comunità Arbreshe della Sicilia. La Sicilia è Mediterraneo africano. La Puglia, con le sue comunità, è incontro con l'Albania e i Balcani.

Insomma questo Mediterraneo diffuso non è "altro da sé" della storia e della cultura adriatica. Ecco perché, nella modernità del quadro geo-politico, ciò che si difende è la lingua. Le antropologie si intrecciano e le tradizioni misurano il senso della storia e la mitologia nella leggenda.

Solo la lingua porta dentro di sé una vera capacità di radicamento alle radici di un popolo, nonostante l'intreccio o la dilatazione "dialettica" con altre lingue. Occorre difendere il principio di una koine originaria. La lingua è quella del popolo – civiltà degli Arbresh. Non è quella del popolo albanese.

È chiaro che la partita della globalizzazione per gli Arbresh non si disputa intorno alle lingue moderne soltanto. Bisogna capire che ormai non si è solo eredi di una civiltà balcana; si è eredi, nella memoria, nella storia e nella civiltà, di un mondo balcanico e mediterraneo. Si è mediterranei perché si è balcani.

Bisogna prendere atto che il Mediterraneo è una civiltà molto più complessa, dentro la quale il vocabolario e l'identità Arbreshe possono avere un ruolo di straordinaria rilevanza. È mondo illirico, albanese e arabo nell'intreccio di radicamenti e di eredità che includono.

In fondo, il Mediterraneo è un crogiuolo di civiltà includenti.